



MOH-MENTI IVORIVIENTI

fytyra ndryshuese e kujtesës
the changing face of remembrance

MONUMENTI MONUMENTI

**fytyra ndryshuese e kujtesës
the changing face of remembrance**

MONUMENTI

fytyra ndryshuese e kujtesës
the changing face of remembrance

Organizuar nga | Organised by
Forum Ziviler Friedensdienst (*forumZFD*)

Në bashkëpunim me | In cooperation with
pax christi im Bistum Aachen

Financuar nga | Financed by
Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
Federal Ministry for Economic Cooperation and Development

KATALOGU / CATALOGUE

Botuesi | Publisher
Forum Ziviler Friedensdienst
Kralja Milutina 11
11000 Belgrade, Serbia

Redaktorët | Editors
Daniel Brumund, Christian Pfeifer

Korrektura | Proofreading
Daniel Brumund, Milica Radulović

Tekstet | Texts
© Autorët | The authors

Fotografitë | Photographs
© Marko Krojač

Përkthimet | Translations
Qerim Ondozi, Luan Morina, Kristina Thaqi (shqip)
Jelena Frančić, Sanja Katarić, Milica Radulović (boshnjakisht, kroatisht, serbisht)
Denise Dewey-Muno (anglisht)
Kristina Naceva, Rodna Ruskovska (maqedonisht)

Koncepti vizual | Visual Concept
Aleksandar Milić - MILIĆ DESIGN

Shtypi | Printing
Envinion, Pristina

© Belgrade, Forum Ziviler Friedensdienst (*forumZFD*)

edicioni 9 i rishikuar 2014 | 9th revised edition 2014

Ballina: Monumenti kushtuar Boro Vukmiroviqit dhe Ramiz Sadikut, 1961
Front Cover: Monument to Boro Vukmirović and Ramiz Sadiku, 1961

përmbajtja / content

Hyrje	Introduction	4
-	-	-
Dr Lutz Schrader		
Monumentet dhe politikat e identitetit në Ballkanin perëndimor	Monuments and Politics of Identity in the Western Balkans	6
-	-	-
Dr Bojana Pejić		
Monumentet e Jugosllavisë: Arti dhe retorika e fuqisë	Yugoslav Monuments: Art and the Rhetoric of Power	10
-	-	-
Valentino Dimitrovski		
Kthimi në të kaluarën: Monumentet dhe kujtesa në Maqedoni	Back to the Past: Monuments and Remembrance in Macedonia	14
-	-	-
Dr Senadin Musabegović		
Kuptimi simbolik i monumenteve në Bosnje dhe Hercegovinë	Symbolic Significance of Monuments in Bosnia and Herzegovina	18
-	-	-
Dr Vjeran Pavlaković		
Historitë e kontestuara dhe e kaluara monumentale: Kultura e kujtesës e Kroacisë	Contested Histories and Monumental Pasts: Croatia's Culture of Remembrance	22
-	-	-
Shkëlzen Maliqi		
Lufta e simboleve: Kujtesa në Kosovë	The War of Symbols: Remembrance in Kosovo	26
-	-	-
Mirjana Peitler-Selakov		
Plastika memoriale e Serbisë nga luftat ballkanike deri sot	Memorial Art in Serbia from the Balkan Wars until Today	30
-	-	-
Fotografitë	Photographs	34
-	-	-
Marko Krojač		
Biografia	Biography	92
-	-	-
Biografitë e autorëve	Authors' Biographies	94



Roli i monumenteve është që të përkujtohet një moment apo personalitet specifik nga e kaluara në mënyrë që të krijohen koncepte identiteti që përputhen politikisht në ditët tona. Derisa këto koncepte identiteti mund t'i ndajnë njerëzit e të nxisin dhunë, ato gjithashtu mund të kenë efekt pajtimi dhe të hapin rrugë drejt formimit të komuniteteve. Pas shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, konceptet e identitetit me një ndikim të ngushtë nacional u përjetuan në një varg shtetesh. Këto identitete shpesh definoreshin sipas divergjencës nga popujt tjerë fqinjë – përmes theksimit të përkatësisë fetare a gjuhësore, bie fjala. Ndonëse kjo mund të jetë e kuptueshme në kontekstin e një madhësie relativisht të vogël si dhe të rrjedhës së historisë së ndërtimit të kombit në shtetet e Ballkanit perëndimor, kjo ka ndikim negativ sa i përket realizimit të proceseve të nevojshme të modernizimit në një botë rrjetëzimesh në rritje. Për më tepër, kjo paraqet pengesë karshi një ballafaqimi më konstruktiv me të kaluarën që nevojitet urgjentisht për ta përsheptuar dialogun rajonal në lidhje me çështjet këmbëngulëse politike dhe ekonomike dhe për të arritur paqe të qëndrueshme. Përmes ekspozitës MONUMENTI, *forum-ZFD* dëshiron të shfaqë se si janë zhvilluar konceptet e identitetit në shtetet e Ballkanit perëndimor përgjatë shekullit XX. Duke marrë parasysh rolin e tyre, monumentet përbëjnë mjete ideale për t'i përfaqësuar këto procese

në një mënyrë interesante. Një monument i vetëm ndonjëherë mund të sjellë në mendje koncepte të ndryshme identiteti për hapësira specifike gjeografike dhe kohore. Transformimi, shkatërrimi dhe mospërfillja e monumenteve ekzistuese përbëjnë “përditësim” të koncepteve politike të identitetit dhe si rrjedhojë janë aq “relevante për identitetin” sa edhe ndërtimi i monumenteve të reja. Prandaj është e rëndësishme që ekspozita MONUMENTI ta shpërfaqë jo vetëm vetë monumentin, por edhe hapësirën përreth. Me Marko Krojaqin, ne kemi pasur sukses në gjetjen e një fotografi, i cili jo vetëm që posedon njohuri rajonale por gjithashtu është në gjendje t'i paraqesë monumentet në kontekstin e tyre haëpsinor. Ekspozita MONUMENTI u organizua nga zyra rajonale e *forumZFD*-së për Ballkanin perëndimor dhe përveç Beogradit ajo do të shfaqet edhe në lokacionet e tjera të projektit siç është Shkupi, Prishtina e Sarajeva. Një nevojë për të gjetur një mënyrë tjetër për t'u ballafaquar me të kaluarën dhe për t'i vënë në pyetje konceptet dominuese të identitetit që ekzistojnë në të gjitha vendet e rajonit. Me fjalë tjera, kjo nënkupton reflektim kritik të së kaluarës së vet, pranim të viktimitave të popujve tjerë, dhe njohje më të madhe të elementeve përafruese që padyshim ekzistojnë përtej kufijve etnikë.

Christian Pfeifer

Menaxher Rajonal për Ballkanin Perëndimor
Forum Ziviler Friedensdienst (*forumZFD*)

introduction

The role of monuments is to commemorate a specific event or personage from the past so as to create politically compliant concepts of identity in the present day. While these concepts of identity can divide peoples and foment violence, they can also have a reconciliatory effect and lead to the formation of communities. Following the collapse of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia, concepts of identity with an acutely national bias were experienced in the succession states. These identities were often defined by the divergence from other, neighbouring nationalities – through the emphasis of religious affiliations or linguistic differences, for example. Though this may be understandable in light of the comparatively small size and the historical course of nation building of the countries in the Western Balkans, it has a negative impact on the realisation of necessary modernisation processes in an increasingly networked world. Moreover, it hinders a more constructive confrontation with the past that is urgently required to accelerate the regional dialogue on pressing political and economic issues and to bring about lasting peace. With the MONuMENTI exhibition, *forumZFD* wishes to show how concepts of identity have developed in the countries of the Western Balkans over the course of the 20th century. Given their role, monuments constitute the ideal means to present these processes in an interesting manner. One and the same

monument can sometimes even conjure up different concepts of identity for specific geographic and temporal spaces. The transformation, destruction and neglect of existing monuments constitute “updates” of political concepts of identity and are consequently as “relevant to identity” as the establishment of new monuments. Hence it is important for the MONuMENTI exhibition to not only show the monument itself, but also the surrounding area. With Marko Krojač, we successfully acquired a photographer, who not only affords outstanding regional knowledge but is also able to present the monuments in their spatial context.

The MONuMENTI exhibition was organised by *forumZFD*’s regional office for the Western Balkans and will also be shown in other project locations such as Skopje, Priština and Sarajevo in addition to in Belgrade. The need to find another way to deal with the past and to question dominant concepts of identities exists in all countries in the region. In concrete terms, this means reflecting critically on one’s own past, acknowledging the victims of other nations, and according greater recognition to the binding elements that undoubtedly exist over and beyond the ethnic boundaries.

Christian Pfeifer

Regional Manager for the Western Balkans
Forum Ziviler Friedensdienst (*forumZFD*)

monumentet dhe politikat e identitetit në ballkanin perëndimor

Dr Lutz Schrader

Shteti komb, politikat e identitetit dhe monumentet

Politikat e kujtesës dhe të identitetit kanë qenë për një kohë të gjatë sferë e elitës udhëheqëse – më së voni që nga formimi i shteteve të institucionalizuara siç janë ato në Egjiptin e lashtë, Greqi dhe Romë. Përkundër kësaj, tranzicioni i shteteve kombe moderne kanë shënuar një pikë kthimi. Në mesjetë dhe në periudhën e hershme moderne, “kombet” ishin grupet etnike që dallonin për nga karakteristikat e tyre kulturore dhe përndryshe ekzistonin në një masë të madhe në pavarësi nga institucionet politike të mbretërive dhe principatave. Kjo ndryshoi kur lëvizjet nacionale rishtaz të formuara zbuluan burimet kulturore që ishin në gjumë përbrenda bashkësive etnike. Për t’u dhënë jetë “shteteve kombe” burokratike moderne, ato e portretizonin “kombin” si një “bashkësi fati” identitet-mbështetëse.

Në dallim nga zeitgeistit nationalist i shekullit XIX, Max Weber ishte njëri nga të parët i cili i referohej origjinës “‘artificiale’ të besimit në etnicitetin e përbashkët”. Sipas mendimit të tij, ajo përputhej me “modelin e reinterpretimit të socializimit nacional në marrëdhëniet personale të bashkësisë”. Për të, formimi i shteteve kombe moderne të nxitura nga fuqia politike, burokracia dhe interesat ekonomikë përfshinin një rast të tillë të “asocimit qëllimplotë-racional” (Weber 1964: 309). Interesat, të drejtat dhe tregjet zëvendësuan lashtësinë, zakonet dhe traditën si bazë të rendit politik dhe ekonomik.

Prandaj, në thelb zuri vend pikërisht e kundërta nga ajo që dukej në sipërfaqe. Zhvillimi i kapitalizmit industrial dhe i burokracive anonime shtetërore si dhe i masave të sekularizuara çuan në një çrrënjosje individuale të shpërndarë gjerësisht si dhe në një “zhgënjim të botës” (po aty). Elitat udhëheqëse kërkonin mënyra dhe mjete për ta kompenzuar mungesën e pashmangshme të kuptimit dhe integritetit social. Entuziazmi nacional i lëvizjes së emancipimit civil të të rinjve u shërbeu mirë. Shteti komb fillimisht i bazuar në nevojën e qenësishme ekonomike dhe në arsyeshmëri të ligjit kërkonte ‘cimento’ të fortë kulturore. Kjo mund të gjendej tek elementet e “afinitetit etnik” që kishte ndikim kudo, në “grupin gjuhësor” dhe në “homogjenitetin e rregullimit ritual të jetës, siç përcaktohet nga besimet e përbashkëta fetare” (po aty).

Poashtu, dinamika ekskluzive e nacionalizmit nuk kaloi e pavërejtur nga Max Weber. Ai fliste për “nderin etnik” në “bindjen sa i përket përsoshmërisë së zakoneve të dikujt dhe të inferioritetit të atyre të huaj” dhe përfundimisht për ‘zgjedhmërinë’ e njerëzve të vet. Si “nder specifik i masave”, nderi etnik është në dispozicion për cilindo që është pjesë e “komunitetit të prejardhjes së besuar subjektivisht”. Weber nxjerr popullaritetin e tij nga fakti se në dallim nga diferencimi i statusit, ai mund të “pretendohet në një shkallë të njëjtë nga secili anëtar i grupeve që urrehen në mes veti”. Neveria etnike si pasojë mund të përvetësojë të gjitha dallimet e përfytyrueshme – përmes mbajtjes së mjekrrës apo të një stili të caktuar flokësh – dhe ato t’i transformojë në “konventa etnike” (po aty).

Për t’i dhënë formë kombit si një subjekt i ri politik përtej kufijve hapësinorë, gjuhësorë, kulturorë e fetarë, historia u nacionalizua gjithashtu, d.m.th. u ndërtua dhe u rindërtua “si legjitimim i një të tashmeje të re” (Kaschuba 2001: 31). Potretizimet e nacionalizuara të historisë gjetën rrugën e tyre në mendjet e njerëzve përmes dramatizimit të tyre efikas publik në letërsi, teatro, muze dhe nëpër universitete. Arkitektura luajti një rol të veçantë në këtë. Me çdo teatër të ri, muze dhe stacion të trenit, kombi ngriti një monument për nder të tij. Duke rilokuar qendrat dhe akset kryesore të qyteteve larg nga kështjellat dhe kishat tek pallatet e parlamentit, bashkitë dhe ndërtesat universitare, marrëdhëniet e reja të fuqisë dhe vetëkonceptcionit të elitave nacionale u gdhendën në gur në kuptimin e plotë të fjalës.

Ndërtimi i një ndërtese të re reprezentative publike shpesh përfundonte me inaugurimin e një monumendi. Ritualit nuk ka ndryshuar shumë në ditët tona. Në përgjithësi fillonte me nismën për ta ndërtuar një monument, që përcillej me debate rreth mesazhit të tij politik dhe formës estetike. Ngazëllimi publik i krijuar nga mediat dhe udhëheqësit e opinionëve formonte një pjesë të realizimit. Kur arrihej tërheqja e vëmendjes, monumendi tashmë filloi të kishte ndikim politik e arsimor – madje edhe para se të vihej guri i parë. Në këtë proces, hierarkitë nacionale të kuptimit vihehin në pyetje dhe konfirmoheshin, përmbyseshin e ndërtoheshin. Për këtë arsye të gjitha elementet debatohen me shumë energji: artistët dhe vendndodhjet, dizajnet dhe realizimi, ftesat dhe fjalimet në inaugurim.

Arsyeja për rritje të interesit publik kishte të bënte në një masë të madhe me funksionin e ri të monumenteve gjatë formimit të shteteve kombe moderne. Qëllimi vendosmërisht reprezentativ dhe arsimor në emër të idesë nacionale doli në pah. Më pas personalitetet – gati ekskluzivisht burra – vihehin në piedestal, që ofruan shërbime të jashtëzakonshme për kombin duke e mbrojtur në fushëbetë, dhe duke kontribuar në rilindjen dhe zhvillimin e gjuhës kombëtare, apo duke e formësuar letërsinë, artin dhe shkencën kombëtare. Përfaqësimet metaforike të ngjarjeve kyçe në historinë kombëtare gjithashtu ishin të popullarizuara. Kombi duhej të ishte i bashkuar rreth përvojave historike, arritjeve dhe simboleve, të themi ashtu. Në proces nuk u rihartua vetëm mendësia publike por edhe e gjithë hapësira publike, në aspektin historik e politik.

Politikat e identitetit në Ballkanin Perëndimor – ndërmjet nacionalizmit dhe “jugosllavizmit”

Paralelet e dukshme ndërmjet zhvillimeve në Evropën perëndimore, veriore dhe qendrore si dhe në rajonin e Ballkanit përfunduan me shpërthimin e Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Në kohën e formimit të shtetit të parë jugor sllav në dhjetor të vitit 1918, popujt e përfshirë e gjetën veten duke u ballafaquar me një dilemë. Në anën tjetër, Serbia ishte mjaft e dobësuar nga barra e luftës për të qenë në gjendje ta mbrojtë hegemoninë e saj në favor të identitetit të përbashkët transnacional. Nga ana tjetër, kroatët dhe sllovenët ishin tashmë mjaft të avancuar në vetëzbulimin e tyre kombëtar nën ombrellën e Habsburgut sa për ta nënshtruar veten edhe

njëherë. Në fillim, dominimi serb dukej të ishte pa alternativë. Por ngadalë dhe sigurt, ideja e përbashkët jugosllave u zbraps. Ajo që mbeti ishte këmbëngulja anakronike e forcave konservative serbe për një shtet centralist unik. Kjo edhe më shumë i vuri zjarr aspiratave të kroatëve, sllovenëve dhe bashkësive tjera për autonomi dhe pavarësi.

Më pas, “kombi me tre emra” u shndërrua në një konflikt të ashpër në rritje ndërmjet tre popujve, ku u futën edhe grupet tjera etnike. Dështimi i një sintheze autentike mund të deduktohet nga monumentet e kësaj periudhe. Në vend të (ri)shpikjes së një forme simbolike adekuate për karakteristikat mjaft të përbashkëta të popujve sllavë të jugut, që nga fillimi mbizotëruan vetëimazhet e ndryshme kombëtare. Madje edhe për serbët projugosllavë, fokusi ishte të lartësimi i meritave të tyre për kauzën e përbashkët. Prandaj mitet dhe simbolet e ‘fiseve’ të ndryshme nuk mund të lidheshin dhe të kombinoheshin në një identitet të përbashkët. Pa mbështetje tek ritualet familjare, imazhet, tingujt, frazat dhe koreografitë, ‘jugosllavizmi’ mbeti një guacë e zbrazët, e shkëputur nga kujtesat dhe ndjenjat e njerëzve të zakonshëm.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ideja jugosllave përjetoj një rilindje në një mënyrë që nuk do të kishte qenë e mundur pa diskreditimin e monarkisë serbe dhe pa bashkëpunimin e nacionalistëve nga të gjitha anët me Fuqitë e Boshtit. Dhe komunistëve u duhej një referencë integruese për ta realizuar programin e tyre politik. Miti i kryengritjes civile kundër forcave okupuese gjermane dhe italiane u

bë njëra nga shtyllat kryesore të identitetit të ripërtirë jugosllav. Për t’u pozicionuar si trashëgimtarët legjitimë të historisë kombëtare të popujve sllavë të jugut, komunistët gjithashtu nxirrmin frymëzime nga shkollat e ndryshme të trashëgimisë kulturore e artistike, nga traditat civile përparimtare, dhe nga lëvizjet kombëtare emancipuese të shekujve XIX dhe XX.

Shumëllojshmëria e burimeve identitet-mbështetëse u pasqyrua tek subjektet dhe gjuha estetike e monumenteve të reja të cilët tashmë mbinin si këpurdhat ndërmjet lumit Drava dhe liqenit të Ohrit. Trajta tradicionale e pedestalit e bërë nga mermeri dhe bronzi u rezervua për sundimtarët historikë dhe për autorët si Ivo Andriqi. Ndryshe, një gjest modern në vazhdimësi u përvetësua për heronj dhe mite të reja. Komplekset monumentale përgjithësisht të mëdha konsideroheshin pika referimi të vetkonceptimit postnacional dhe universalist. Me gjithë avangardizmin e tyre, ato prapëseprapë shfaqnin vazhdimësi në një pikë thelbësore: Edhe më shumë se paraardhësit e tyre civilë, komunistët aspironin për modernizëm industrial. Megjithatë, versioni i tyre jugosllav u thye aq shpejt sa edhe betoni i monumenteve që e madhëronte gati prerazi.

Referenca tek modernizmi u refuzua në mënyrë eksplicite nga pasardhësit neonacionalistë të titizmit në vitet 1990. Integrimi i ndërmjetësuar kulturalisht nga shteti, tregu dhe shoqëria civile u zëvendësuan me një kulturë të reduktuar vetëm në etnicitet si qëllimi aktual, i vetëmjaftueshëm. Me kthimin në traditat e vjetra, të rizbuluara dhe të shpikura,

u bënë përpjekje për t’i nxjerrë sfondet e tjetërsisë kulturore. Kjo gjithashtu përfshinte monumentet. Edhe mesazhet e tyre politike edhe estetika në masë të madhe konfirmojnë semantikën e mbrapshtë të ideologjisë etnonacionaliste. Mirëpo monumentet e heronjve, të vjetër e të rinj, nuk dështuan të kenë një ndikim tek vizitorët. Aty buron një rezonancë emocionale nga kujtimi i përvojave të përbashkëta historike që lidhen me vendndodhjen e memorialeve.

Deri në ditët tona, tendenca për të përfutur nga karizma e atyre vendeve duket e madhe në qarqet e caktuara politike, fetare dhe intelektuale. Sikur të mos dinin më mirë, ata edhe njëherë i përdorin monumentet për t’i prezantuar qëllimet e tyre politike dhe kombëtare si arritje të aspiratave dhe profecive të çiltra, si tejkalim të fyerjeve shumëshekullore, dramatizim të fitoreve legjendare apo si njohje të arritjeve të jashtëzakonshme dhe të vyrtyteve të njerëzve të tyre. Sidoqoftë, ky lloj i politikave të kujtesës dhe të identitetit e ka çmimin e vet. Ai për shumë vite i mban gjallë emocionet përjashtuese dhe përçarëse të luftës. Poashtu, estetika këmbëngul në një formalizëm reaksionar. Spektri shtrihet nga statujat e figurave heroike përmes metaforave të gurit të varrit e deri te citatat monstroze pseudoantike.

Sidoqoftë, gjithashtu ekzistojnë monumentet e reja që përfaqësojnë një qasje të shikimit përpara. Ato ose bëjnë referenca të vetëdijshme drejt artit monumental bashkëkohor– siç është vepra e e Ivan Meshtroviqit, ose i prejnë radikalisht të gjitha rrënjët. Të fundit janë rezultat i

kërkimit të përmbajtjes dhe formave të shprehjes që dënojnë çfarëdo reference në traditat kombëtare, titiste apo etnonacionaliste. Krijuesit e tyre duket se kanë humbur besimin në një qëndrim disi të çuditshëm heroik. Heronjtë tradicionalë kundërveprojnë me përfaqësimet e Rokit apo të Bob Marlit. Statujat qëndrojnë ballë për ballë me shikuesit e tyre. Ato ftojnë në dialog dhe reflektim. Dekonstruktimi i monumenteve zuri vend përmes një ndërrimi vendesh: fokusi nuk është më tek ekzagjerimi apo dalldisja me idetë, personalitetet dhe ngjarjet e krijimit të bashkësive. Më saktë, shumë më shumë ka të bëjë me thirrjen për një qasje dhe debat mjaft individual rreth një personi apo ngjarjeje të përfaqësuar. Prandaj perspektiva e individit nuk bëhet vetëm pjesë e monumentit por gjithashtu pjesë e interpretimit të historisë...

Bibliografia

Kaschuba, Wolfgang (2001): Geschichtspolitik und Identitätspolitik. Nationale und ethnische Diskurse im Kulturvergleich, in: Binder, Beate/ Kaschuba, Wolfgang/Niedermöller, Peter (Ed.): Inszenierung des Nationalen. Geschichte, Kultur und die Politik der Identitäten am Ende des 20. Jahrhunderts. Alltag und Kultur vol. 7, Cologne: Böhlau Verlag, p. 19-42.

Weber, Max, Economy and Society. An outline of interpretive sociology, Volume 2, edited by Guenther Roth and Klaus Wittich, Berkley, Los Angeles, London: University of California Press.

monuments and politics of identity in the western balkans

Dr Lutz Schrader

Nation state, politics of identity and monuments

The politics of memory and identity have long been the domain of the ruling elite – at the latest since the formation of institutionalised states such as those in ancient Egypt, Greece and Rome. The transition to the modern nation states nevertheless marked a turning point. In the Middle Ages and Early Modern period, “nations” were ethnic groups that differed in their cultural characteristics and otherwise existed to a large extent independently of the political institutions of kingdoms and principalities. This changed when the newly formed national movements discovered the cultural resources that lay dormant within the ethnic communities. To breathe life into the modern bureaucratic “nation state”, they portrayed the “nation” as an identity-endowing “community of fate”.

Contrary to the nationalist zeitgeist of the 19th century, Max Weber was one of the first, who referred to the “‘artificial’ origin of the belief in common ethnicity”. In his opinion, it corresponded to the “model of reinterpretation of rational socialisation in personal community relations”. For him, the formation of modern nation states driven by political power, bureaucracy and economic interests involved such a case of “purpose-rational association” (Weber 1964: 309). Interests, rights and markets replaced ancestry, customs and tradition as the bases of political and economic order.

Thus, exactly the opposite took place at the core than appeared to be the case on the surface. The development of industrial capitalism and anonymous state bureaucracies and secularised mass societies led to widely spread individual uprooting and the “dis-enchantment of the world” (ibid). The ruling elites sought ways and means to compensate for the imminent lack of social meaning and integration. The national enthusiasm of the young civil emancipation movement served them well. The nation state primarily based on inherent economic necessity and the rationality of the law required strong cultural ‘cement’. This could be found in the elements of “ethnic affinity” with an impact everywhere, in the “language group” and in the “homogeneity of the ritual regulation of life, as determined by shared religious beliefs” (ibid).

Also the exclusive dynamics of nationalism did not go unnoticed by Max Weber. He spoke of “ethnic honour” in the “conviction of the excellence of one’s own customs and the inferiority of alien ones” and finally of the ‘chosenness’ of one’s own people. As “specific honour of the masses”, ethnic honour is accessible to anybody who belongs to the “subjectively believed community of descent”. Weber derives its popularity from the fact that in contrast to status differentiation, it can be “claimed to an equal degree by any and every member of the mutually despising groups”. Ethnic repulsion may consequently take hold of all conceivable differences – through to having a beard or particular haircut – and transform them into “ethnic conventions” (ibid).

To shape the nation as a new political subject over and above the spatial, linguistic, cultural and religious boundaries, the history was also nationalised, i.e. constructed and reconstructed “as legitimisation of a new present” (Kaschuba 2001: 31). The nationalised portrayals of history found their way into people’s heads through their effective public dramatisation in literature, theatres, museums and universities. Architecture played a special role in this. With every new theatre, museum and railway station, the nation erected a monument in its honour. By relocating the centres and main axes of cities away from castles and churches to the palatial parliament, town hall and university buildings, the new power relations and self-conception of the national elites were literally carved in stone.

The construction of a new representative public building was often completed with the inauguration of a monument. The ritual has changed little to this day. It generally began with the initiative to construct a monument, followed by the debates on its political message and aesthetic form. The public excitement created by the media and opinion leaders formed part of realisation. Once attention had been drawn, the monument already began to have a political and educational impact – even before the first stone had been laid. In this process national hierarchies of meaning were questioned and confirmed, overturned and constructed. That is why all elements are hotly debated: artists and locations, designs and realisation, invitations to and speeches at the inauguration.

The reason for increased public interest had much to do with the new function of monuments during the formation of modern nation states. A decidedly representational and educational purpose in the name of the national idea came to the fore. Subsequently personalities – almost exclusively men – were put on the pedestal, who had rendered outstanding services to the nation by defending it on the battlefield, contributing to the rebirth and development of the national language, or shaping the national literature, art and science. Metaphorical representations of key events in the national history were also popular. The nation was to be united around the historic experiences, achievements and symbols, so to speak. In the process not only the public’s mindset but also the entire public space was remapped historically and politically.

Politics of identity in the Western Balkans – between nationalism and “Jugoslavenstvo”

The obvious parallels between developments in Western, Northern and Central Europe and the Balkan region ended with the outbreak of the Balkan Wars and the First World War. At the time of the founding of the first united southern Slavic state in December 1918, the peoples involved found themselves facing a dilemma. On the one hand, Serbia had been too weakened by the burden of war to be able to assert its hegemony in favour of a shared transnational identity. On the other, Croats and Slovenes were already too advanced in their national self-discovery under the Habsburg yoke to subordinate themselves once again. At the beginning, the Serbian dominance ap-

peared to be without alternative. Yet slowly but surely, the shared Yugoslav idea lost ground. What remained was the anachronistic insistence of conservative Serbian forces on a centralised unitary state. This merely fuelled the aspirations of Croats, Slovenes and other communities for autonomy and independence even more.

Successively, the “nation with three names” turned into an increasingly fierce conflict between three nations, into which other ethnic groups were drawn. The failure of an authentic synthesis can be deduced from the monuments of this period. Instead of (re-) inventing an adequate symbolic form for the much conjured shared characteristics of the southern Slavic peoples, the different national self-images prevailed from the beginning. Even for the pro-Yugoslav Serbs, the focus was on celebrating their own merits for the common cause. Thus the myths and symbols of the different ‘tribes’ could not be linked and combined in a shared identity. Without recourse to the familiar rituals, images, sounds, phrases and choreographies, ‘Jugoslavenstvo’ remained an empty shell, cut off from the memories and emotions of the ordinary people.

After the Second World War, the Yugoslav idea experienced a renaissance in a way that would not have been possible without the discreditation of the Serbian monarchy and the collaboration of nationalists from all sides with the Axis Powers. And the communists needed an integrative reference to realise their

political programme. The myth of a civil uprising against the German and Italian occupying forces became one of the most important pillars of a renewed Yugoslav identity. To establish themselves as the legitimate heirs of the national history of the southern Slavic peoples, the communists also drew inspiration from the different schools of cultural and artistic heritage, from progressive civil traditions, and from emancipatory national movements of the 19th and early 20th centuries.

The variety of identity-endowing sources was reflected in the subjects and aesthetic language of the new monuments that now sprung up like mushrooms between the Drava River and Lake Ohrid. The traditional shape of pedestal made out of marble and bronze were reserved for historic rulers and authors such as Ivo Andrić. In contrast, a consistently modern gesture was adopted for the new heroes and myths. The generally vast monument complexes were considered landmarks of a post-national and universalist self-conception. With all their avant-gardism, they nonetheless showed continuity in one essential point: Even more than their civil predecessors, the communists aspired to industrial modernism. However, their Yugoslav version cracked as rapidly as the concrete of the monuments almost emphatically celebrating it.

The reference to modernism was explicitly rejected by the neo-nationalist successors of Titoism in the 1990s. The culturally-mediated integration by state, market and civil society was replaced by a culture reduced solely to

ethnicity as the actual, self-sufficient purpose. With return to old, rediscovered and invented traditions, attempts were made to erect the backdrops of cultural otherness. This also included monuments. Both their political message and aesthetics largely confirm the backward semantics of ethno-nationalist ideology. Yet still the monuments for heroes, old and new, did not fail to have an impact on visitors. An emotional resonance emanates from the evocation of shared historic experiences associated with the memorial sites.

To this very day, the temptation to take advantage from the charisma of those places seems great in certain political, religious and intellectual circles. As if one did not know better, once again they use monuments to present their political and national goals as the fulfilment of the heartfelt aspirations and prophecies, the overcoming of centuries-old insults, the re-enactment of legendary victories or the acknowledgement of extraordinary accomplishments and virtues of their people. However, this type of politics of remembrance and identity has its price. It keeps the exclusive and divisive emotions of the war years alive. Also the aesthetics persist in a retrograde formalism. The spectrum ranges from statues of heroic figures via tombstone metaphors to monstrous pseudo-antique quotes.

However, there are also new monuments representing a forward-looking approach. Either they make conscious reference to contemporary monumental art – such as the work of Ivan Meštrović. Or they radically cut all

roots. The latter are the result of the search for content and forms of expression, which deny any reference to national, Titoistic or ethno-nationalist traditions. Their creators seem to have lost their trust in a somewhat strange heroic attitude. Traditional heroes are counteracted with representations of Rocky and Bob Marley. Statues stand eye-to-eye with their beholders. They invite to dialogue and reflection. The deconstruction of monuments took place via a reversal: the focus is no longer on exaggeration of and rapture about community-creating ideas, personalities and events. Rather, it is far more about inviting to a rather individual approach and debate on the person or event represented. Thus the perspective of the individual not only becomes a part of the monument but also a part of the interpretation of history ...

Bibliography

Kaschuba, Wolfgang (2001): Geschichtspolitik und Identitätspolitik. Nationale und ethnische Diskurse im Kulturvergleich, in: Binder, Beate/Kaschuba, Wolfgang/Niedermöller, Peter (Ed.): Inszenierung des Nationalen. Geschichte, Kultur und die Politik der Identitäten am Ende des 20. Jahrhunderts. Alltag und Kultur vol. 7, Cologne: Böhlau Verlag, p. 19-42.

Weber, Max, Economy and Society. An outline of interpretive sociology, Volume 2, edited by Guenther Roth and Klaus Wittich, Berkeley, Los Angeles, London: University of California Press.

monumentet jugosllave: arti dhe retorika e pushtetit

Dr Bojana Pejić

Monumenti është faktikisht një fenomen publik; publiku është komision i cili e ka arsytuar dhe të cilit i kushtohet. Hapësira e hapur publike në të cilën një monument ekziston është teknikisht medium i vetëm i mundshëm i sferës socio-psikologjike për të cilën ai synohet: realiteti shpirtëror i mjedisit të vet. P u b l i k s h m ë r i a është natyra e vërtetë e monumentit; këtu monumenti rritet, qëndron, apo rrëzohet: në publikshmëri qëndron e gjithë madhështia apo mosqenia e monumentit. Nëse i mungon dimensionin publik, monumenti është vetëm një masë, ndonjëherë një skulpturë e mirë apo diçka tjetër, por gjithmonë një keqkuptim i cili zhduket me heqjen e monumentit.

Eugen Franković, "Javnost spomenika" (Publikshmëria e monumenteve)

"Kujtesa i bashkangjitet vendndodhjes së vet..." shkruan historiani freng Pierre Nora. Monumentet dhe memorialet janë vërtetë vendndodhje të tilla. Kur ne sot përpiqemi ta rishkruajmë një histori arti të vendndodhjeve jugosllave të kujtesës, ne ballafaqohemi me një fakt dëshpërues: një histori e tillë faktikisht nuk është shkruar ndonjëherë. Mungesa e teksteve të çmueshme historike dhe teorike të artit në lidhje me monumentet politike dhe "kulturore" të ngritura në territoret e ish Jugosllavisë nuk pasqyron mungesën e monumenteve. Përkundrazi! Edhe shteti i parë (1918-1941) edhe shteti i dytë jugosllav (1945-1991/92) manifestonin një lakmi të vërtetë për përkujtime dhe një pasion të vërtetë për hapësinimin e kujtesave kolektive. Cilido projekt i tillë, sidoqoftë, kishte nevojë për zbatimin e një politike të caktuar të kujtesës dhe këto politika varen nga ajo se çka përfytyrohet si "identiteti kolektiv" i një bashkësie, kombi apo shteti. Historiani amerikan John R. Gillis thekson se edhe kujtesave

edhe identiteteve shpesh u mveshet statusi i "objekteve materiale" të pandryshueshme. Ai e zbërthen këtë konceptim: "Ne kemi nevojë të na bëhet me dije se kujtesat dhe identitetet nuk janë gjëra fikse por përfaqësime dhe konstruksione të realitetit, më shumë dukuri subjektive sesa objektive." Prandaj, "ne vazhdimisht i shqyrtojmë kujtesat tona për t'u përshtatur identiteteve tona aktuale." Monumentet publike, edhe ato që u kushtohen figurave politike edhe ato për njerëz të kulturës, janë instrumentale në këto shqyrtime: ato të cilat nuk u përshtaten "identiteteve të reja" duket të largohen për t'u lënë vend monumenteve të reja të cilat tani i hapësinojnë identitetet e ndërtuara rishtaz. Një diskurs rreth memorialeve politike (apo të çfarëdo monumenti tjetër publik) që ne mund ta ndëtojmë sot, dallon radikalisht nga kuptimi i zakonshëm i monumenteve që tradicionalisht diskreditoreshin si "arti i urdhëruar" apo "arti i porositur" (Auftragskunst). Si vepra arti të porositura nga ndonjë agjensi publike (bashkësi kombëtare, organizatë veterane, ose madje administratë shtetërore/federale) monumentet besohet të jenë "shërbimi i" një fuqie të caktuar, të cilën ata duhet ta "ilustrojnë." Megjithatë, kur monumentet ekzaminohen si përfaqësime vizuale, ne (duhet ta) kuptojmë monumentin si vendin në të cilin ndërtohet fuqia. Siç argumenton historiani amerikan i artit David Summers, "imazhet zëvendësuese" (përfaqësimet e sundimtarëve) dhe hapësira në të cilën përdoren, janë "realizimi i fuqisë ipso facto, jo shprehje e fuqisë, por forma aktuale e marrë nga fuqia në njërin apo në tjetrin vend e kohë." Monumentet, sikur edhe format tjera të përfaqësimeve vizuale që i hasim në sferën publike (siç janë posterët, filmat dokumentarë dhe të luajtur, fotografitë në shtyp dhe pullat postare), luajnë një rol themelues dhe jo vetëm atë pasqyrues, të vonuar. Një diskurs rreth vendeve memoriale në dy

shtete jugosllave nuk është unik. Ai nuk dallon shumë nga vendet tjera: të paktën që nga Revolucioni Francez, trajtimi i monumenteve publike tregon në drejtim të faktit se krijimi i imazheve është po aq i vjetër sa edhe thyerja e imazheve. Krijimi dhe thyerja është poashtu karakteristikë e produksioneve memoriale jugosllave, ku nuk duhet harruar se të dy shtetet jugosllave dhe shumica e atyre postjugosllave janë themeluar pas luftërave. Mbretëria e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve e njohur si "kombi me tre emra" (troimeni narod) u themelua në vitin 1918 pas Luftës së Parë Botërore. Monumentet e ndërtuara rishtaz kishin për qëllim të përforconin kujtesën publike të herozimit dhe vuajtjeve të luftës, por kjo kujtesë, fatkeqësisht, mund të krijohet vetëm në disa vende të shtetit të bashkuar rishtaz, faktikisht të përbërë nga fituesit dhe humbësit e luftës. Kur ky shtet u bë "kombi me një emër" (jednoimeni narod) dhe në përputhje me rrethanat u riemërua Mbretëria e Jugosllavisë (1929-41), filloi të promovojë ideologjinë e jugosllavizimit të unisuar, i cili nuk u ndërta vetëm përmes diktaturës por gjithashtu përmes monumenteve për mbretërit jugosllavë të dinastisë serbe të Karagjorgjeviqit: Petar I "Çliruesi" (vdiq më 1921) dhe Aleksandar "Bashkuesi i Madh" (i vravë më 1934). Ndërmjet viteve 1923 dhe 1940, afro 215 monumente dhe memoriale të dedikuara për sundimtarët e vdekur u ngritën në gjithë mbretërinë jugosllave. Asnjëri nga këta monumente nuk mbijetoi, por skulptorët që i dizajnuan (Ivan Meshtrović, Lojze Dolinar, Frano Krshinić, Antun Augustinčić dhe Sreten Stojanović) mbijetuan. Të gjithë ata përsëri do të angazhoheshin në prodhimin e memorialeve në Jugosllavinë "e re". Shteti i dytë jugosllav, i shpallur më 29 nëntor 1943, ishte gjithashtu një shtet i lindur nga lufta. Pas vitit 1945, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë u kënaq edhe njëherë me

statujë-mani, e cila tani e hapësinonte kujtesën e një lufte të drejtë dhe fitoren ndaj fashizmit. E arritur nga forcat partizane tranzicionale dhe multietnike, ajo mbështeste "vëllazërim bashkëmin" e "të gjithë" popujve/kombeve jugosllave. Kështu u krijuan edhe vendet e reja memoriale të populluara me monumente të panumërta të cilat, si të gjithë objektet e tilla në botë, e zhvilluan përsëri një kujtesë kolektive e cila, që nga viti 1945, u bë e institucionalizuar si historia e "jonë": kjo ishte historia e fituesve, dhe fituesit kanë prirje për "kujtesat selektive." Në hapësinimin e kësaj kujtese-si-histori, monumentet jugosllave shfrytëzuan "regjime përfaqësimi" të ndryshme. Rreth viteve 1952-54, beteja ndërmjet realizmit socialist (kryesisht akademik) dhe modernizmit në Jugosllavinë Socialiste përfundoi me fitoren e modernizmit. Kështu, që nga vitet 1960, memorialet kryesore jugosllave që i përkujtonin "ushtarët e rënë" (pali borci) dhe "viktimitat e fashizmit" (žrtve fašizma) fituan forma abstrakte, pra, moderne; megjithatë, njëkohësisht me këto produksione të inicuaruara e të financuar nga Shoqata e Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare (Savez boraca Narodnooslobodilačkog rata), monumentet e bazuara në përfaqësim figurativ vazhduan të ndërtoreshin anëmbanë Jugosllavisë deri në fund të viteve 1980, dhe shpesh mbështeteshin nga organizatat lokale të veteranëve. Edhe nëse këto monumente të bazuara në përfaqësimet ikonike apo realiste të trupave njerëzore (si rregull, trupa meshkujsh) mund të duken sikur ofrojnë një identifikim dhe pranim më të lehtë nga "njerëzit," memorialet e krijuara në mënyrë abstrakte vazhdojnë të ngërthejnë ideologjinë e njëjtë: mungesa e "humanizmit" (që kuptohet si mungesa e përfaqësimeve trupore) solli praninë e skulpturave gjigante abstrakte të quajtura "trupa organike" (si rregull, të bazuar në forma falike siç janë obeliskët, cilindrart, format e ngritura) që përsëri ngërthejnë retorikën e fuq-

isë, dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme – militarizmi. Një ndërrim tematik ndodhi në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970. Derisa “skulpturat revolucionare” të prodhuara deri në atë kohë e reinskenonin fitoren e luftës dhe mposhtjen e fashizmit, prodhimet më të vonshme moderniste të memorialeve, të ndërnuara në “vendndodhjet e Revolucionit” tentonin që kujtesa e luftës të merrej si revolucion socialist: kjo ndodhi rreth tridhjetë vjet pas luftës, kur kujtesat për të fillonin të zbeheshin dhe kishin pak domethënie për gjeneratat e reja. Për më tepër, komplekset memoriale, të dizajnuara nga artistët dhe/ose arkitektët siç janë Bogdan Bogdanović, Dushan Xhamonja, Slavko Tihec dhe Miodrag Živković dhe të ngritura në vendndodhjet natyrore ku kishin ndodhur fitoret e partizanëve, nënkuptojnë edhe një aspekt: ato sugjerojnë se revolucion i është një proces i natyrshëm. Prandaj, duhet të hiqet dorë nga dualizmi tradicional ndërmjet procedurave reprezentative (figurative) dhe atyre joreprezentative (abstrakte). Në vend të kësaj, duhet pyetur se si monumentet aktivisht kanë bërë një hapësinim të ideologjisë komuniste, ku ndarja ndërmjet përfaqësimit ikonik dhe atij joikonik vështirë se luan ndonjë rol.

Që nga shfaqja e ideologjive nacionaliste në Jugosllavi në fund të viteve 1980, tradita antifashiste iu ekspozua një amnezie kolektive, dhe në shumë (në mos në gjithë) shtetet postjugosllave ajo mohohet gati tërësisht, apo u fshi në tërësi. Rrërimi dhe shkatërrimi i monumenteve “komuniste” jugosllave ndodhi jo vetëm gjatë luftërve jugosllave të viteve 1990, por edhe më vonë. Monumentet e ngritura (apo të ringritura) në shtetet sovranë postjugosllave përkujtonin heronj dhe viktimat të luftërve (1991 deri 1999) por jo të gjithë prej tyre. Secili shtet-komb ndërtoi monumentet e veta të cilat tani përbëjnë ideologjinë nacionaliste të vështur nga sytë e viktimizimit dhe të vuajtjes kombëtare nën

“fuqitë e huaja” (si rregull, shteti/kombi fqinj), nën “komunistë” dhe madje nën (po aty) “bashkësinë ndërkombëtare.” Kujtesat e ripërsëritura tek monumentet dhe memorialet ‘politike të ndërtuara’ në territoret jugosllave në shekullin XX janë përgjithësisht kujtesat e dhunës dhe, bashkë me të, militarizmit. Megjithatë, do të ishte historikisht e gabuar të supozohej se përfaqësimi dhe referenca ndaj dhunës është specifike për monumentet e ngritura në rajonin tonë “luftëdashës dhe brutal” të Ballkanit. Për më tepër, sikur edhe në pjesët tjera të botës, vetëm monumentet shpesh nuk u ekspozohen dhunës. Në artikullin e tij “Dhuna e artit publik”, historiani amerikan i artit W.J.T. Mitchell dallon dy lloje të dhunës të drejtuar kundër monumenteve dhe veprave tjera publike të artit. Njëra është dhuna “zyrtare” e policisë, fuqisë së legjislativit apo gjyqësorit, siç ishte rasti i heqjes së “Panteonit Komunist” pas vitit 1989, që kryesisht u bazua në vendimet e parlamentit. Tjetra është dhuna “jozyrtare” e ushtruar nga “masat” e hidhëruara. Ai parashtron disa pyetje: “a është artit publik në thelb i dhunshëm, apo është provokim i dhunës? A është e ndërtuar dhuna brenda monumentet në vetë konceptin e tij? Apo dhuna është thjesht një aksident i cili bie mbi disa monumente, çështje e fateve në histori?” Në këtë kontekst, ai na përkujton se prodhimet monumentale përgjithësisht i kushtohen një teme: “Pjesa e madhe e artit publik në botë – memorialet, monumentet, harqet triumfale, obeliskët, shtyllat dhe statujat – ka një referencë dukshme të drejtpërdrejtë në dhunë në formën e luftës apo të pushtimit. Që nga Ozimandi deri te Çezari, Napoleoni dhe Hitleri, artit publik ka shërbyer si një formë e monumentalizimit të dhunës, dhe asnjëherë me më shumë fuqi sesa kur ai e paraqet pushtuesin si një njeri të paqes, duke imponuar një kod napoleonik apo një pax Romana mbi botën”. Historiana

hungareze e artit, Katalin Sinkó, e cila diskuton rreth heqjes së monumenteve të ndërmarrë nga regjimi komunist në vendin e saj të lindjes, thekson ndoshta aspektin më të rëndësishëm të shfityrimit të monumenteve: “Shkatërrimi i statujave si veprim ritual dëshmohej domethënësisht vetëm në një mjedis i cili e kupton dhe e pranon kuptimin e akteve të tilla simbolike”. Prandaj, në ditët e para të Mbretërisë jugosllave, të gjitha gjurmët e mbretërisë austro-hungareze u hoqën; ato monumente të dinastisë Karagjorgjeviq të cilat nuk ranë nën forcat okupuese të Luftës së Dytë Botërore sakaq u shfityruan pas vitit 1945 nga ana e autoriteteve komuniste; dhe pas shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë, shtetet-kombe që rezultuan filluan ta përvetësonin identitetin e tyre të ri duke i rishikuar kujtesat (nacionaliste), dhe kështu duke u angazhuar në një “punë kujtese” e cila, siç thekson Gillis, është “sikurse çdo punë tjetër fizike, e gërshtuar në marrëdhëniet komplekse klasore, gjinore dhe të fuqisë që përcaktojnë se çka kujtohet (ose harrohet), nga kush, dhe me cilin synim.”

Sa i përket pyetjes së parashtruar në konceptin e këtij projekti, “A ka elemente pajtimi në kulturën e monumenteve në ditët tona?”, përgjigjja ime është negative. Ndërsa duket disi e logjikshme të ndërtohet Memoriali i Hebrenjve të Vrarë të Evropës (2006) në Berlin, pyetja është se ku do të ishte “e logjikshme” të ndërtohej një memorial për viktimat në Srebrenicë. Në Beograd, natyrisht. Por, kush do (guxonte) ta ndërtonte atje? Unë besoj se monumentet nuk mund të ofrojnë pajtim, por njerëzit nganjëherë munden. Në një performancë publike të mbajtur në Sarajevë në vitin 1998, artisti vizuel kroat Slaven pui për rreth 20 minuta raki kumbulle të Bosnjes dhe grappa të Kroacisë, duke i përzier. Titrat e kësaj performance shkonin: “Duke e pritur Willy Brandt.” Ne vazhdojmë të presim...

Literatura

Baldani, Juraj, *Revolucionarno kiparstvo* (Zagreb: Spektar, 1977)

Franković, Eugen, „Javnost spomenika“, *Život umjetnosti*, No. 2, 1966, p. 18.

Gamboni, Dario, *The Destruction of Art: Iconoclasm and Vandalism Since the French Revolution* (London: Reaktion Books. Gamboni, 1997)

Gillis, John R., „Memory and Identity: the History of a Relationship“, in Gillis, ed., *Commemorations: The Politics of National Identity* (Princeton: Princeton University Press, 1994)

Karge, Heike, *Steinerne Erinnerung – versteinerte Erinnerung? Kriegsdenken in Jugoslawien (1947-1970)*, (Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2010).

Nora, Pierre, „Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire“, in *Representations*, no. 26, Spring 1989.

Mitchell, W.J.T., „The Violence of Public Art“, in W.J.T Mitchell, ed., „Art and the Public Sphere“, (Chicago and London: The University of Chicago Press, 1992)/

Pejić, Bojana, „‘Tito’ or the Iconization of an Idea“, in Dejan Sretenović, Ed., *Novo čitanje ikone* (Beograd: Geopoetika, 1999), pp. 107-155.

Pejić, Bojana, „The Communist Body: Politics of Representation and Spatialization of Power in the SFR Yugoslavia“, doctoral dissertation (in preparation for publishing).

Rajčević, Baša, *Zatrvno i zatrtro - o uništenim srpskim spomenicima* (Novi Sad: Prometej, 2001)

Sinkó, Katalin, „Political Rituals: The Raising and Demolition of Monuments“, in György, Peter and Turai, Hedvig, Eds., *Art and Society in the Age of Stalin*, (Budapest: Corvina, 1992) (German edition: Staatskunstwerk ~ Kultur in Stalinismus, Budapest, Corvina, 1992).

Summers, David, „The Real Metaphor: Towards a Redefinition of the ‘Conceptual Image’“, in Bryson et al., Eds., *Visual Theory*, (New York: Harper Collins, 1991).

yugoslav monuments: art and the rhetoric of power

Dr Bojana Pejić

A monument is namely a public phenomenon; the public is the commission which reasoned it and to which it is dedicated. The physical open space in which a monument exists is technically the only possible medium of the socio-psychological sphere which the monument is intended for: the spiritual reality of its milieu. Publicness is the monument's true nature; this is where the monument grows, stands, or falls: in publicness lies all the magnificence or nothingness of the monument. If it lacks this public dimension, the monument is just a mass, sometimes a good sculpture or something else, but always a misunderstanding that disappears with the monument's removal.

*Eugen Franković, "Javnost spomenika"
(The Publicness of Monuments)*

"Memory attaches itself to sites ..." writes French historian Pierre Nora. Monuments and memorials are indeed such sites. When we try to rewrite today an art history of Yugoslav sites of remembrance, we are facing a depressing fact: such a history has actually never been written. The absence of valuable art historical and theoretical texts about political and "cultural" monuments erected on former Yugoslav territories does not mirror the absence of monuments. On the contrary! Both the first (1918-1941) and the second Yugoslav state (1945-1991/92) manifested a real greed for commemorations and genuine passion for spatialisation of collective memories. Any such project, however, necessitated the implementation of a particular politics of remembrance and these politics are dependent on what is imagined as "collective identity" of a community, a nation, or a state. American historian John R. Gillis stresses that both memories and identities are often attributed the status of unchangeable "material

Even though the fate of Yugoslavia’s disintegration with all its tragic consequences, became fully visible during the war in Bosnia and Herzegovina and was perhaps most notably woven into monuments in the country, not all of the monuments were expressions to constitute ‘political authority’ in times of war. On the contrary, they also symbolise a manifold tradition of diverse cultures that did not form in opposition to each other, but through subtle intertwining and constant interaction which had characterised the way of life in Bosnia and Herzegovina for centuries. The famous ‘Old Bridge’ in Mostar, which was destroyed during fighting in 1993, did not simply represent the identity of one nation, but it rather opened a place for everyday encounters of manifold, intertwining identities from diverse nations.

Remembrance in Bosnia and Herzegovina today

Ultimately, the question arises as to how trauma experienced by the victims during the wars in Bosnia and Herzegovina can be expressed through monuments? In which way can a sculpture commemorate the innocents that perished in the past without fostering the

impression that crimes are the only paradigms to be embedded within the collective memory? Today, no great ideology exists that could give meaning to the victims as part of a vision of future progress and improvement. Hence monuments that could form a new political consciousness are not built anymore. However, a need of the people – of those who survived and feel remorse (among them the author of these lines) – still exists to express closeness to those who have perished. A rare example is the memorial cemetery in Potočari, close to Srebrenica. Through the simplicity of its smooth stone and the names of the deceased written onto it, reflects some sort of relation of the living towards the dead. It does not emphasize the lament over the Srebrenica genocide but rather expresses an overwhelming pain that in its ineffability exceeds rational imagination and understanding. In this way, the monument eludes any narcissistic awareness of collective victimisation, the kind of which, unfortunately, is all too often part of the ritualized and populist discourse of the political and religious elite in Bosnia and Herzegovina.

The current socio-political climate is marked by the Dayton Peace Agreement of 1995 that ended – or better: froze – the war and represents an intersection of contradictory processes that are reflected by newly built monuments. On the one hand, national aspirations exist regarding the separation of territories and their annexation to neighbouring countries,

namely Croatia and Serbia. Thus, in the southwestern Bosnian town of Tomislavgrad, stands a monument showing the medieval Croatian King Tomislav. The monument embodies a mythical past aimed at legitimising national sovereignty over a certain territory as well as state autonomy. Therefore the medieval king represents neither elitism that rises above the working class, nor does he embody any aristocratic or divine nobility. Instead he illuminates the origin of exclusive national will, the power of national unity and harmony. On the other hand, the general commercialization of society stultifies the meaning of public good, leading to the arbitrary placement of cheap symbols and superficial memorial inscriptions. An example is the sculpture ‘Multi-ethnic Man’, a donation from Italy that was placed in the Svjetlost Park in central Sarajevo. In its impersonality and banality, the sculpture seems to deny the very idea of multi-ethnicity.

Today, in order to create a new political community, or a new unity of Bosnia and Herzegovina, it is necessary to consider all lines of separation and the symbolical power that has divided us and which is expressed by sculptures and monuments. Then, finally, we may be able to let out the cathartic cry of ‘liberation from the bloody past’ and thereby at the same time embody the sense for new multi-ethnic unity.

historitë e kontestuarra dhe të kaluarat monumentale: kultura e kujtesës e kroacisë

Dr Vjeran Pavlaković

Monumentet publike janë mbase shembuj më së lehti të dukshëm të kulturës së kujtesës të ndonjë vendi, dhe prandaj janë shpesh në qendër të kundërkthënies gjatë periudhave të tranzicioneve politike. Jugosllavia socialiste ndërtoi mijëra monumente, statuja, dhe pllaka memoriale për ta përkujtuar fitoren partizane në Luftën e Dytë Botërore dhe, më specifikisht, për të siguruar legjitimitet për regjimin e pasluftës. Bashkë me llojet tjera të kujtesës që nuk janë domosdoshmërisht fizike (festat zyrtare, simbolet kombëtare, institucionet, etj.), monumentet luajnë një rol të rëndësishëm në lavdërimin e fitores së kombit dhe në përkujtimin e të vdekurve të tij. Por pikërisht meqenëse janë objekte fizike, qoftë pllakë e gurit që përshkruan ndonjë ngjarje historike apo një hark masiv i fitores, monumentet përfaqësojnë interpretimin zyrtar të regjimit në lidhje me të kaluarën si dhe sfidojnë aftësinë e administratës së re për ta tejkaluar një trashëgimi problematike historike. Andaj, ndërtimi, shkatërrimi, restaurimi apo censurimi i monumenteve të ndonjë vendi u japin hapësirë studiuesve të analizojnë se si elitat politike kërkojnë ta transmetojnë botëkuptimin e tyre ideologjik si dhe mekanizmat që ata i përdorin në formësimin e së kaluarës për legjitimitet bashkëkohor politik. Shpërbërja e komunizmit dhe e shtetit jugosllav nënkuptonte që topografia e monumenteve partizane e kishte humbur funksionin e tij origjinal. Disa monumente morën domethënien

të reja, të tjerët u shkatërruan apo u dëmtuan, dhe në shumë raste u ndërtuan monumente të reja për t'i pasqyruar vendet e pavarura që dikur kishin qenë pjesë e ish Jugosllavisë. Kroacia e ditëve tona, që doli nga shekulli XX traumatik, të karakterizuar nga ngritja dhe rënia e shumë perandorive, shteteve e ideologjive, ofron një rast studimi përndritës rreth asaj se si është definuar (dhe ridefinuar) narrativat historike përmes monumenteve publike, sidomos të atyre që kishin lidhje me Luftën e Dytë Botërore.

Monumentet, ashtu si të gjithë vendndodhjet memoriale, tregojnë jo vetëm ngjarjet historike që elitat kombëtare kërkojnë të mbahen mend, por gjithashtu ato ngjarje të cilat, përmes përjashtimit apo censurimit, duhej të harroheshin. Qeveritë tranzicionale shpesh duhet të merren me trashëgimitë monumentale të paraardhësve të tyre, një detyrë mjaft e frikshme për vendet që dalin nga diktaturat apo nga sistemet tjera politike represive. Për më tepër, këto qeveri ballafaqohen me çështjen nëse hapësirat memoriale do të shërbejnë apo jo si mjete për pajtim apo si linja fajësimi që i përjetësojnë konfliktet e pazgjidhura.

Kujtesa kulturore e Kroacisë gjatë periudhës socialiste përbëhej nga monumentet të cilat jo vetëm që e theksonin aspektin revolucionar të lëvizjes partizane, por edhe i barazonin serbët dhe kroatët në luftën e tyre kundër pushtuesve fashistë dhe kolaboracionistët vendorë. Regji-

mi kolaboracionist i ustashëve gjatë Luftës së Dytë Botërore nisi një kampanjë gjenocidale kundër serbëve, çifutëve dhe romëve si dhe i persekutonte kroatët të cilët e kundërshtonin diktaturën e ustashëve. Ustashët e themeluan Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH – Nezavisna Država Hrvatska), i cili ishte i pavarur vetëm me emër, meqë ishte i ndarë dhe i okupuar edhe nga Gjermania edhe nga Italia dhe njihej vetëm nga regjimet që ishin pro Fuqive të Boshtit. Ata që u vranë duke luftuar në “anën e gabuar” apo ata që u likuiduan në masakrat komuniste të pasluftës u fshinë nga kultura e kujtesës në shtetin e ri jugosllav. Kjo përshinte kolaboracionistë në pjesët tjera të Jugosllavisë, siç ishin çetnikët serbë e malazezë dhe gardat e bardha sllovene. Problemi në Kroaci, sikurse edhe në disa vende ish komuniste si Lituania, Latvia, Estonia dhe Sllovakia, ishte se në vitet e nëntëdhjeta kolaboracionistët u rimodeluan si patriotë dhe antikomunistë, përderisa roli i tyre në Hollokaust si dhe në mizoritë tjera u hoq si një fabrikim komunist.

Prandaj monumentet në Kroaci kishin edhe komponentat ideologjike edhe ato etnike të cilat dallonin nga rajoni në rajon, dërsia shumë familje tjera dhe viktimat të represionit komunist nuk lejoheshin t'i kujtonin publikisht të vdekurit e tyre. Në vitet 1950 dhe 1960, memorialet shpesh gërshetonin përshkrime heroike të luftëtarëve partizanë apo vuajtjet e viktimave të terrorit fashist. Shumë partizanë paraqiteshin në fushëbetejë apo duke mbajtur

armët e tyre, derisa një motiv tjetër i përhapur i shfaqte partizanët duke i bartur bashkëluf-tëtarët e tyre të plagosur. Gratë përgjithësisht paraqiteshin si nëna që vajtonin apo si viktimat civile, edhe pse herë-herë ato mund të shiheshin duke mbajtur pushkë në dorë, siç është rasti te monumenti qendror në Sisak. Ani pse Partia Komuniste e kishte fjalën e fundit për rregullimin e përmbajtjes së monumenteve, nismat dhe stilet lokale dhe rajonale linin të kuptohej se kujtimi i luftës nuk ishte vetëm një proces nga lart poshtë, por negociohej me grupet e ndryshme të interesit. Në Istria, monumentet përmbanin edhe tekste kroate edhe ato italiane, dhe e theksonin faktin se ky rajon iu “kthye” vendlindjes kroate pasi kishte qenë nën sundimin fashist italian që nga Lufta e Parë Botërore. Në Dalmaci, shëmbëlltyra e rezistencës daj sundimit venecian u inkorporua në disa memoriale, siç janë ato në ishullin Korçula. Në pjesët e Kroacisë kontinentale me shumicën e popullatës kroate, tekste të statuave dhe pllaka i referosheshin një të ardhmeje më të mirë të ofruar nga revolucioni komunist. Për serbët e Kroacisë, rezistenca antifashiste u bë pjesë përbërëse e identitetit të tyre, dhe monumentet nëpër komuna me shumicë serbe funksiononin si kujtesa të terrorit ustash. Këto memoriale shpesh përdornin alfabetin cirilik i cili, në vitet e nëntëdhjeta, shihej nga nacionalistët kroatë si element i huaj në projektin e dëshiruar të shtetndërtimit.

Në vitet 1960 u shfaqën trende të reja në ndërtimin e monumenteve që kishin lidhje me Luftën e Dytë Botërore: dizajne abstrakte të cilët më nuk përhapnin troç mesazhe ideologjike, por ishin vepra arti estetikisht të sofistikuar që e tejkalonin dogmatizmin rigjid të diktaturës së mëhershme komuniste. Format kolosale të Dushan Xhamonjës (siç është monumenti në Podgariq) si dhe misticizmi simbolik i Bogdan Bogdanoviçit (i ilustruar me shembull të Lulja e Jasenovacit) paralajmëronte një periudhë të re të monumenteve që përfaqësonin produksion artistik unik dhe autokton në shkallë të gjerë. Frymëzimet eksperimentale në produksionin e monumenteve asnjëherë nuk u bartën sa duhet në dizajnimin e njëjësive të banimit, të cilat në masë të madhe rezultuan në komplekse apartamentesh njëblloko, të hirta dhe depersonalizuese që ende shërbejnë si paralajmërime të të metave të utopisë socialiste të premtuar nga regjimi.

Shpërthimi i dhunës në vitet e nëntëdhjeta, dështimi i monopolit komunist mbi narrativat historike, si dhe urgjenca për formë të reja apo paraprakisht të shtypura të kujtesës kolektive nënkuptonin që lufta e përgjakshme e Kroacisë për pavarësi u përcoll me një sulm mbi simbolet fizike të regjimit të kujtesës kolektive mbi trashëgiminë monumentale. “Cenzurimi” i monumenteve partizane përfshinte jo vetëm heqjen e tyre nga ana e autoriteteve të reja, por edhe vandalizmin, dëmtimin nga armët e ndryshme, shkatërrimin komplet nga paramili-

tarët apo nga ushtarët kroatë, dhe ndërtimin e monumenteve të reja me kundërnarrativa që e shfaqësonin regjimin ustash nga karakteristikat e tij fashiste. Sulmet nga ana e Ushtrisë Popullore Jugosllave, të cilët akoma përdornin simbolet komuniste në vitin 1991, i provokoi ata që luftonin për pavarësi të Kroacisë ta shfryënin inatin e tyre në monumente që gjithashtu përmbanin shëmbëlltyrë komuniste. Shoqata e Veteranëve Antifashistë e Kroacisë vlerësoi se në vitet 1990 u dëmtuan apo u shkatërruan mbi tre mijë memoriale partizane, dhe në disa raste sulmet vazhduan në dekadën e ardhshme: monumenti i Heronjve Popullorë në varrezën kryesore në Zagreb u dëmtua në vitin 2001, monumenti i Titos në qytetin e tij të lindjes në Kumrovec u shkatërrua në vitin 2004 dhe monumenti i viktimave serbe në fshatin Prkos u dëmtua rëndë në vjeshtë të vitit 2010.

Sulmi i dhunshëm mbi monumentet partizane në vitet 1990 ishte më shumë një rivlerësim i së kaluarës; ishte një goditje sistematike mbi vlerat antifashiste në të cilën bazohej Evropa pas vitit 1945. Për më tepër, ishte dukshëm një përpjekje e nacionalistëve radikalë për ta shlyer kujtesën e minoritetit serb të Kroacisë. Për shembull, emrat e viktimave të një masakre të ustashëve në Glina, duke përfshirë civilë që u varrosën të gjallë në një kishë, u hoqën nga vendndodhja e monumentit që e përkujtonte tragjedinë, derisa shtëpia memoriale u shndërrua në një qendër kulturore kroate. Shumë monumente tjera pa simbo-

le të dukshme komuniste prapëseprapë u shkatërruan apo u dëmtuan rëndë. Shkalla e dukshme e kësaj kulture të amnezisë tregon se shteti i Kroacisë në vitet 1990 lejonte sulmin mbi monumentet partizane, sidomos kur meret parasysh se asnjë individ asnjëherë nuk u persekutua për dëmin ndaj trashëgimisë kulturore të vendit. Shkatërrimi i monumenteve ishte i shtrirë sidomos në rajonet që ishin prekur më së shumti nga lufta, siç është Dalmacia, Lika, Banovina, Korduni, dhe Sllavonia. Për më tepër, një kulturë tërësisht e re e kujtesës që ka të bëjë me Luftën Atdhetare e transformoi peisazhin e karakterizuar me monumente që pasqyronin estetikën dhe narrativat e shtetit-komb kroat. Rreziku është se përsëri “ana e gabuar”, në këtë rast komuniteti serb i Kroacisë (në veçanti viktimat civile të luftës), po përjashtohet nga politikat kulturore të kujtesës të shtetit; me fjalë tjera, gabimet e regjimit të kaluar po përsëriten.

Pas vdekjes së presidentit Tuxhman më 1999, klima politike ndryshoi dukshëm ashtu që përdorimi i hapur i simboleve fashiste nuk tolerohej më dhe që monumentet e shkatërruara dalëngadalë mund të restauroheshin. Presidentët Stjepan Mesi (2000-2010) dhe Ivo Josipović (2010-aktual) dhanë kontribut në ndryshimin e qëndrimit të shtetit ndaj trashëgimisë antifashiste, duke përfshirë rindërtimin e monumenteve të shkatërruara dhe duke mbështetur një kulturë të kujtesës që e promovonte pajtimin. Prapëseprapë ndarja e

qartë e Kroacisë dhe fantazmat e Luftës së Dytë Botërore vazhdojnë të ndikojnë edhe në politikën vendore edhe në atë të jashtme. Rindërtimi i monumentit të shkatërruar partizan në qytetin Srb, vendndodhje e kryengritjes masive në vitin 1941, përfaqësonte një ndryshim në të gjitha nivelet kombëtare karshi marrëdhënieve partizane dhe serbe-kroate, por grupet djathtiste organizuan një kundër-komemoracion që dëshmon se narrivat e kontestuara rreth së kaluarës ende luajnë rol në vendndodhjet e caktuara të kujtesës. Një hap tjetër historik u ndërmor në tetor 2010, kur presidenti Josipović mori pjesë në zbulimin e një monumenti që u kushtohej nëntë viktimave serbe në moshë, të vrarë në fshatin Varivode si rrjedhojë e Operacionit Stuhia (1995), e që ishte hera e parë që një monument zyrtar të ndërtohej për viktimat serbe të Luftës Atdhetare. Kjo ishte një shenjë e qartë se ai do të vazhdonte ta ndiqte premtimin e tij për t'i nderuar viktimat nga të gjitha palët, jo vetëm nga Lufta e Dytë Botërore por edhe nga konfliktet më të vonshme, në një përpjekje për t'i depolitizuar këto kujtesa traumatike. Sidoqoftë, zgjatja e plagëve të luftrave të viteve 1990 lë të kuptohet që duhet të kalojë më shumë kohë para se historia e Luftës së Dytë Botërore të pushojë së qeni fushëbetejë e politikave bashkëkohore në ish Jugosllavi.

contested histories and monumental pasts: croatia's culture of remembrance

Dr Vjeran Pavlaković

Public monuments are perhaps the most readily visible examples of a country's culture of remembrance, and are therefore also often at the center of controversies during periods of political transitions. Socialist Yugoslavia built thousands of monuments, statues, and memorial plaques to commemorate the Partisan victory in the Second World War and, more specifically, to provide legitimacy for the postwar regime. Along with other types of remembrance which are not necessarily physical (public holidays, national symbols, institutions, etc.), monuments play an important role in celebrating a nation's victories and commemorating its dead. But precisely because they are physical objects, whether a stone plaque describing a historic event or a massive victory arch, monuments both represent a regime's official interpretation of the past as well as challenge a new administration's ability to overcome a problematic historical legacy. Thus the construction, destruction, restoration, or censorship of a country's monuments allows scholars to analyze how political elites seek to transmit their ideological worldview and the mechanisms they use in molding the past for contemporary political legitimacy. The dissolution of communism and the Yugoslav state meant the topography of Partisan monuments lost their original function. Some monuments obtained new meanings, others were destroyed or damaged, and in many

cases new monuments were built to reflect the independent countries that used to be part of the former Yugoslavia. Modern-day Croatia, emerging from a traumatic twentieth century characterized by the rise and fall of multiple empires, states, and ideologies, provides an illuminating case study in how its historical narrative has been defined (and redefined) through public monuments, especially those related to the Second World War.

Monuments, like all memorial sites, indicate not only the historical events national elites want remembered, but also those events which, through exclusion or censorship, ought to be forgotten. Transitional governments often have to deal with the monumental legacies of their predecessors, an especially daunting task for countries emerging from dictatorships or other repressive political systems. Moreover, these governments are faced with the question of whether or not memorial spaces will serve as tools for reconciliation or as fault lines that perpetuate unresolved conflicts.

Croatia's cultural memory during the socialist period consisted of monuments which not only emphasized the revolutionary aspect of the Partisan movement, but the equality of Serbs and Croats in fighting against the fascist occupiers and domestic collaborators. The Ustaša collaborationist regime during the Second World War in Croatia embarked on a genocidal campaign against Serbs, Jews,

and Roma, and persecuted Croats who opposed the Ustaša dictatorship. The Ustaše established the Independent State of Croatia (NDH – Nezavisna Država Hrvatska), which was independent in name only, since it was divided and occupied by both Germany and Italy and was recognized only by pro-Axis regimes. Those killed in fighting on the "wrong side" or those who were liquidated in post-war communist massacres were erased from the culture of remembrance in the new Yugoslav state. This included collaborators in other parts of Yugoslavia, such as Serb and Montenegrin Četniks and Slovenian White Guards. The problem in Croatia, as in some other former communist countries such as Lithuania, Latvia, Estonia, and Slovakia, was that in the 1990s the collaborators were recast as patriots and anticommunists, while their role in the Holocaust and other atrocities was dismissed as a communist fabrication.

The monuments in Croatia, thus, had both ideological and ethnic components which varied from region to region, while many other families and victims of communist repression were not allowed to publicly remember their dead. In the 1950s and 1960s, the memorials often featured heroic depictions of Partisan fighters or the suffering of victims of fascist terror. Many Partisans were shown in battle or carrying their weapons, while another common motif depicted Partisans carrying wounded comrades. Women were generally shown as

grieving mothers or civilian victims, although occasionally they could be seen carrying a gun in their hand, as on the central monument in Sisak. Although the Communist Party ultimately regulated the content of the monuments, local and regional initiatives and styles meant that remembrance of the war was not just a top down process, but was negotiated with various group interests. In Istria, the monuments featured both Croatian and Italian texts, and emphasized the fact that this region was "returned" to the Croatian homeland after being under fascist Italian rule since the end of the First World War. In Dalmatia, imagery of resistance to Venetian rule was incorporated into some memorials, such as the ones on the island of Korčula. In parts of continental Croatia with mostly Croat populations, the texts on statues and plaques referred to the better future offered by the communist revolution. For Croatian Serbs, the antifascist resistance became an integral part of their identity, and monuments in municipalities with a Serb majority functioned as reminders of the Ustaša terror. These memorials often used Cyrillic script, which in the 1990s was seen by Croatian nationalists as a foreign element in the desired state-building project.

By the 1960s new trends appeared in the construction of monuments related to the Second World War: abstract designs that no longer bluntly delivered an ideological message, but were aesthetically sophisticated works of art

transcending the rigid dogmatism of the early communist dictatorship. Dušan Džamonja's colossal shapes (such as the monument in Podgarić) and Bogdan Bogdanović's mystical symbolism (exemplified in the Jasenovac Flower) heralded a new era of monuments which represented unique and autochthonous artistic production on a large scale. The experimental inspirations in monument production never quite transferred to the design of housing units, which for the most part resulted in monolithic, grey, and dehumanizing apartment complexes that still serve as warnings to the flaws of the socialist utopia promised by the regime.

The outbreak of violence in the 1990s, the collapse of the communist monopoly on historical narratives, and the emergence of new or previously suppressed forms of collective remembrance meant that Croatia's bloody war for independence was accompanied by an attack on the physical symbols of the former regime, namely the monument heritage. The "censorship" of Partisan monuments included not only their removal by the new authorities, but vandalism, damage from various weapons, complete destruction by paramilitaries or Croatian soldiers, and the erection of new monuments with counter narratives absolving the Ustaša regime of its fascist characteristics. The attacks by the Yugoslav People's Army, which still used communist symbols in 1991, provoked those fighting for Croatian indepen-

dence to vent their anger at the monuments which also featured communist imagery. The Association of Antifascist Veterans of Croatia estimated that over three thousand Partisan memorials were damaged or destroyed in the 1990s, and in some cases the attacks continued into the following decade: the monument to the People's Heroes in Zagreb's main cemetery was damaged in 2001, Tito's monument in his hometown of Kumrovec was destroyed in 2004, and a monument to Serb victims in the village of Prkos was heavily damaged in the fall of 2010.

The violent attack on the Partisan monuments in the 1990s was more than just a reevaluation of the past, but a systematic assault on the antifascist values that modern Europe was based upon after 1945. Furthermore, it was evidently an effort by radical nationalists to erase the memory of Croatia's Serb minority. For example, the names of the victims of an Ustaša massacre in Glina, including civilians who were burned alive in a church, were removed from the site of the monument commemorating the tragedy, while the memorial house was transformed into a Croatian cultural center. Many other monuments without overt communist symbols were nevertheless destroyed or heavily damaged. The sheer scale of this culture of amnesia indicates that the Croatian state in the 1990s tolerated the attack on Partisan monuments, especially when it is taken into consideration

that no individuals were ever prosecuted for the damage to the country's cultural heritage. The devastation of the monuments was particularly extensive in regions mostly affected by the war, such as Dalmatia, Lika, Banovina, Kordun, and Slavonia. Moreover, an entirely new culture of memory related to the Homeland War transformed the scarred landscape with monuments that reflected the aesthetics and state-building narratives of the Croatian nation-state. The danger is that once again the "wrong side", in this case the Croatian Serb community (specifically civilian victims of the war), is being excluded from the cultural memory politics of the state; in other words, the mistakes of the previous regime are being repeated.

After Tuđman's death in 1999, the political climate changed enough that the open use of fascist symbols was no longer tolerated and that the destroyed monuments could slowly be restored. Presidents Stjepan Mesić (2000-2010) and Ivo Josipović (2010-present) were instrumental in changing the state's attitude towards the antifascist legacy, including the rebuilding of destroyed monuments and fostering a culture of remembrance that promotes reconciliation. Yet Croatia's red-black divide and the ghosts of the Second World War continue to affect both domestic and foreign politics. The rebuilding of the destroyed Partisan monument in the town of Srb, site of a massive uprising in 1941, represented a

shift at the national level towards the Partisans and Serb-Croat relations, but right-wing groups organized a counter-commemoration that indicate that contested narratives over the past still play out at certain sites of memory. Another historic step was taken in October 2010, when Josipović attended the unveiling of a monument to nine elderly Serb civilians killed in the village of Varivode in the aftermath of Operation Storm (1995), the first time an official monument was built for Serb victims of the Homeland War. This was a clear sign that he would continue to pursue his promise to honor the victims from all sides, not only from the Second World War but from more recent conflicts, in an effort to depoliticize those traumatic memories. However, the lingering scars of the wars in the 1990s means that still more time needs to pass before the history of the Second World War ceases to be a battleground for contemporary politics in the former Yugoslavia.

Lufta e simboleve: kujtesa në Kosovë

Shkëlzen Maliqi

Pas një periudhe prej disa dekadash në Jugosllavinë socialiste, kur memorialet në Kosovë synonin përfaqësimin e një kujtese të përbashkët, në vitet '90 të shekullit të kaluar ndodhi thyerja e sistemit dhe shpërbërja e federatës, që e përmbysi edhe rendin e pretenduar simbolik të “kujtesës së përbashkët socialiste”. Kujtesat në Kosovë u ndanë radikalisht ashtu siç u ndanë aspiratat politike dhe territoriale midis dy komuniteteve etnike kryesore, të shqiptarëve që përbëjnë rreth 88 % të popullatës, dhe të serbëve që janë nën 10 %. Kujtesa e materializuar në memorialet e shqiptarëve nuk përputhet më në asnjë pikë me kujtesën dhe memorialet serbe.

Çka kujtojnë dhe festojnë shqiptarët, serbët e refuzojnë, dhe e kundërta, çka kujtojnë dhe festojnë serbët, e refuzojnë shqiptarët. Në vend të fjalës ‘refuzim’ mund të themi edhe ‘urretje’, dhe nuk do të ishim gabim, por gjeneralizimi që zakonisht nuk preferohet në përshkrimin e fenomeneve sociale më është dukur më pak i gabueshëm nëse ky fenomen përshkruhet si ‘refuzim’. Kjo lë mundësinë për një çikë respekti për kujtesën dhe heronjtë e tjetrit, por definitivisht konstaton se nuk ekziston asnjë hero dhe asnjë kujtesë që simbolizon ndonjë vlerë të përbashkët. Për më shumë, memorialet ekzistuese në Kosovë, të vjetrat dhe të rejtat, shërbejnë si pretekst për të vazhduar luftën simbolike mes dy popujve. Fushëbeteja kryesore në këtë çarje të memorieve prek kryesisht trashëgiminë historike dhe religjioze

të kohëve më të lashta, por edhe atë të kohëve më të reja.

Ajo çka serbët duan ta kujtojnë si vende të shenjta janë manastiret mesjetare, sidomos Patrikana e Pejës, si seli historike e Kishës Ortodokse Serbe, ku bëhet inaugurimi solemn i patrikut serb. Ndërkaq, nga monumentet bashkëkohore serbët e Kosovës (dhe ata në Serbi) rëndësi të veçantë i japin Kullës së Gazimestanit që është ndërtuar në vitin 1952 dhe që kujton Betejën e Kosovës të vitit 1389. Kjo betejë ka qenë fatale për mbretërinë serbe mesjetare sepse shënon ngjarjen pas së cilës Serbia u pushtua nga Perandoria Otomane. Kulti modern i shënimit të kësaj beteje në Ditën e Shën Vedit (serbisht: Vidovdan), që festohet me 28 qershor, ka marrë një kuptim tjetër, atë të rikthimit ose të hakmarrjes historike, sepse serbët që tubohen te Kulla e Gazimestanit thonë se kujtojnë amanetin e trimave ose betimin e Shën Vedit (që quhet “vidovdanski zavet”) që sipas tyre ka këtë porosi: “Kosova ka qenë, është dhe do të mbetet përgjithmonë serbe”. Humbja e sërishme e Kosovës në vitin 1999, kur NATO intervenoi, ka ringjallur mitin e “betimit të Vidovdanit”, të humbjes së sërishme që një ditë do të kthehet në fitore.

Për shqiptarët, ndërkaq, kremtimi i Shën Vedit dhe i betejës së humbur është pa kuptim. Konsiderohet një mit i konstruktuar i nacionalizmit serb që bazohet në shtrembërimin dhe përvetësimin e historisë. Historianët shqiptarë, dhe jo vetëm shqiptarë, duke u mbështetur në dëshmitë historike, për betejën e Kosovës

thonë se nuk ka qenë vetëm betejë serbe me otomanët, por ka qenë konfrontim i një ushtrie të përbërë prej forcave krishtere nga Ballkani, ku kanë marrë pjesë edhe princërit shqiptarë.

Konsiderata speciale e serbëve thotë se manastiret dhe kishat mesjetare në Kosovë janë diçka si tapi historike që Serbisë ua garanton sovranitetin mbi Kosovën. Historiografia dhe publicistika shqiptare e kundërshton këtë duke e relativizuar përkatësinë serbe të tyre. Një pjesë e kësaj trashëgimie, ajo më e vjetra është bizantine, kurse Serbët e kanë pushtuar dhe sunduar Kosovën në shekujt XIII dhe XIV, në kohën kur edhe shqiptarët, si popullsi autoktone, kanë qenë të krishterë. Andaj mendohet se i takon një historie dhe tradite që pjesërisht ka qenë e përbashkët. Por, nga ana tjetër, islamizimi i pjesës dërmuese të popullsisë shqiptare gjatë pushtimit otoman, si dhe përdorimi i gjatë i kësaj trashëgimie nga Kisha Ortodokse Serbe, ka bërë që kjo trashëgimi të perceptohet si serbe dhe e huaj për shqiptarët.

Duke bërë garë me pretendimet historike serbe, ideologët e Kosovës shqiptare nuk insistojmë në trashëgiminë e përbashkët të këtij tabani kulturor bizantin, por theksojnë simbolet identitare të veçanta nga kohët më të lashta para ardhjes së serbëve (në përgjithësi, sllavëve) në Ballkan. Këto simbole përfshijnë simbolet e Dardanisë antike, pastaj ato nga koha e rezistencës së lavdishme të shqiptarëve ndaj pushtuesit otoman (që përmbledhet në kultin e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skenderbeut), si dhe ato nga koha

e vetëdijesimit dhe zgjimit të kombit modern shqiptar. Për këtë të fundit, vend i shenjtë konsiderohet Monumenti i Lidhjes së Prizrenit, një kompleks muzeal në qytetin e Prizrenit. Atje, në vitin 1878, ishte mbajtur kongresi historik i parisë shqiptare ku është nxjerrë programi me të cilin është kërkuar krijimi i një shteti të pavaruar shqiptar.

Siç u cek në krye të artikullit, ndasitë dhe konfliktet rreth Kosovës që kanë zgjatur dy shekujt e fundit, nuk kanë lënë hapësirë për krijimin e kujtesës dhe monumenteve që do të simbolizojnë jetën e përbashkët, ose të ndonjë veçantie të Kosovës që do të përkrahej nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Andaj edhe nuk ka memoriale nga kjo kohë që i dedikohen kujtesës dhe respektit të përbashkët të të gjithë Kosovarëve.

Vetëm në një periudhë të shkurtër pas Luftës së Dytë Botërore, nga viti 1945 e deri nga fundi i viteve '80, në Kosovë u krijuan kushtet për ngritjen e përmendoreve që synonin “përbashkësinë” dhe respektin e të gjithëve. Komunizmi triumfalist i kohës së Josip Broz Titos pretendonte se ka siguruar barazi për të gjitha kombet dhe kombësitë që jetonin në Jugosllavi. Në këtë kohë edhe në Kosovë u ngritën shumë monumente që i kujtojnë momentet e lavdishme të revolucionit dhe komunizmit, ose që i bëjnë homazh dëshmorëve të luftës antifashiste.

Monumentet më të rëndësishme kanë qenë ato që kanë kujtuar betejat e aradhave parti-

zane në Kosovë, p.sh. monumenti i xehhtarëve partizanë në Mitrovicë. Në kategorinë e parë të kujtesës dhe festimeve kanë qenë monimentet për nder të herojnëve dhe martirëve të shquar të luftës antifashiste, si përmendorja e Boro Vukmiroviciqit dhe Ramiz Sadikut në Prishtinë. Në të vërtetë, në çdo komunë të Kosovës ka pasë lapidare, busta, varreza të dëshmorëve dhe parqe memoriale. Në këto vende mbaheshin tubimet vjetore për të përkujtuar heroizmin, sakrificën e martirëve dhe fitoren e revolucionit.

Në Kosovë më i përhapuri ka qenë kulti i Boro Vukmiroviciqit dhe Ramiz Sadikut, dy shokë dhe udhëheqës të lëvizjes komuniste nga Peja, të cilët janë pushkatuar në Landovicë afër Prizreni, më 14 prill 1943. Kjo histori e martirizimit mësohej nëpër shkollat e Kosovës dhe përmendej në diskursin publik në çdo rast si shembull i internacionalizmit dhe vëllazërim-bashkimit. Shumë shkolla, institucione e rrugë e kanë mbajtur emrin Boro e Ramiz. Këtë emërtim e ka mbajtur edhe një kompleksi i madh sportiv, tregtar dhe kulturor, që është ndërtuar në vitet '70 në qendër të Prishtinës. Por kjo ka qenë mbase ndërmarrja e fundit në Kosovë që e ka simbolizuar politikën zyrtare komuniste të ish federatës jugosllave mbi barazinë e kombeve dhe kombësive.

Karshi Kosovës kjo politikë ka qenë kontradiktore. Në vitet '50 dhe '60 ka pasur elemente të përndjekjeve dhe terrorit të vrazhdtë policor, ndërsa nga fundi i '60 dhe në vitet '70 është mundësuar që Kosova dhe shqiptarët të

gëzojnë një autonomi të zgjeruar. Sidoqoftë, pas vdekjes së Titos, sërisht kthehet metoda e terrorit policor, që shkoi deri në abrogim të autonomisë dhe luftën e viteve 1998-1999.

Pas ndryshimeve që kanë ndodhur në Kosovë nga fundi i viteve '80 dhe në vitet '90, monumentet e kohës së socializmit janë shkatërruar ose janë lënë jashtë çdo respekti dhe kujdesi institucional. Sikur që praktikisht brenda natës është tretur ideologjia titiste dhe premtimi i bashkim vëllazërimit (Titoja e përsëriste vazhdimisht, në çdo fjalim të tij "Bashkim vëllazërimi i kombeve jugosllave duhe të ruhet si bebëzat e syrit", ndërkaq që Jugosllavia pas tij do të shpërbëhet me një seri luftërash vëllavrasëse!), brenda natës do të zhduket edhe kujtesa dhe respekti për monumentet e revolucionit dhe bashkim-vëllazërimit.

Një pjesë e këtyre monumenteve është shkatërruar, sidomos bustet në vendet publike, por edhe komplekset e mëdha memoriale, si ato të Caralevës dhe Landovicës. Varrezat e dëshmorëve në Prishtinë tani janë jashtë funksionit, aty janë varrosur disa dëshmorë të luftës së fundit në Kosovë. Në një pjesë të saj, në vitin 2006, është varrosur dr. Ibrahim Rugova, presidenti i parë i zgjedhur i Kosovës (në atë kohë nën protektoratin e OKB, jo e pavarur). Disa përmendore tjera të LNÇ-së, si ajo në qendrë të Prishtinës, në Karagaq të Pejës etj., kanë qenë të minuara pa sukses ose është kërkuar heqja e tyre, por kanë mbijetuar kryesisht falë ndërkombëtarëve. Sot gjendja e tyre është e mjerë, mungon kujdesi

dhe respekti, dhe është vetëm çështje ditësh kur do të menjahohen.

Në vend të monumenteve të vjetra dhe të kohës së komunizmit, pas vitit 1999, në Kosovë janë ngritur disa qindra monumente dhe busta që kujtojnë luftën e fundit dhe martirët e saj. Pos monumenteve të heronjëve të rezistencës ilegale dhe luftës së UÇK-së, Adem Jashari (Prekaz), Zahir Pajaziti (Prishtinë), Agim Ramadani (Gjilan), Fehmi Agani (Prishtinë), janë ngritur edhe monumentet e heronjëve historikë – monumenti i Skenderbeut para ndërtesës së qeverisë dhe kuvendit të Kosovës, dhe të personaliteteve të shquara si: Nëna Tereze (Prishtinë), Bill Klinton (Prishtinë), përmendorja falenderuese për fuqitë intervenuese (Monumenti i NATO-s në Prizren).

Karakteristika e shumicës së monumenteve të reja është se nuk e kanë cilësinë e duhur të vendosjes në hapësirë e as cilësitë e realizimit artistik. Monumenti i ngritur për nder të Bill Klintonit është shembull i shtatores së keqe, që është kritikuar edhe publikisht. Për ndërtimin e tij nuk është konsultuar fare komuniteti artistik. Edhe bustet dhe shtatoret tjera që janë vendosur anëmbanë Kosovës, paraqesin një dukuri interesante të vazhdimit të jetës së artit soc-realist, i cili në Kosovë nuk ka ekzistuar më parë, por që pas vitit 1999 ka nisur të "importohet" nga Shqipëria, ku ka qenë stil i obligueshëm në kohën e komunizmit, dhe skulptorët nga ajo kohë, tani po angazhohen në Kosovë.

Nga ana tjetër, monumentet e serbëve të Kosovës që janë ngritur në Kosovë në kohën e sundimit të Milosheviqit, atje ku dominojnë shqiptarët, pas luftës janë hequr, kurse në enklavat serbe ato ende ekzistojnë. Shembull interesant është ai në Mitrovicë, ku ka ndodhur një zhvendosje e shtatores së konsulit rus Shqerbina. Para luftës ai ka qenë në pjesën jugore të qytetit, që tani i takon shqiptarëve, dhe ata e kanë hequr, kurse serbet e kanë rigrur shtatoren e Shqerbinës në pjesën veriore të qytetit. Kështu, përderisa shqiptarët i bëjnë homazhe perindimorëve, serbet e Kosovës shfaqin respekt për Rusinë, sikur ende jemi në kohën e luftës së ftohtë.

Do të duhet mbase edhe shumë kohë që në Kosovë të shfaqet nevoja për përmendore të përbashkëta.

the war of symbols: remembrance in kosovo

Shkëlzen Maliqi

After a period of several decades in socialist Yugoslavia, when memorials in Kosovo tended to represent common culture, the dissolution of Yugoslavia in the 1990s also overthrew the pretended symbolic order of the 'common socialist remembrance of the past centuries'. Remembrance in Kosovo radically broke up just like the political and territorial aspirations of the two main ethnic communities in Kosovo, the Albanians that compose around 88% of the population, and the Serbs that make up less than 10%. The remembrance embodied by the Albanian memorials does not match any more at any point the Serbian remembrance and memorials.

What Albanians celebrate and commemorate is rejected by Serbs, and what Serbs commemorate and celebrate is rejected by Albanians. We could replace the word 'reject' and say 'hatred' instead. We wouldn't be wrong, but such generalisations are usually not preferred in describing social phenomena – however, it seems less wrong if it is described as rejection. This leaves space for a bit of respect for the remembrance and the heroes of the other side, but we definitely come to the conclusion that no hero or remembrance exists that symbolises any common value. Furthermore, existing memorials in Kosovo, both new and old ones, serve as a pretext to continue the war of symbols between the two communities. The main battlefield in this division of remembrance affects the historical and

religious heritage of the most ancient times, yet the most recent times as well.

What Serbs want to commemorate as holy places are the medieval monasteries, most notably the Patriarchate of Peja/Peć, which is the historical seat of the Serbian Orthodox Church where the Serbian Patriarch is solemnly ordained. Meanwhile, Kosovo Serbs (and those in Serbia) give special importance to the Gazimestan Tower, a monument built in 1952 commemorating the Battle of Kosovo in 1389. This battle was indeed fatal for the medieval Serbian kingdom because it marked the event after which Serbia was occupied by the Ottoman Empire. The modern tradition of commemorating this battle on St. Vitus Day (Serbian: Vidovdan) which is celebrated on the 28th of June has taken on a different meaning: the one of return or historical revenge because Serbs that gather at the Gazimestan Tower say that on this day they commemorate both the will of the brave ones and 'St. Vitus' Oath' (Serbian: 'Vidovdanski Zavet') which says: "Kosovo has been, is and will remain Serbian forever." The loss of Kosovo again in 1999, when NATO intervened to help end the Kosovo(-Albanian) - Serbian conflict, has revived the myth of 'St. Vitus' Oath' of the renewed loss that one day will turn into victory.

For Albanians, on the other hand, the celebration of the lost battle and St. Vitus Day is meaningless. They consider it to be a Serbian nationalistic constructed myth based on distortion and appropriation of history. According

to historical evidence of the Battle of Kosovo, Albanian historians, and not only they, claim that it wasn't just a Serbian battle against Ottomans, but that it was a confrontation of joined Christian forces from the Balkans in which Albanian Princes participated as well.

Serbs consider the medieval churches and monasteries in Kosovo as a type of historical possession that guarantees Serbia's sovereignty over Kosovo. Albanian writings and historiography opposes this idea by doubting that these churches and monasteries are only Serbian in their affiliation. The oldest part of this orthodox heritage reaches back to the Byzantine Empire and points to the occupation and rule of Kosovo by Serbs in the 13th and 14th century when Albanians as an indigenous population were also Christian. Therefore it is believed that they share at least part of this history and tradition. However, on the other side stands the Islamisation of the majority of the Albanian population during the Ottoman occupation, as well as the long time use of this heritage by the Serbian Orthodox Church, which has made this Christian heritage be perceived as Serbian.

Despite arguing against Serbian historical claims, Kosovo's ideologues do not insist on the common heritage of this Byzantine cultural subsoil but emphasise the special identity embodied by symbols from ancient times before Serbs (or more generally: Slavs) came to the Balkans. These symbols include the ones of the ancient Dardanians, as well as those of

the Albanians' resistance against the Ottoman invaders (built on the cult of the national hero Gjergj Kastriot Skanderbeg) and those from the time of the awakening of the Albanian modern national revival. For the latter one, a holy place is the monument of the League of Prizren, a museum compound in the town of Prizren. There in 1878, the historical congress of Albanian leaders took place during which the desired program for the making of the Albanian independent state was written and issued.

As stated above, divisions and conflicts over Kosovo in the last two centuries have left no space for creating remembrance and monuments that would symbolise a common life, or any particularity of Kosovo that would be supported by all the communities living there. Therefore there are no memorials from this particular time that are dedicated to the remembrance and mutual respect of all Kosovars.

Only for a short period of time after the Second World War, from 1945 until the late 80s, conditions were created for the construction of monuments that aimed at 'commonality' and respect by everyone. The Communist times under Josip Broz Tito claimed to have provided equality for all the nations and nationalities living in Yugoslavia. At this time, many monuments were built in Kosovo that recalled glorious moments of the revolution and Communism, or those that paid tribute to the martyrs of the anti-fascist war.

The most important monuments were those which commemorate the battles of partisan brigades in Kosovo, such as the monument of partisan miners in Mitrovica. To another category of remembrance and commemorations belonged monuments honouring prominent heroes and martyrs of the anti-fascist war such as the Boro Vukmirović and Ramiz Sadiku monument in Pristina. As a matter of fact, every municipality of Kosovo had its own lapidaries, statues, cemeteries of martyrs and memorial parks. In such places, annual gatherings were organised to commemorate the heroism, sacrifice of the martyrs and the victory of the revolution.

In Kosovo, most widespread was the cult of the Montenegrin Boro Vukmirović and the Albanian Ramiz Sadiku, two friends and leaders of the communist movement from Peja/Peč, who were executed together in Landovica near Prizren, on the 14th of April, 1943. This history of martyrdom was taught in schools throughout Kosovo and mentioned in the public discourse whenever possible as an example of internationalisation, brotherhood and unification. Many schools, institutions and streets were named after Boro and Ramiz— such as a big sports, culture and trade complex that was built in the 1970s in the centre of Pristina. Yet perhaps this was the last enterprise in Kosovo that symbolised the official Communist politics of the former Yugoslav Federation regarding the equality of nations and nationalities.

In spite of this unity, some politics towards Kosovo was contradictory: In the 1950s and 1960s there were elements of persecution and continued brutality by the police, but at the same time, in the late 1960s and the 1970s, this unity made it possible for Kosovo and Albanians to enjoy a wider autonomy. However, after Tito's death there was a return to the methods of police brutality, and even to the abrogation of autonomy as well as eventually the war of 1998-1999.

Following the changes that took place in Kosovo by the end of the 1980s and 1990s, the monuments of socialist times were destroyed or left without respect and institutional care. It seemed as if Titos' ideology and promise for brotherhood and unity practically vanished overnight. (Tito used to repeat himself in every speech he made by saying "The unity and brotherhood of the Yugoslavian nations must be preserved as the pupils of the eyes"; meanwhile, after him Yugoslavia would fall apart in a series of fratricidal wars!). And also the respect for the monuments of the revolution and for brotherhood and unity would disappear overnight as well.

A number of these monuments were destroyed, especially statues in public places, but also big memorial complexes such as the ones of Caraleva and Landovica. The cemeteries of martyrs in Pristina are out of function, some martyrs from the last war in Kosovo are buried there now. In one part of it, the first elected President of Kosovo, Dr. Ibrahim

Rugova, was buried in 2006 (at that time under the UN Protectorate and not an independent state.) Some other memorials of National Liberation War such as the one in the centre of Pristina or the one in Peja/Peč have been unsuccessfully mined or their removal has been requested, but they survived mainly thanks to international intervention. Knowing that the situation for these monuments is dismal, there is lack of respect and care, and it's only a matter of time until they will be removed.

After 1999, in the places of the old Communist monuments, some hundreds of monuments and statues were built in Kosovo that remind us of the last war and its martyrs. Besides the monuments of the heroes of the illegal resistance and the KLA war, Adem Jashari (Prekaz), Zenun Pajaziti (Pristina), Agim Ramadani (Gjilan) and Fehmi Agani (Pristina), monuments of historical heroes have been built as well. Some examples of these are the Skanderbeg Monument in front of the Government and Kosovo Assembly Building, as well as monuments to well known personalities such as Mother Teresa (Pristina), Bill Clinton (Pristina), and the monument thanking the intervening powers (NATO monument in Prizren).

Characteristic of the majority of these new monuments is a lack of quality regarding both the area where they are placed and their artistic value. The monument honouring Bill Clinton is an example of a qualitatively bad monument which has been criticised publicly.

The artistic community was not asked for an idea regarding the building of this monument. Also other statues and monuments built all over Kosovo represent an interesting socialist realism art style, which in Kosovo did not exist before. After 1999, these styles started to be imported from Albania, where they used to be an obligatory style during the time of Communism, and sculptors from that time now are working in Kosovo.

On the other hand, monuments of Kosovo Serbs that were established in the time of Milosevic's ruling were removed after the war in those places where Albanians dominate, whereas they still exist within the Serbian enclaves. An interesting example is the monument to the Russian consul Grigorije Stepanović Ščerbina in Mitrovica. Before the war it used to stand in the southern part of the city, which now belongs to Albanians. They removed it in 2001 and Serbs then reinstated the monument in 2007 in the northern side of the city, which belongs to Serbs. So, while Albanians do homage to the West, Serbs of Kosovo show respect to Russia, as if still living in the time of the Cold War.

Perhaps more time is necessary before the need for common monuments is shown in Kosovo.

arti memorial në serbi nga luftërat ballkanike deri më sot

Mirjana Peitler-Selakov

Nga perspektiva historike dhe politike, secili autoritet i ri i emërtuar definon marrëdhëniet e tij vetanake ndaj të kaluarës; me këtë ai bën rikonstruktimin e historisë dhe ndodhive të kaluara në mënyrën e cila i përgjigjet interesit dhe ideologjisë së tij, e cila gjithashtu përfshin edhe “rikonstruktimin” e hapësirës publike. Në procesin e krijimit të identitetit të komunitetit jugosllav, qoftë ajo në Mbretërinë e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve ose në komunitetin e ri socialist, njëra nga përpjekjet kryesore ishte, padyshim, format e ndryshme të festimit të Luftërave Ballkanike, Luftës e Parë dhe të Dytë Botërore dhe glorifikimin e dëshmorëve të rënë dhe viktimave civile. Përveç analizave të monumenteve dhe memorialëve, perceptimi i tyre në shoqërinë e asaj kohe ishte gjithashtu i rëndësishëm, gjegjësisht theksimi i “lidhjes” së tyre me popullatën. Kjo kryesisht ishte realizuar nëpërmjet të evenimenteve të mbajtura rreth këtyre objekteve – vende të veçanta të memories të cilat krijojnë memorien kolektive dhe krijimin e historisë shtetërore. Memorialët dhe parqet memoriale janë organizuar si vende për përkujtimin edhe të tragjedyve të luftës dhe të heroizmit të luftëtarëve. Qëllimi i tyre ishte të bëjë rikonstruktimin e memories dhe gjithashtu t'i mishërojë ata në të tanishmen. Memoriet gjithmonë paraqesin procesin e rikonstruktimit. Prandaj, ata janë të pandashme në kontekstin social në të cilin ata zënë vend. Në gjithmonë mbajnë mend në varësi të kontekstit në të cilin jetojmë.

Përkujtimi i Dëshmorit të rënë

Simboli i qytetarit – ushtar dhe gatishmëria e tij

për të sakrifikuar veten për atdheun nuk është vetëm glorifikim i memories së luftës, por paraqitet në fund të shekullit të 19-të si një element përforcues i komunitetit dhe me këtë bëhet edhe paradigme e shoqërive të nacionalizuara. Në Serbi, ekziston një numër i madh i monumenteve të cilat janë ngritur në kujtim të dëshmorëve të rënë nga Luftërat Ballkanike dhe që të dy luftërat Botërore. Në veçanti në shoqërinë jugosllave të pasluftës pas vitit 1945, krijimi i monumenteve për ushtarët ishte forma më e shpeshtë e ndërtimit të monumenteve. Simboli i dëshmorit të rënë paraqiste fitoren dhe fuqinë e armatës çlirimtare. Themelimi i Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë në vitin 1943 të Mbledhjen e dytë të KAÇKJ-së (Këshillit Antifashist Çlirimtar Kombëtar të Jugosllavisë) në Jajce nënkuptoi edhe krijimin e një Jugosllavie të re të udhëhequr nga Partia Komuniste dhe një renditje të re shoqërore - socializmi.

Mishërimi i ideologjisë shtetërore

Procesi i okupimit të hapësirës shoqërore, gjegjësisht mishërimi i ideologjisë në të me krijimin e simboleve të reja ideologjike, kishte për qëllim përforcimin e komunitetit kolektiv dhe krijimin e imazhit të shoqërisë së veçantë. Në atë kohë, në veçanti objektet të cilat ruanin kujtimet e viktimave të Luftës së Dytë Botërore ishin të pranishme në hapësirat publike. Kultivimi i dy diskurseve publike – fokusimi në viktimat ushtarake dhe glorifikimi i viktimave civile – që ishte gjithashtu prezent në mënyrë adekuate nga format e monumenteve në hapësirat publike; ushtarët në uniformë ose monumentet për viktimat e fashizmit. Këta objekte shpesh ishin shfrytëzuar

si simbole në procesin e integritit socialist të shteti modern jugosllav. Shtrirja hapësinore e ideologjisë së re vazhdoi paralelisht me shkatërrimin e simboleve të cilët funksiononin në të kaluarën. Të gjitha këta monumente të cilat dëshmonin për ndodhitë historike duhej të zhdukeshin sepse ata tregonin për historinë të cilën komuniteti i ri socialist dëshiron-te ose t'i fshijë ose t'i harrojë ose t'i vendosë ata në kontekstin e ri. Gjithsesi, ndarja midis politikës së Titos dhe Stalinit në vitin 1948 gjithashtu nënkuptonte edhe ndarjen definitive të rrugëve komuniste të Jugosllavisë dhe Sovjetëve. Si kundërpeshë e imazhit të ushtarit të Armatës së Kuqe, paraqitet simboli i partizanit të Jugosllavisë i cili fuqishëm promovonte idenë e luftës çlirimtare partizane dhe rrënjëzimit e tij midis popullatës. Kjo jo vetëm që degradoi rolin e Sovjetëve në një pozitë të nënshtruar, por gjithashtu krijoi një mit lidhur me rrugën socialiste të Jugosllavisë së re, për të cilën të gjithë njerëzit kanë luftuar pa u kursyer.

“Rojet e Memories” Sot

Historiani Maks Bergholc na përkujton në analizat e tij inovative “Në mesin e patriotëve, lakrës, derrave dhe barbarëve: Monumentet dhe varrezat e luftës nacional çlirimtare 1947 – 1965” (Bergholc 2007: 61 – 82) se rojet e memories së luftës nacional çlirimtare pa dyshim ka qenë Shoqata e luftëtarëve të Luftës Nacional Çlirimtare (SUBNOR), organizata e veteranëve partizan e cila ishte themeluar në vitin 1947. Që nga fillimi ishte një organizatë social-politike e krijuar që të jetë “organizatori, agjitor dhe roja kryesore e memories zyrtare politike të regjimit Komunist jugosllav lidhur me luftën” (Bergholc 2007 : 63).

Kjo është e dokumentar në një numër të madh të fjalimeve politike të mbajtura nga Kryetari i atëhershëm Tito, siç ishte fjalimi i tij në Kongresin themelues të partisë: “Ju nuk jeni anëtarë të një organizate të rëndomtë... Detyra e juaj është të jeni në linjë e frontit gjithkund dhe të vazhdoni të kultivoni traditën tonë anëmbanë, të ruani arritjet e mëdha të Luftës Nacional Çlirimtare” (cituar në Bergholc 2007: 63).

Sipas Bergholc-it, veteranët në Jugosllavi shfrytëzonin metoda të ndryshme të krijimit të memories të luftës në dekadat pas Luftës së Dytë Botërore, njëlloj si “aktivistët e tjerë të memories” në Evropë, duke shfrytëzuar shprehjen e thënë nga historiani Xhej Vinter... Përveç krijimit të muzeve, shkrimit të kronikave dhe aktiviteteve të tjera, detyra më e rëndësishme e tyre ishte ndërtimi i monumenteve dhe rregullimi i varrezave të shokëve të tyre të rënë dhe viktimave të tjera të fashizmit.

Aktiviteti i tyre i jashtëzakonshëm në sferën e (ri)-krijimit të memories qartë tregon zgjuarsinë edhe të luftëtarëve edhe të shtetit të cilët përpiqeshin që e tanishmja e tyre të jetë në harmoni me një version specifik të së kaluarës. Në punën e tij hulumtuese lidhur me marrëdhënien midis memories sociale dhe ndërtimit të monumenteve, Bergholc tërheq vëmendjen në çështjen kyçe e cila vështirë që është diskutuar: si reagues qytetarët e Jugosllavisë në mijërat e monumenteve të cilat kujtojnë luftën nacional çlirimtare? A thua ata me të vërtetë pranuan dhe adoptuan “traditën e re” e cila festonte dëshmorët e rënë dhe viktimat e terrorit fashist, dhe a thua këta “kujtues material” inkurajonin

ndërtimin e socializmit? Me fjalë të tjera, a thua qytetarët e rëndomtë, qytetarët e RSFJ, gjithashtu ishin "konsumatorë të këtyre memorieve" (Bergholc 2007: 65)?

Ceremonitë e inaugurimit të monumenteve të reja zakonisht ishin evenimente të fryra me qindra, madje edhe mijëra pjesëmarrës dhe vizitorë. Me pas vijonin vizitat e kompanive, shkollave dhe shoqatave të ndryshme të cilat zakonisht gjithmonë përfshinin vizitat në parqet memoriale dhe varrezat. Kurora me lule dhe lule vendosehin në përvjetorët e tyre. Programet zyrtare të ruajtjes së monumenteve mbaheshin të paprekur pak ose shumë, por Bergholc tregon se interesi i qytetarëve për këta vende ka filluar që të zvogëlohet nga vite e 50-ta. Disa vende ishin lënë pas dore, përreth monumenteve ishte papastërti dhe monumentet ngadalë filluan të shkatërrohen. Disa prej tyre madje edhe kishin humbur vlerën. Në analizën e tij të thellë të këtij fenomeni social, Bergholc tregon se popullata filloi të vërejë bar dhe fara në varreza, derra të cilët kërkonin ushqim rreth monumenteve, si edhe probleme të tjera, dhe filluan të shkruajnë shkronja rreth kësaj në gazeta dhe autoriteteve. (Bergholc 2007: 61 – 82)

Bergholc me bindje diskuton se sjellja e tillë flet për diskrapancën midis aktiviteteve të SUB-NOR-it dhe të memories dhe nivelit të pranimit të këtyre aktiviteteve nga disa pjesë të popullatës. Gjithashtu kjo tregon se aktivistët dhe sistemi nuk mundeshin të shfrytëzojnë ndërtimin e monumenteve për krijimin e një sistemi të veçantë dhe stabil të vlerave. Siç edhe kishte shkruar një aktivist në vitin 1960: "Monumenti duhej që të për-

kujtojë ditët e lavdishme të së kaluarës së afërt dhe të na edukojë. A thua vallë në këtë gjendje që është mund të bëjë këtë?" (Pobeda: këshilli i qarkut të fronit nacionalçlirimtar Krushevc, 21 tetor, 1960, siç citohet në Bergholc, 82)

Kjo dhe pyetjet e tjera të ngjashme lidhur me qëllimin e monumenteve mundet gjithashtu të parashtrahet edhe sot në Serbi, ku nga njëra anë po shkatërrohen dhe prishen monumentet e Luftës së Dytë Botërore, dhe në anën tjetër figurat e memories bizare të "heronjve të dashur" në qendrat e fshatrave dhe qyteteve po bëhen simbole kulturore të atyre rajoneve. Një histeri e re e monumenteve, të cilët disa historianë janë mjaft trima që ta quajnë një "lloj post-modernizmi", është paraqitur në Serbi që nga viti 2007 kur ishte ngritur një monument për Roki Ballboa dhe më pas për Bob Marli dhe Xhoni Dip. Në këtë rast gjithsesi flasim or një lloj të "anti-monumenteve". Ata tregojnë për krizën e gjendjes së identitetit kolektiv i cili gjithashtu buron nga mungesa e heronjve pozitiv të cilët dalin nga konfliktet e dhunshme të cilat vijuan pas shpartallimit të ish Jugosllavisë. Përveç karaktereve të "importuar" të Srgjan Aleksi (përshkrimi i monumentit për Srgjan Aleksi ndërtuar në Pançevë/ Serbi 2010), nuk ekzistojnë personallitete ose heronj të këtyre luftërave me të cilat një person i rëndomtë do të kishte mundur dhe dashur të identifikohet me ta. Në të njëjtën kohë, karakteret e heronjve të filmave të Holivudit dhe muzikantëve kanë një efekt terapeutik. Ata bartin në vete fuqinë e ëndrrave fëmijërore të luftëtarëve për qëllim të mirë dhe një botë më të mirë.

Sot, pas luftërave në territorin e ish Jugoslla-

visë dhe pas themelimit të shteteve të reja, marrëdhëniet ndaj historisë më të re janë më tepër se problematike. Shumë monumente në hapësirat publike po zhvendosen, shkatërrohen, ri-emërtohen ose fshihe. Renditja politike është e bazuar në interesat dhe ndjenjat të cilat mund të jenë edhe me shumë sukses të ndikuara në nivel simbolik. Secila parti politike me këtë edhe formon politikën e saj të historisë. Por, kjo nuk është e gjithëfuqishme dhe as janë simbolet e tyre. Ajo që shoqëria mban mend, ata memorie të cilat ia vlejnë të mbahen mend, nuk mund të vendosen në mënyrë ekskluzive nga politikat sepse ata memorie janë të grupuara thellë në fuqinë e regjimeve personale. Prandaj ruajtja e memories kalon përtej kontrollit të autoriteteve. Ajo është proces i transferimit të legjendave gojore të familjeve, miqve dhe komunitetit, fuqi kjo e cila duhet pasur parasysh nga secila politikë e historisë. Një lloj siç bëjnë praktikatat e reja të artit në drejtimin e monumenteve.

Bibliografia

Assmann, Aleida: Erinnerungsräume. Formen und Eandlungen des kulturellen Gedächtnisses, C.H.Beck, München, 1999.

"Među rodoljubima, kupusom, svinjama i varvarima: spomenici I grobovi NOR-a, 1947-1965 godine," Godišnjak za društvenu istoriju, godina. XIV, sveska 1-3, (Beograd, 2007), 61-82.

Časopis: Godišnjak za društvenu istoriju, Udruženje za društvenu istoriju, Beograd, 1-3, 2007.

Fulgosi, A. et al: Mesta stradanja žrtava fašističkog terora na području grada Beograda, Elaborat grupe autora, Zavod za zaštitu spomenika kulture grada Beograda, Beograd, 2008.

Grupa autora, Kultura sjećanja: 1945, Disput, Zagreb, 2009.

Halbëachs, Maurice : Les Cadres sociaux de la mémoire, Paris, 1952.

Nora, Pierre: Between Memory and History, trans. Marc Roudebush, Representations 26, Paris, 1989.

Pejić, Bojana: „Postkommunistische Körperpolitik. Die Politik der Repräsentation im öffentlichen Raum,“ in: Die Kunst des Öffentlichen (Hrg. Marius Babias und Achim Könneke). Amsterdam, Dresden: Verlag der Kunst 1998., str. 38-54.

Popović, Biljana et al: Susret sa jakim emocijama, Vodič za primenu programa Istraživanje humanitarnog prava u postkonfliktnom kontekstu, MKCK, Beograd, 2006.

Sturm, Hermann: Denkmal & Nachbild. Zur Kultur des Erinnerns, Klartext Essen, 2009.

memorial art in serbia from the balkan wars until today

Mirjana Peitler-Selakov

From a historical and political perspective, every newly appointed authority defines its own relation towards the past; it is reconstructing thus the history and the past events in a way that suits its interests and its ideology, which includes also the “reconstruction” of public space. In the process of creating the identity of a Yugoslav community, be it the Kingdom of the Serbs, Croats and Slovenes or the new socialist community, one of the key efforts was, without doubt, the different forms of commemorating the Balkan wars, the First and Second World War and the glorification of the fallen soldiers and civilian victims. Besides the analyses of the monuments and memorials, their perception in the society of the time is also significant i.e. the highlighting of their ‘connection’ to the population. This was mostly realised through events held around these objects – unique places of memory which were constructing collective memory and creating the state history. Memorials and memorial parks are organised as places for the commemoration of both war tragedies and the heroism of the combatants. Their purpose was to reconstruct memories and also to embed them into the present. Memories always represent processes of reconstruction. Therefore they are inseparable from the social context in which they take place. We always remember depending on the context we live in.

Commemoration of Fallen Soldiers

The symbol of the citizen-soldier and his readiness to sacrifice himself for the homeland is

not only the glorification of the memory of war but it appears at the end of the 19th century as a strengthening element of the community and becomes thus a paradigm of nationalised societies.

In Serbia, a large number of monuments exist which are made in the memory of fallen soldiers from the Balkan wars and from both world wars. Especially in the post-war Yugoslav society after 1945, the creation of monuments for soldiers was the most frequent monument form. The symbol of the fallen soldier expressed victory and the power of the liberation army.

The foundation of the Federal People’s Republic of Yugoslavia in 1943 at the second meeting of AVNOJ (Anti-Fascist Council of the People’s Liberation of Yugoslavia) in Jajce meant the foundation of a new Yugoslavia led by the Communist Party and a new social order – socialism.

Embedding State Ideology

The process of conquering public space, i.e. embedding ideology in it by creating new ideological symbols, aimed at strengthening the collective community and to create the image of a unique society.

At that time, especially objects which preserved the memories of victims of the Second World War were present in public spaces. The nurture of two public discourses – focusing on military victims and glorifying civilian victims – was also adequately represented by monument forms in public spaces: the soldier in uniform or monuments for the victims of fascism. These objects have frequently been used as symbols in the process of the social

integration of the modern Yugoslav state. The spatialization of the new ideology proceeded parallel to the destruction of symbols which had functioned in the past. All those monuments had to vanish which testified to historical events that the new socialist community wanted either to erase and forget or to put in a new context. However, the division between Tito’s and Stalin’s politics in 1948 also meant the definitive separation of the Yugoslav and Soviet communist path. As the counterpart to the image of the Red Army soldier, the symbol of the Yugoslav partisan appeared which strongly promoted the idea of the partisan liberation battle and its rootedness in the nation. This not only degraded the role of the Soviets to a subordinate position but it also created a myth about the socialist path of the new Yugoslavia for which all its peoples have fought selflessly.

“Guardians of Memory” Today

The historian Max Bergholz reminds us in his innovative analysis “Among patriots, cabbage, pigs and barbarians: Monuments and graves of the national liberation war 1947-1965” (Bergholz 2007: 61-82) that the guardian of the memory of the national liberation war has without a doubt been the Association of Fighters of the National Liberation War (SUBNOR), the organisation of Partisan veterans that was founded in 1947. It was from the beginning a social-political organisation created to be the main “creator, agitator and keeper of the official memory politics of the Yugoslav Communist regime regarding the war” (Bergholz 2007: 63). This is documented in a vast number of public speeches held by the then President

Tito, such as his speech at the founding congress of the party:

“You are not members of an ordinary organisation... Your task is to be in the front lines everywhere and to continue nurturing our tradition everywhere, to preserve the great accomplishments of the National Liberation War” (cited in Bergholz 2007: 63).

According to Bergholz, the veterans in Yugoslavia used different methods of creating memories of the war in the decades after the Second World War, just like other ‘memory activists’ in Europe, to use the phrase coined by historian Jay Winter... Besides creating museums, writing chronicles, and other activities, their most significant task was in building monuments and arranging the graves of their fallen comrades and other victims of fascism. Their extraordinary activity in the field of (re-) creating memories clearly shows the diligence of both the fighters and the state who were striving for their present to be in harmony with this specific version of the past. In his path breaking research on the relationship between social memory and monument building, Bergholz draws attention to a key question that has hardly been discussed: how did the citizens of Yugoslavia react to the thousands of monuments commemorating the national liberation war? Did they really accept and adopt ‘the new tradition’ which celebrated the fallen soldiers and victims of the fascist terror, and did these ‘material reminders’ encourage the building of socialism? In other words, were the ordinary people, the citizens of SFRJ, also the ‘consumers of these memories’ (Bergholz 2007: 65)?

The inauguration ceremonies for new monuments were usually pompous events with hundreds, even thousands of participants and visitors. Later there were visits of companies, schools and different associations that usually included always visits to memorial parks and graveyards. Wreaths and flowers were laid down on anniversaries. The official programs of the preservation of monuments were kept intact more or less, but Bergholz shows that the interest of the citizens for those places already began to decline by the 1950s. Some places were neglected, the surroundings of the monuments were untidy, and the monuments began to slowly dilapidate. Some of them were even desecrated. In his in-depth analysis on this social phenomenon, Bergholz shows that the population started noticing grass and weeds on graves, pigs looking for food around monuments, as well as other problems, and they started writing letters about that to newspapers and the authorities. (Bergholz 2007: 61-82)

Bergholz convincingly argues that such behaviour speaks to a discrepancy between the activities by SUBNOR and the memories and the level of acceptance of those activities by some parts of the population. It also shows that the activists and the system were not able to use the construction of monuments for creating a unique and stable system of values. As one of the activists wrote in 1960: "The monument was supposed to commemorate the great days of the recent past and to educate. Can it do that now, in the condition that it is in?" (Pobeda: okružni odbor jedinstvenog narodnooslobodilačkog fronta Kruševac, Oc-

tober 21, 1960, as cited in Bergholz, 82)

This and other similar questions about the purpose of the monuments could also be asked in Serbia today, where on the one side monuments of the Second World War are being destroyed and deteriorate, and on the other side bizarre memorial figures of 'favourite heroes' in the centre of villages and cities are becoming the cultural symbols of this region. A new monument hysteria, which some art historians are brave enough to call a "kind of postmodernism", has appeared in Serbia since 2007 when a monument was raised for Rocky Balboa and later for Bob Marley and Johnny Depp. Here we are most certainly talking about a sort of 'anti-monuments'. They point to a crisis of the collective state identity which also derives from a lack of positive heroes stemming from the violent conflicts that followed the break-up of Yugoslavia. Apart from the "imported" character of Srdjan Aleksić (description of the monument for Srdjan Aleksić built in Pančevo/Serbia 2010), there are no personalities or heroes of that war which an ordinary person could and want to identify with. At the same time, the characters of Hollywood film heroes and musicians have a therapeutic effect. They carry within them the power of childhood dreams of a fighter for a good cause and a better world.

Today, after the wars on the territory of former Yugoslavia and after the foundation of new countries, the relationship towards the most recent history is more than problematic. Many monuments in public spaces are being moved, destroyed, renamed or erased. The political

order is based on interests and emotions both of which can be very successfully influenced on a symbolic level. Every political party is thus forming its own policy of history. But it is not almighty and neither are its symbols. What societies remember, those memories that are worth keeping, cannot be decided on exclusively by politics because those memories are buried deep inside the power of personal stories. Keeping memories is therefore beyond the control of any authorities. It is the process of conveying oral legends of families, friends and the community, whose power has to be taken into consideration by every history politics. Just like new art practices in the monument discourse do.

Bibliography

Assmann, Aleida: Erinnerungsräume. Formen und Wandlungen des kulturellen Gedächtnisses, C.H.Beck, München, 1999.

Bergholz, Max: "Među rodoljubima, kupusom, svinjama i varvarima: spomenici I grobovi NOR-a, 1947-1965 godine," (Among patriots, cabbage, pigs and barbarians: Monuments and graves of the national liberation war 1947 – 1965), Godišnjak za društvenu istoriju, godina. XIV, sveska 1-3, (Beograd, 2007), 61-82 (Yearbook for social history 1-3) .

Časopis: Godišnjak za društvenu istoriju, Udruženje za društvenu istoriju, Beograd, 1-3, 2007.

Fulgosi, A. et al: Mesta stradanja žrtava fašističkog terora na području grada Beo-

grada, Elaborat grupe autora, Zavod za zaštitu spomenika kulture grada Beograda, Beograd, 2008.

Grupa autora, Kultura sjećanja: 1945, Disput, Zagreb, 2009.

Halbwachs, Maurice : Les Cadres sociaux de la mémoire, Paris, 1952.

Nora, Pierre: Between Memory and History, trans. Marc Roudebush, Representations 26, Paris, 1989.

Pejić, Bojana: „Postkommunistische Körperpolitik. Die Politik der Repräsentation im öffentlichen Raum,“ in: Die Kunst des Öffentlichen (Hrg. Marius Babias und Achim Köneke). Amsterdam, Dresden: Verlag der Kunst 1998., str. 38-54.

Popović, Biljana et al: Susret sa jakim emocijama, Vodič za primenu programa Istraživanje humanitarnog prava u postkonfliktnom kontekstu, MKCK, Beograd, 2006.

Sturm, Hermann: Denkmal & Nachbild. Zur Kultur des Erinnerns, Klartext Essen, 2009.

fytyra ndryshuese e kujtesës fotografitë

Komentet për monumentet i kanë shkruar autorët nga fushat e ndryshme akademike. Edhe pse janë hartuar me kujdes, tekstet përfaqësojnë pikëpamjet e autorëve që jo domosdoshmërisht pasqyrojnë edhe mendimin e *forumZFD*-së apo të partnerëve të tij bashkëpunues. Sidoqoftë, qëllimi i ekspozitës është që të mundësojë dhe të përmirësojë shkëmbimin e vështirimeve, mendimeve dhe perspektivave të ndryshme.

Bosnja dhe Hercegovina

Dr Senadin Musabegović (me Andrea Baotiq)

Kroacia

Dr Vjeran Pavlaković

Kosova

Shkëlzen Maliqi

Maqedonia

Valentino Dimitrovski

Serbia

Mirjana Peitler-Selakov

the changing face of remembrance photographs

The comments for the monuments were written by authors from different academic fields. Even though carefully drafted, the texts represent their authors' points of view which do not necessarily reflect the opinion of *forumZFD* or its cooperation partners. However, the aim of the exhibition is also to allow and promote an exchange of different views, opinions and perspectives.

Bosnia and Herzegovina

Dr Senadin Musabegović (with Andrea Baotić)

Croatia

Dr Vjeran Pavlaković

Kosovo

Shkëlzen Maliqi

Macedonia

Valentino Dimitrovski

Serbia

Mirjana Peitler-Selakov



1928

Monumenti kushtuar ushtarëve të rënë në rajonin e Timokut gjatë luftrave për çlirim dhe bashkim

Vendi: Zaječar, Serbi

Skulptor: Frano Mengelo Dinčiq

Monument to the Fallen Soldiers from the region of Timok in the Wars for Liberation and Unity

Location: Zaječar, Serbia

Sculptor: Frano Mengelo Dinčić

Monumenti në Zaječar, në Serbinë lindore, përkujton ushtarët e rajonit të cilët dhanë jetën në Luftën e Parë Ballkanike (1912-1913) dhe në Luftën e Parë Botërore (1914-1918). Ai ishte zbuluar në qendrën e qytetit gjatë 100 vjetorit të çlirimit nga sundimi osman. Si përgjigje për kryengritjen e parë dhe të dytë të Serbisë kundër sundimit osman (1804-1815), Serbia fitoi statusin e principatës autonome në vitin 1828. Kjo shënoi një hap të rëndësishëm drejt pavarësisht të plotë të Serbisë, gjë që u njoh ndërkombëtarisht gjatë Kongresit të Berlinit më 1878.

Është interesante që mbishkrimi në monument nuk është shumë i qartë në formulimin e përkushtimit. Përdersa i përmend luftrat për çlirim dhe bashkim, mbishkrimi nuk e përmend se cilit bashkim i referohet: bashkimit të serbëve, kroatëve dhe slovenëve në Mbretërinë e Jugosllavisë (të formuar më 1918), apo çlirimit dhe bashkimit vetëm të serbëve? Pas Luftës së Dytë Botërore, në Jugosllavinë e sapoformuar socialiste, monumenti e humbi kuptimin e tij por vazhdoi të shërbejë si vend për vendosje kurorash të luleve dhe ende vizitohej nga organizatat e veteranëve.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë monumentit iu kthye kuptimin i tij: gjatë të nëntëdhjetave, te monumenti filluan të mbahen festime në shenjë përkujtimi të ngjarjeve të shekullit XIX. Qëllimi ishte të forcohej identiteti kombëtar serb duke e ushqyer mitin mbi heroizmin e popullit serb në luftën e tyre për pavarësim.

Monumenti u renovua në nëntor 2008. Çdo vit më 9 maj, kurora lulesh vendosen në monument, por ceremonia përkujtimore nuk mbahet më.

The monument in Zaječar, in eastern Serbia, commemorates soldiers from the region who gave their lives in the First Balkan War (1912-1913) and the First World War (1914-1918). It was unveiled in the city centre on the 100th anniversary of the liberation from Ottoman occupation. As a response to the first and second Serbian uprising against Ottoman rule (1804-1815), Serbia was granted the status of autonomous principality in 1828. This marked an important step towards Serbia's full independence which was internationally recognized during the Congress of Berlin in 1878.

Interestingly, the inscription on the monument is not very precise in the formulation of its dedication. While it mentions the wars for liberation and unity, the inscription does not say which unity it refers to: the unity of Serbs, Croats and Slovenians in the Kingdom of Yugoslavia (formed in 1918) or the liberation and unity of Serbs alone? After the Second World War, in the newly formed socialist Yugoslavia, the monument lost its significance, but it remained a place to lay wreaths and was still visited by organizations of veterans.

Following the disintegration of Yugoslavia, the monument once again gained significance: In the 1990s, celebrations were being held at the place in commemoration of the events from the 19th century. The intention was to strengthen the Serbian national identity by nurturing the myth of the heroism of the Serbian people in their fight for national independence.

The monument was renovated in November 2008. Every year on May 9th, wreaths are laid at the monument, but no special commemorations are taking place any more.



1929
Monumenti
kushtuar Grgur
Ninskit
 Vendi: Split,
 Kroaci
 Skulptor: Ivan
 Meshtroviq
Monument to
Grgur Ninski
 Location:
 Split, Croatia
 Sculptor:
 Ivan Meštrović

Ndërtimi i kësaj statuje për nder të Grgur Ninskit, ipeshkvit të Ninit (900 - 929), provokoi disa nga debatet më të nxehta në Split gjatë periudhës mes luftrave. Historiografia kroate e ka portretizuar tradicionalisht Grgur Ninskin si mbrojtës të identitetit kroat sepse përpjekjet e tij për përdorimin e alfabetit glagolitik dhe të sllavishtes së vjetër në vend të latinishtes për shërbime fetare, çuan në konflikt me Romën, dhe Grguri në fund humbi. Kështu, ai simbolizoi rezistencën kroate ndaj dominimit Italian dhe gjatë viteve të njëzeta të shekullit të kaluar, ai u shfrytëzuar edhe si simbol i jugosllavizmit. Më 1929, statuja e gjatë tetë metra ishte ngritur në peristil në qendër të pallatit Dioklecian në Split, pavarësisht protestës së historianëve të artit (që mendonin se monumenti e dëmtonte hapësirën arkitekturale) dhe të komunitetit Italian të Dalmacisë (që e shihnin atë si kërcënim të drejtpërdrejtë në trashëgiminë italiane të qytetit).

Përmbajtja e fjalimeve politike të dhëna gjatë ceremonisë së zbulimit tregon qartë që ky monument e demarkon territorin kroat dhe përfaqëson fitoren mbi pretendimet italiane në Adriatikun lindor. Gjatë okupimit Italian të Splitit, gjatë Luftës së Dytë Botërore, autoritetet e hoqën monumentin dhe e prenë në copa të cilat i ruajtën në një depo. Gjatë viteve të pesëdhjeta të shekullit të kaluar, autoritetet komuniste e bashkuan monumentin por e vendosën jashtë mureve të pallatit Dioklecian. Sot statuja është zhveshur nga politikat kundërtë-nëse por ende mban në vete aurën e misterit: vendasit e fërkojnë gishtin e madh të këmbës së Grgur Ninskit për fat të mirë.

The building of this statue in honor of Grgur Ninski, Bishop of Nin (900-929), provoked some of the most heated debates in Split during the Interwar period. Croatian historiography traditionally portrayed Grgur Ninski as a defender of Croatian identity because of his efforts to use the Glagolitic script and Old Slavic language in religious services instead of Latin, leading to a clash with Rome that Grgur eventually lost. Thus, he symbolised Croatian resistance to Italian domination, and in the 1920s, was even used as a symbol of Yugoslavism. In 1929, the eight meter high statue was erected on the Peristyle in the centre of Diocletian's palace in Split, despite protests from art historians (who thought the monument ruined the architectural space) and Dalmatia's Italian community (who saw it as a direct threat to the Italian legacy in the city).

The content of the political speeches given during the unveiling ceremony clearly indicate that the monument demarcated Croatian territory and represented a victory over Italian pretensions in the Eastern Adriatic. During the Italian occupation of Split in the Second World War, the authorities removed the monument and had it cut into pieces, which were preserved in a storage facility. In the 1950s, the communist authorities restored the monument, but placed it outside of the walls of Diocletian's palace. Today the statue has been stripped of political controversy, but retains an aura of mysteriousness: locals rub Grgur Ninski's big toe for good luck.



1934

Monumenti kushtuar Petar II Petrović-Njegoshit

Vendi: Trebinje, Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Toma Rosandić

Monument to Petar II Petrović-Njegoš

Location: Trebinje, Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Toma Rosandić

Kjo statujë është një nga monumentet e para të kushtuara Petar II Petrović-Njegoshit (1813-1851), princit-ipeshkvit serb ortodoks dhe sunduesit të Malit të Zi, si dhe poetit të njohur, posaçërisht për veprën epike 'Kurora e Maleve' (Gorski vijenac). Statuja ishte financuar nga diplomati dhe shkrimtari serb Jovan Dučić, si trashëgimi për vendlindjen e tij, Trebinje, në juglindje të Hercegovinës.

Dučić e kishte paraparë që statuja e Njegoshit të jetë një nga statujat e shumëta në alenë e mbushur me poetë dhe artistë serbë. Meqë kjo ide nuk u realizua, Dučić ia dhuroi statujën parkut të qytetit në shenjë përkujtimi të rëndësisë së veprës së Njegoshit për ideologjinë jugosllave. Me rastin e inaugurimit të monumentit, mbreti Aleksandër I Karagjorgjeviq, sunduesi i Mbretërisë së Jugosllavisë, pati shkruar: "Trebinje lindi heronj, shkenctarë dhe poetë, tre llojet më të pastra të burrave. Ky qytet historik gjithnjë ka qenë pararojë e vogël por krenare për atdheun, dhe një mbrojtës me vlerë i besimit në idealin dhe misionin tonë."

Monumenti, edhe pse i fokusuar në rëndësinë e veprës letrare të Njegoshit, u pranua shpejt si monument ekskluzivisht 'pro-serb'. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Trebinje ishte pjesë e 'Shtetit të pavarur Kroat', që ishte armiqësor ndaj popullatës serbe, statuja e Njegoshit, që ishte e konsideruar si 'mbrojtëse e traditës dhe e shpirtit serb', u hoq nga piedestali dhe u var në një dru. Thuhet se kryebashkiaku i komunës së Trebinjes, Muho Resulbegović, e kishte fshehur në bodrumin e një stacioni të zjarrfikësve.

Pas luftës, statuja u kthye në vendin e vet. Ajo qëndroi për një kohë në mesin e busteve kushtuar heronjëve të Luftës Nacional Çlirimtare, në park të qytetit. Shumë nga këto buste u larguan apo u dëmtuan gjatë viteve të nëntëdhjeta. Së voni ka filluar restaurimi i disave nga këto buste, por vetëm i atyre që i janë kushtuar heronjëve që besohet të kenë nacionalitetet serb.

The statue is one of the first monuments dedicated to Petar II Petrović-Njegoš (1813-1851), Serbian Orthodox prince-bishop and ruler of Montenegro as well as a well-known poet, most famous for the epic 'The Mountain Wreath' (Gorski vijenac). The statue was funded by Serbian writer and diplomat Jovan Dučić as a legacy to his home town Trebinje in south-eastern Herzegovina.

Dučić originally envisioned the statue of Njegoš to be one of numerous statues on an alley lined with Serbian poets and artists. Since the idea was not realised, Dučić donated the statue to be part of a city park in commemoration of the significance Njegoš's work had for Yugoslav ideology. On the occasion of the monument's inauguration, king Aleksandar I Karađorđević, ruler of the Kingdom of Yugoslavia, wrote: "Trebinje gave birth to heroes, scientists and poets, three purest types of man. This historical town has always been a small but proud vanguard of the homeland and a valuable guardian of faith in our ideal and our mission."

The monument, albeit focusing the cultural significance of Njegoš's literary work, was soon perceived as being exclusively 'pro-Serbian'. During the Second World War, when Trebinje was part of the 'Independent State of Croatia' which was hostile towards the Serbian population, the statue of Njegoš, considered a 'guardian of tradition and the Serbian spirit', was taken off its pedestal and hung on a tree. Allegedly, the head of the Trebinje municipality, Muho Resulbegović, had it hidden in the basement of a fire station.

After the war, the statue was reinstated at its original place. It used to stand among busts dedicated to heroes of the National Liberation War that were built in the park after the war. Many of these busts were removed or damaged during the 1990s. Recently, the restoration of some of these busts has begun, but only regarding those dedicated to heroes believed to be of Serbian nationality.



1938

**Monumenti kushtuar
Gjorgje 'Karagjorgje'
Petroviqit**

Vendi: Topolla, Serbi
Skulptor: Petar Palaviçini

**Monument to Djordje
'Karadjordje' Petrović**

Location: Topola, Serbia
Sculptor: Petar Palavičini

Ky monument i kushtohet Gjorgje Petroviqit (1762-1817), të njohur nga osmanët si Karagjorgje (në turqisht: 'Gjorgje i ziu'), i cili ka qenë udhëheqësi i Kryengritjes së Parë Serbe (1804-1813) kundër sundimit osman dhe i cili ka qenë përfaqësues i dinastisë Karagjorgjeviq. Monumenti dominon qendrën e qytetit të Topollës, një qytet i vogël në Serbinë qendrore, të ndërtuar nga Karagjorgje prej 1811 deri më 1813, dhe i cili njihet si 'qyteti i Karagjorgjes'. Ai është portretizuar në pozën e fituesit duke e pushuar dorën e djathtë në një shpatë dhe duke e mbajtur kartën e kushtetutës në dorën e majtë. Shpata i ngjan asaj që ai e kishte pranuar nga Cari Aleksandri i I-rë i Rusisë në fillim të kryengritjes, si 'mbrojtës i besimit ortodoks dhe i atdheut'. Karta përfaqëson reformat kushtetuese që Karagjorgje i kishte prezantuar në Serbi gjatë fillimit të shekullit të XIX.

Në Jugosllavinë socialiste, përkujtimet për Karagjorgjen dhe rolin e tij historik ishin të ndaluara. Që nga shpërbërja e Jugosllavisë, përkushtime të shumëta shtetërore e ushtarake, pranë monumentit në Topollë, e shënojnë Ditën Nacionale të Serbisë, çdo vit më 15 shkurt, që është dita kur Kryengritja e Parë Serbe filloi më 1804 dhe kur kushtetuta e parë serbe (ajo e Principatës së Sebisë) hyri në fuqi më 1835. Kështu, karakteri historik i 'Dukës Serb' Karagjorgjes, kontribon në forcimin e identitetit kolektiv serb.

The monument is dedicated to Djordje Petrović (1762-1817), known by the Ottomans as Karadjordje (Turkish: 'Black Djordje'), who was the leader of the First Serbian Uprising (1804-1813) against Ottoman rule and representative of the Karadjordjević dynasty. The monument dominates the city centre of Topola, a small town in central Serbia which Karadjordje built from 1811 until 1813 and which known as the 'City of Karadjordje'. He is portrayed in the pose of a winner resting his right hand on a sabre and holding a constitutional charter in his left hand. The sabre resembles the one he received from the Russian Tsar Alexander I at the beginning of the uprising as the "defender of the Orthodox faith and fatherland." The charter represents the constitutional reforms Karadjordje introduced in Serbia during the early 19th century.

In socialist Yugoslavia, commemorations for Karadjordje and his historical role came to a halt. Ever since the disintegration of Yugoslavia, state and military tributes in front of the monument in Topola mark the National Day of Serbia every year on February 15th, the day when the First Serbian Uprising began in 1804 and when the first Serbian constitution (of the Principality of Serbia) came into effect in 1835. Thus the historical character of the 'Serbian Duke' Karadjordje contributes to the strengthening of a collective Serbian identity.



1948

Monumenti kushtuar Titos

Vendi: Kumrovec, Kroaci

Skulptor: Antun Augustinčić

Monument to Tito

Location: Kumrovec, Croatia

Sculptor: Antun Augustinčić

Monument i Titos në fshatin Kumrovec, vendlindjen e liderit Jugosllav, është një nga statujat më ikonike që i janë kushtuar Titos në kulmin e jetës së tij si komandant i lëvizjës partizane të rezistencës, e që ka funksionuar si komponent i fuqishëm i personalitetit kult të Titos që ka lulëzuar pas vitit 1945. Kopje të monumentit mund të gjenden në republikat tjera të ish-Jugosllavisë. Kumroveci ka funksionuar si vend i rëndësishëm i kujtesës gjatë Jugosllavisë socialiste. Më 1981, Lidhja Komuniste e Kroacisë e hapi një shkollë politike në këtë fshat për t'i trajnuar kuadrot e veta.

Pas vitit 1990, Kumroveci e humbi karakterin e vet politik si dhe funksionet si muze etnografik fshati që paraqet jetën e shekullit të XIX. Sidoqoftë, në dekadën e fundit ai sërish lulëzoi si pikë mbledhëse e të ashtuquajturëve Tito-nostalgjikëve, posaçërisht gjatë fundjavëve më të afërta me 25 majin, dikur festën zyrtare për ditëlindje të Titos.

Në dhjetor 2004, persona të panjohur e kanë detonuar një mjet eksploziv pranë monumentit, duke e shkatërruar atë plotësisht. Shumë njerëz dyshuan që ky veprim ishte 'ndëshkim' për vendimin e një viti më parë të qeverisë, nën presionin e BE-së, për largimin e monumenteve të ustasëve. Monumenti shpejt u restaurua dhe vazhdon të jetë pikë qendrore mbledhëse, gjatë përkujtimeve të majit, i varrosur nën kurora lulesh.

The monument of Tito in the village of Kumrovec, the Yugoslav leader's birthplace, is one of the most iconic statues dedicated to him and shows him in the prime of his life as the commander of the Partisan resistance movement, which functioned as a powerful component of Tito's cult of personality that flourished after 1945. Copies of the monument can also be found in other former Yugoslav republics. Kumrovec functioned as an important site of remembrance during socialist Yugoslavia. In 1981, the League of Communists of Croatia opened a political school in the village to train its cadres.

After 1990, Kumrovec lost its political character, and primarily functions as an ethnographic village museum depicting life in the nineteenth century. However, in the last decade it has once again flourished as a gathering spot for so-called Tito-nostalgics, especially on the closest weekend to 25 May, once an official holiday for Tito's birthday.

In December 2004, unknown persons detonated an explosive device next to the monument, destroying it completely. Many suspected that the action was 'retribution' for the government's decision to remove two Ustaša monuments earlier in the year under pressure from the European Union. The monument was quickly restored and remains a central gathering spot, buried in wreaths and flowers, during the May commemoration.



1953

Memoriali kushtuar 'Betejës së Kosovës' së vitit 1389

Vendi: Gazimestan, Kosovë

Skulptor: Aleksandar Deroko

Memorial to the 'Battle of Kosovo' in 1389

Location: Gazimestan, Kosovo

Sculptor: Aleksandar Deroko

Kulla e Gazimestanit e gjatë 25 metra ('Vendi i Heronjëve') është ndërtuar më 1953 nga arkitekti serb Aleksandar Deroko, dhe e përkujton Betejën e Kosovës të vitit 1389. Memoriali gjendet afër Prishtinës, në një zonë ku supozohet që beteja është zhvilluar. Nga brenda, kulla është e dekoruar me fjalë nga këngë epike kushtuar betejës së zhvilluar midis osmanëve të udhëhequr nga Sulltan Murati i I-rë dhe forcat e krishtera nga i tërë Ballkani, nën udhëheqjen e princit serb Lllazar Hrebeljanović. Nga fund i luftës, udhëheqësit e të dyja anëve u vranë. Konsiderohet që kjo ka qenë ngjarja kyçe pas së cilës Ballkani u okupua nga Perandoria Osmane për pothuajse 500 vite.

Gjatë viteve të fundit, Gazimestani është shndërruar në një vend kult për shumë serbë, në veçanti pas qershorit të vitit 1989, kur u festua 600 vjetori i betejës mesjetare. Slllobodan Millosheviq, asokohe president i Republikës Socialiste të Serbisë në kuadër të federatës së Jugosllavisë, organizoi një ceremoni që u vijua nga qindra mijëra serbë. Përmes fjalimit të tij kryesor, Millosheviq fuqizoi pronësinë historike serbe mbi Kosovën.

Pas intervenimit të NATO-s në Kosovë më 1999, kulla e Gazimestanit ishte nën mbrojtjen e trupave të KFOR-it, dhe që nga deklarimi i pavarësisë së Kosovës më 2008, vendi mbikëqyret nga policia e Kosovës. Serbët ende mbledhen atje për ditën e Shën Vidit (serbisht: Vidovdan), por zakonisht janë grupe të vogla që mbikëqyren nga policia. Shumë shqiptarë të Kosovës e kritikojnë faktin që monumenti përkujton vetëm heronjtë serbë të betejës – si Millosh Obiliqin, kalorësi që, sipas legendës, e vrau Sulltan Muratin dhe i cili konsiderohet hero kombëtar serb. Sidoqoftë, ushtria e udhëhequr nga princi Lllazar ishte e përbërë nga luftëtarë nga i gjithë Ballkani, përfshirë edhe princa shqiptarë.

The 25 metre tall Gazimestan ('Place of Heroes') Tower was built in 1953 by the Serbian architect Aleksandar Deroko and commemorates the 'Battle of Kosovo' in 1389. It stands near Pristina in the area where the battle presumably took place. On the inside, the tower is decorated with the words of epic songs dedicated to the battle fought between Ottoman forces led by Sultan Murat I and Christian forces from throughout the Balkans commanded by Serbian prince Lazar Hrebeljanović. By the end of the battle, the leaders of both sides were killed. It is considered the key event after which the Balkans were occupied by the Ottoman Empire for almost 500 years.

In recent years, Gazimestan has become a cult place for many Serbs, especially after June 1989, when the 600th anniversary of medieval battle was celebrated. Slllobodan Milošević, at the time president of the Socialist Republic of Serbia as part of the Yugoslav federation, organised a big ceremony which was attended by hundred thousands of Serbs. In a major speech, Milošević reinforced Serbia's historic claim over Kosovo.

After NATO's intervention in Kosovo 1999, the Gazimestan Tower was under protection of KFOR troops, and since Kosovo's declaration of independence in 2008, it has been watched over by the Kosovo Police. Serbs still gather there for St Vitus Day (Serbian: Vidovdan), but usually they are small groups supervised by the police. Many Kosovo-Albanians criticise that the monument commemorates only Serbian heroes of this battle – such as Miloš Obilić, the knight who according to the legend killed Sultan Murat and who is considered a national hero by Serbs. However, the army led by prince Lazar was comprised of fighters from throughout the Balkans, also including Albanian princes.



1961

Monumenti kushtuar Boro Vukmiroviqit dhe Ramiz Sadikut

Vendi: Prishtinë, Kosovë

Skulptor: I panjohur

Monument to Boro Vukmirović and Ramiz Sadiku

Location: Pristina, Kosovo

Sculptor: Unknown

Ky monument i kushtohet malazezit Boro Vukmiroviq (1912-1943) dhe shqiptarit Ramiz Sadiku (1915-1943), dy shokëve dhe heronjëve më të respektuar të luftës antifashiste Nacional Çlirimtare në ish-Jugosllavi. Monumenti gjendet në parkun e qytetit në Prishtinë, ku ishte vendosur më 1961.

Boro dhe Ramizi ishin vrarë nga ushtarët italianë në prill 1943 pasi që ishin zënë robër duke udhëtuar nga Gjakova për në Prizren. Një nga legjendat që përflitet rreth vdekjes së tyre thotë që ushtarët italianë dhe brigadat shqiptare që i kishin zënë robër, i kishin ofruar Ramiz Sadikut që të ikë dhe ta shpëtojë veten, mirëpo ai kishte refuzuar të ndahet nga shoku i tij i armëve, Boro. Vdekja e këtij martiri shqiptar pranë një sllavi (Boro Vukmiroviq ka qenë djali i një malazezi nga Peja) u bë simbol i 'vëllazërim bashkimit' të shqiptarëve me serbo-malazezët.

Më 1999, gjatë një vale të largimit dhe shkatërrimit të monumenteve komuniste apo të kohës së Millosheviqit, edhe busti i Boros u largua. Kështu Ramizi mbeti vetë dhe i 'shpëtuar' në një mënyrë që është krejtësisht në kundërshtim me narrativën origjinale përtej kufijve etnikë. Mesazhi politik prapa shkatërrimit të këtij monumenti mbështetet nga fakti që madje edhe sot asnjë autoritet zyrtar nuk e ka urdhëruar rregullimin e monumentit apo kthimin e emrit të Boros në shumë shkolla në Kosovë që dikur quheshin sipas dy heronjëve, e sot e mbajnë vetëm emrin e Ramizit.

This monument is dedicated to the Montenegrin Boro Vukmirović (1912-1943) and the Albanian Ramiz Sadiku (1915-1943), two friends and most respected heroes of the antifascist National Liberation Movement in former Yugoslavia. It is located in the town park of Pristina, where it was installed in 1961.

Boro and Ramiz were killed by Italian soldiers in April 1943 after they were captured while travelling from Gjakova to Prizren. One of the legends surrounding their death states that the Italian soldiers and Albanian brigades that captured the two offered Ramiz Sadiku to escape and save himself, but he refused to part with his comrade-in-arms and friend Boro. This martyr's death of an Albanian next to a Slav (Boro Vukmirović was the son of a Montenegrin man from Peja/Peć) became a symbol of 'brotherhood and unity' of the Albanian and Serb-Montenegrin population.

In 1999, during a wave of removals and destructions of monuments from communist times and the Milosević era, the bust of Boro was taken down. Thus Ramiz has been left alone and 'saved' in a way which completely contradicts the original narrative of comradeship beyond ethnical borders. The political message behind the destruction of this monument is backed by the fact that until today no official authority has ordered the repair of the monument and that some schools in Kosovo which had initially been named after these two 'heroes', kept the name of Ramiz but removed the name of Boro.



1961

‘Fluturimi i ndërprerë’ – Parku Shumaricë

Vendi: Kragujevc, Serbi

Skulptor: Miodrag Živković

‘Interrupted Flight’ – Park Šumarice

Location: Kragujevac, Serbia

Sculptor: Miodrag Živković

	Ky monument është pjesë e parkut memorial 'Tetori i Kragujevcit' i cili përkujton rreth 7000 qytetarë të Kragujevcit që ishin ekzekutuar nga Wehrmacht-i gjerman në zonën e Shumaricës afër Kragujevcit, në Serbinë qendrore, në tetor 1941.	The monument is part of the memorial park 'October of Kragujevac' which commemorates the around 7000 citizens of Kragujevac who were executed by the German Wehrmacht in the area of Šumarice, near Kragujevac in central Serbia, in October 1941.
	Monumenti 'Fluturimi i ndërprerë' i kushtohet specifikisht mbi 300 nxënësve dhe mësuesve që kanë qenë në mesin e viktimave. Njerëzit e quanin 'Klasa V3' duke iu referuar njërës nga klasët e shkollës së mesme të Shumaricës, që ishte ekzekutuar. Për skulptorin e monumentit, Miodrag Živkovićin, ai përfaqëson një 'gur të thyer i cili përpqet të fluturojë si zog. Fluturimi i tij është ndërprerë dhe ka mbetur në atë vend përgjithmonë, në Shumaricë.'	The monument 'Interrupted Flight' is specifically dedicated to the more than 300 pupils and teachers who were among the victims. People used to call it 'Class V3' in reference to one of the many classes from the secondary school in Šumarice that were executed. For the sculptor of the monument, Miodrag Živković, it represents a "broken stone which is trying to fly as a bird. Its flight has been cut off and it stayed here forever, in Šumarice."
	Edhe pse një debat mbi ndërtimin e parkut memorial kishte nisur më 1952, ai nuk u realizua deri dhjetë vite më vonë. Kjo vonesë mund të shpjegohet me faktin që bëhet fjalë për një komemoracion për viktimat civile e jo për partizanë apo të rënë të luftës Nacional Çlirimtare, dy kategori që gjithnjë kanë qenë prioritet edhe zyrtarisht, gjatë procesit të krijimit të memorialeve kushtuar Luftës së Dytë Botërore.	Although a debate regarding the construction of the memorial park had already started in 1952, it was not realised until ten years later. This delay can be explained by the fact that it is a commemoration of civilian victims and not of fallen partisans or members of the national liberation movement both of whom were officially prioritised in the process of creating memorials related to the Second World War.
	Parku memorial në Shumaricë edhe sot ka vizitorë të shumtë e të rregullt, sikur në ditët e Jugosllavisë socialiste. Përkujtimi i viktimave bëhet zyrtarisht çdo vit më 21 tetor, në 'Ditën e Kujtimit të Viktimave të Luftës së Dytë Botërore'. Kujtimi i viktimave të Kragujevcit ruhet edhe në poemën e njohur 'Përralla e përgjakshme', të shkruar në 1941 nga poetesha serbe Desanka Maksimović. Sot, disa nga këto monumente janë dëmtuar dhe përdhosur me grafitë. Më 2011, një pjesë e pishtarit të monumentit 'Zjarri i përjetshëm i lirisë' ishte vjedhur. Mungesa e fondeve pengon restaurimin e parkut memorial.	The memorial park in Šumarice has as many regular visitors today as it had in socialist Yugoslavia. A commemoration of the victims takes place yearly on October 21st, the official 'Day in Remembrance of National Second World War Victims'. The memory of the victims in Kragujevac is also preserved in the famous poem 'Bloody Fairytale' written in 1941 by the Serbian poetess Desanka Maksimović. Today, some of the monuments have been damaged and desecrated by graffiti. In 2011, a part of the torch from the monument 'Eternal Flame of Freedom' monument was stolen. A lack of financial funds hinders restoration of the Memorial Park.



1961

Monumenti kushtuar heronjëve të Lëvizjes Nacionale Çlirimtare

Vendi: Prishtinë, Kosovë

Skulptor: Miodrag Živković

Monument to Heroes of the National Liberation Movement

Location: Pristina, Kosovo

Sculptor: Miodrag Živković

Monument i kushtuar heronjëve të rënë në Lëvizjen Nacional Çlirimtare ishte ndërtuar në Prishtinë, kryeqytetin e Kosovës, në vitin 1961 nga skulptori Miodrag Živković. Ai gjendet në njërin nga sheshet kryesore të qytetit, midis ndërtesës së Parlamentit të Kosovës dhe ndërtesës së Komunës së Prishtinës. Monumenti përbëhet nga tre pjesë: një obelisk 22 metërsh me tre shtylla që hapen përpjetë si buqetë (nuk shihet në fotografi) dhe një skulpturë që përfaqëson tetë partizanë, të vendosur nja dhjetë metra larg obeliskut. Ato qëndrojnë mbi një plato të gjerë katrore që dikur kishte edhe një fontanë.

Në fjalorin e përditshëm, monumenti ende quhet 'Përmendorja e Vëllazërimit Bashkimit'. Ai ka për qëllim të simbolizojë vëllazërimin dhe bashkimin midis shqiptarëve, serbëve dhe nacionaliteteve tjera. Më 1999, pasi forcat e NATO-s intervenuan në Kosovë, një tentim për ta çuar monumentin në ajër me dinamit, dështoi. Më vonë disa studentë i ngjyrosën figurat e partizanëve me motive nga flamujt e shteteve perëndimore që përkrahin pavarësinë e Kosovës. Sot monumenti është në masë të madhe i degraduar dhe i lënë pas dore. Komuna e Prishtinës ka planifikuar që në të ardhmen e afërt ta rrezojë dhe në vend të tij ta ndërtojë një parking nëntokësor.

The monument dedicated to fallen heroes of the National Liberation Movement was built in the capital of Kosovo, Pristina, in 1961 by sculptor Miodrag Živković. It is located in one of the city's major avenues, between the Kosovo Parliament building and the Pristina Municipality Parliament building. The monument consists of two parts: a 22 metre tall obelisk with three poles that open like a bouquet (not visible in the photograph) and a sculpture portraying eight partisan figures placed ten metres in front of the obelisk. They stand on a wide squared plate that once included a fountain.

In everyday language this monument was and still is called 'Memorial of Brotherhood and Unity'. It intends to symbolise brotherhood and unity between Albanians, Serbs and other nationalities. In 1999, after NATO forces intervened in Kosovo, an attempt to damage the monument with dynamite failed. Later, students repainted the partisan figures with the motives of flags of western countries supportive of the independence of Kosovo. Today the monument is considerably dilapidated and not taken care of. The municipality of Pristina has planned to remove it in the near future in order to build an underground garage in its place.



1965

Monumenti kushtuar partizanëve të rënë dhe viktimave të terrorit fashist

Vendi: Sisak, Kroaci

Skulptor: Antun Augustinčić

Monument to Fallen Partisans and Victims of Fascist Terror

Location: Sisak, Croatia

Sculptor: Antun Augustinčić

Sisak është vend i veçantë në kujtesën kulturore të lëvizjes së rezistencës antifashiste sepse ai ishte vendi ku njësi i parë partizan u formua në Kroaci më 22 qershor 1941. Edhe pse shumë memoriale tjera në Sisak janë vende të rëndësishme të kujtimit – kampi i bazës i njësitit të parë partizan në pyllin e Brezovicës, sheshi qendror i Kryengritjes Popullore, si dhe vendi ku dikur kishte qenë një kamp famëkeq i fëmijëve – skulptura masive e Antun Augustinčićit i dominon varrezat e qendrës së qytetit.

Ky monument i ngritur për viktimat e luftës përbëhet nga dy pjesë: një ‘flamur’ të madh trekëndësh, të mbuluar me pllaka mermeri që janë të ngulitura drejt ajrit si vela të anijes, dhe një skulpturë më e vogël që paraqet dy partizanë duke mbajtur shokët e tyre të plagosur. Skulptura e fundit ishte kritikuar nga disa zyrtarë komunistë për shkak të ngjashmërisë me pamjet e Pieta-së religjioze që mund të shihen në rajonin prej nga Augustinčić vjen, Zagorje. Një urnë që mban mbetjet e disa Heronjëve të Popullit dhe revolucionarëve tjerë, gjendet në shkallët nën monumentin flamur.

Monumenti e humbi funksionin e tij të rëndësishëm përkujtimor kur u shemb komunizmi dhe Jugosllavia më 1991, por monumenti i ri i Luftës së Atdheut, i ndërtuar menjëherë pranë monumentit të Augustinčićit, tregon që vendi ende vizitohet nga delegacione antifashiste dhe grupe të veteranëve gjatë ditëve përkujtimore. Aktualisht monumenti është në gjendje të keqe për shkak të shkallëve të prishura, grafitëve dhe pllakave të mermerit të rëna.

Sisak holds a special place in the cultural memory of the antifascist resistance movement because it was the location where the first Partisan unit in Croatia was formed on 22 June 1941. Although many other memorials throughout Sisak denote important sites of remembrance – the base camp of the first Partisan unit in Brezovica Forest, the centrally located Square of the People’s Uprising, and the place where an infamous camp for children had once stood – the massive sculpture by Antun Augustinčić dominates the central town cemetery.

This monument to the victims of war consists of two parts: a large, triangular ‘flag’ covered in marble tiles thrusting into the air like the prow of a ship, and a smaller sculpture depicting two Partisans carrying a wounded comrade. The latter sculpture was criticised by some communist officials because of its similarity to the religious Pieta imagery common in Augustinčić’s native Zagorje region. An ossuary containing the remains of several People’s Heroes and other revolutionaries is located on the steps below the flag monument.

The monument lost its important commemorative function with the collapse of communism and Yugoslavia in 1991, but the construction of a monument to the Homeland War immediately next to Augustinčić’s sculpture means that it is still visited by local antifascist delegations and veterans’ groups during memorial days. It is currently in bad shape due to crumbling stairs, graffiti, and fallen marble tiles.



1966

Lulja e 'Gurtë' e Jasenovacit

Vendi: Jasenovac, Kroaci

Skulptor: Bogdan Bogdanović

Jasenovac 'Stone' Flower

Location: Jasenovac, Croatia

Sculptor: Bogdan Bogdanović

Kompleksi memorial i Jasenovacit vazhdon të mbetet vendi më kontraverz i kujtesës nga Lufta e Dytë Botërore, në Kroaci. Ai gjendet në vendin e një kampi të përqëndrimit që ishte vendosur aty nga regjimi i ustashëve. Edhe pse Jasenovaci ishte vend i Holokaustit ku me mijëra hebrenj e romë janë vrarë, shumica e viktimave ishin serbë të persekutuar nga ustashët. Monumenti nuk ka simbolikë religjioze apo kombëtare, dhe përfaqëson rilindjen dhe jetën. Edhe pse shpesh gabimisht i referohen si 'Lulja e Gurtë', ai në fakt është i ndërtuar nga betoni. Ai është i plotësuar me një muze dhe me disa monumente të tjera në rrethinë që kanë për qëllim përkujtimin e kampeve tjera ose të vendeve të vrasjeve. Prej kur ustashët e shkatërruan kampin original, monumenti i Jasenovacit është struktura dominuese në vend dhe pika qendrore për të gjitha aktivitetet përkujtimore.

Në Jugosllavi, qindra e mijëra nxënës fëmijë e kanë vizituar muzeun dhe paraqitjet e krimeve të ustashëve, ndërsa përkujtimet kanë shërbyer për përf forcimin e numrit zyrtar të viktimave që është 700 mijë. Gjatë viteve të tetëdhjeta, historianë kroatë, në veçanti Franjo Tuđman, ofruan një vlerësim shumë më të vogël të numrit të viktimave, për shkak të besimit se numri është rritur për ta bartur fajin

kolektiv tek kroatët, ndërsa historianët serbë e rritën numrin si dëshmi të natyrës gjenocidale të kroatëve. Jasenovaci dhe monumenti i tij u bënë simbole kryesore në arsyetimin e rebelimit serb kundër, të ashtuquajturit, shtetit të rilindur ustash, gjatë të nëntëdhjetave. Serbët e okupuan Jasenovacin gjatë Luftës së Atdheut (1991 – 1995) dhe organizuan përkujtime me mesazhe që thoshnin që serbët dhe kroatët kurrë më nuk do të munden të jetojnë në të njëjtin shtet.

Pas Operacionit Stuhia (1995), qeveria kroate e ktheu kontrollin mbi Jasenovacin. Monumenti Lule u renovua më 2003, dhe një ekspozitë e re e përhershme u hap në muze më 2006. Që nga viti 2000, qeveria kroate e ripërturi rëndësinë e përkujtimit me qëllim të tërheqjes së vëmendjes për rreziqet e fashizmit, nacionalizmit ekstrem dhe të rehabilitimit të ustashëve gjatë viteve të nëntëdhjeta. Prandaj Jasenovaci poashtu e përfaqëson politikën kundërthënëse brenda Kroacisë, rreth politikave të kujtimit.

The Jasenovac memorial complex remains one of the most controversial sites of remembrance related to the Second World War in Croatia. It stands at the location of a concentration camp, established by the fascist Ustaša regime. Although Jasenovac was a Holocaust site where thousands of Jews and Roma were killed, the majority of the victims were Serbs persecuted by the Ustaše. The monument lacks religious or national symbolism and represents rebirth and life. While it is often mistakenly called the 'Stone Flower', the monument is actually constructed from concrete. It is complemented by a museum and several other monuments in the surrounding area that designated other camps or killing sites. Since the Ustaše destroyed the original camp, the Jasenovac monument is the dominating structure at the site and the focus point of all commemorative activities.

In Yugoslavia, hundreds of thousands of school children visited the museum and its graphic depictions of Ustaša crimes, while the commemorations served to reinforce the official number of 700,000 victims. In the 1980s, Croat historians, notably Franjo Tuđman, offered much lower estimates in the numbers of victims, which he believed was used to place collective guilt on the Croatian people,

while Serb historians increased the numbers as proof of the genocidal nature of Croats. Jasenovac and its monument, thus, became key symbols in justifying the Serb rebellion against an allegedly reawakened Ustaša state in the 1990s. Serbs occupied Jasenovac during the Homeland War (1991 – 1995) and organised commemorations whose message was that Serbs and Croats could never again live together in the same state.

After Operation Flash (1995), the Croatian government restored control over Jasenovac. The Flower Monument was renovated in 2003, and a new permanent exhibition in the museum opened in 2006. Since 2000, the Croatian government restored the importance of the commemoration in order to draw attention to the dangers of fascism, extreme nationalism, and the Ustaša rehabilitation that had taken place in the 1990s. Therefore, Jasenovac also symbolises an inner-Croatian conflict of contradicting policies of remembrance.

MONUMENTI



1971

Monumenti kushtuar themelimit të brigadës Kosmaj

Vendi: Kosmaj, Serbi

Skulptor: Vojin Stojić

Monument to the Founding of the Kosmaj Brigades

Location: Kosmaj, Serbia

Sculptor: Vojin Stojić



1971

Krerët e heronjëve nacionalë: Darinka Radović, Sofija Ristić, Milan Blagojević Španac dhe Millan Ilić Čiča

Vendi: Topolla, Serbi

Skulptor: I panjohur

Heads of National Heroes Darinka Radović, Sofija Ristić, Milan Blagojević Španac and Milan Ilić Čiča

Location: Topola, Serbia

Sculptor: Unknown

Monumenti i gjatë 30 metra i kushtohet ushtarëve të rënë nga brigada partizane Kosmaj, dhe ishte zbuluar në përvjetorin e tridhjetë të themelimit të brigadës së famshme partizane në maje të kodrës Kosmaj, në Serbinë qendrore afër Beogradit. Kjo brigadë është formuar në korrik 1941 dhe është bërë e famshme me pjesëmarrjen në thyerjen e 'Frontit të Sremit' (serbisht: Sremski Front), një linjë e mbrojtjes e mbajtur nga forcat gjermane dhe kroate afër Beogradit, në prill të vitit 1945, gjë që shënoi fundin e Luftës së Dytë Botërore në Serbi.

Monumenti nuk ka qenë vetëm vend për mbajtjen e përkujtimeve por gjithashtu një pikë popullore e pikniqeve. Sot, pak vizitorë vijnë ndërsa monumenti dhe rrethina janë plotësisht të neglizhuar.

The 30 metre tall monument is dedicated to the fallen soldiers of the Kosmaj partisan brigades and was unveiled on the 30th anniversary of the founding of the famous partisan detachment on the top of Kosmaj hill, in central Serbia near Belgrade. The partisan detachment was formed in July 1941 and earned fame for its participation in the breakthrough of the 'Syrmian Front' (Serbian: Sremski Front), a defence line held by German and Croatian forces near Belgrade, in April 1945 which marked the end of the Second World War in Serbia.


The monument used to be not only a place for holding commemorations but also was a popular picnic destination. Today only few visitors come and both the monument and its surrounding have been neglected.

Monumenti i kushtuar katër heronjëve kombëtare nga Lufta e Dytë Botërore gjendet në Serbinë qendrore, në Topollë. Millan Iliq Čiča (1886-1942) mori pjesë edhe në lufrat e Ballkanit e edhe në Luftën e Parë Botërore. Ai ishte pjesë e brigadës partizane të Shumadisë. Më 1944, ai ishte ndër ushtarët e parë që u shpall hero nacional. Darinka Radović (1896-1943) dhe Sofija Ristić (1900-1944) u ofronin strehim partizanëve në shtëpitë e tyre dhe kujdeseshin për ushtarët e lënduar dhe për pjesëtarët e lënduar nga lëvizja e rezistencës serbe. Millan Blagojević Španac (1905-1941) mori pjesë në përgatitjet e kryengritjes dhe në korrik 1941 ai u bë komandanti i parë i brigadës së partizanëve të Shumadisë i cili theu sundimin okupator në atë zonë. Që të tretë u vranë nga çetnikët në mesin e viteve të katërdhjeta dhe u deklaruan heronj nacionalë të Jugosllavisë pas lufte.

Monumenti në Topollë është i veçantë për shkak të përkujtimit të heroinave kombëtare. Në Armatën Nacional Çlirimtare kanë luftuar mbi 100.000 gra, ndërsa nga mbi 25.000 që janë vrarë, 91 janë shpallur heroina nacionale. Sot, monumenti shërben vetëm si objekt për hulumtime shkencore në lidhje me rolin e grave në betejën nacionale dhe pos kësaj, është i harruar.

The monument dedicated to four national heroes of the Second World War is located in the central Serbian town Topola. Milan Ilić Čiča (1886-1942) participated in both the Balkan wars and the First World War. He was part of the partisan brigades of Šumadija. In 1944, he was among the first soldiers to be declared a national hero. Darinka Radović (1896-1943) and Sofija Ristić (1900-1944) were offering refuge to partisans in their homes and caring for both wounded soldiers and leaders of the Serbian resistance. Milan Blagojević Španac (1905-1941) participated in the preparations of the uprising and in July 1941 became the first commander of the Šumadija partisan brigades who crushed the occupational rule of the area. All three of them were killed by Chetniks in the mid-1940s and declared national heroes of Yugoslavia after the war.

The monument in Topola is especially significant for its remembrance of female national heroes. In the National Liberation Army more than 100.000 women were fighting, around 25.000 of whom died, and 91 women were declared national heroes. Today, the monument serves only as an object of scientific research regarding the role of women in the national liberation battle and has otherwise been forgotten.



1972

Monumenti kushtuar viktimave të terrorit fashist dhe luftëtarëve të Luftës Nacional Çlirimtare nga qyteti Sanski Most dhe rrethina e tij

Vendi: Shushnjar (Sanski Most), Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Petar Krstić

Monument to the Victims of Fascist Terror and the Fighters of the National Liberation War from the city Sanski Most and its surroundings

Location: Šušnjar (Sanski Most), Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Petar Krstić

Monumenti është pjesa qendrore e parkut memorial të kushtuar viktimave të fashizmit dhe ushtarëve të Luftës Nacional Çlirimtare (1941-1945) nga Sanski Most, në Bosnje dhe Hercegovinë veriperëndimore.

Në vendin e monumentit, në kodrën Shushnjar afër Sanski Most, fashistët ekzekutuan njëzeteshtatë serbë të Bosnjes në maj 1941, si mënyrë për t'u tërhequr vërejtjen atyre që më parë kishin organizuar një rebelim. Viktimat ishin varrosur në luginën e Shushnjarit e cila më vonë u shndërrua në një varrezë masive për mijëra serbë që u ekzekutuan në gusht 1941. Për shkak të faktit që rreth Sanski Mostit shumë hebrenj ishin vrarë dhe shumë ushtarë nga ajo zonë kishin vdekur në luftë, parku iu kushtua të gjitha këtyre viktimave, pa dallim të fesë apo etnisë. Plakatet memoriale me emrat e tyre shpërblejnë secilin individ veçanërisht, por me rëndësi të barabartë. Gjatë luftës së viteve të nëntëdhjeta, parku memorial u bë viktimë e vandalizmit. Kur autoritetet e Republika Srpskës morën kontrollin mbi Sanski Most, një kryq u ngrit në luginën e Shushnjarit, duke e theksuar kështu besimin ortodoks të viktimave të 1941. Plakatet memoriale me emrat e të rënëve boshnjakë dhe kroatë u hoqën. Ky fokus i ri ekskluziv në krimet e kryera kundër popullatës serbe vetëm sa e përforcoi retorikën nacionaliste dhe praktikën përkujtimore që u ushtruan pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Mohimi i gjithë atyre viktimave të cilat nuk ishin serbe (pos hebrenjëve) kishte për qëllim ndarjen e kroatëve dhe boshnjakëve nga e kaluara e përbashkët. Sot, parku memorial është nën mbikëqyrjen e Federatës së Bosnjes dhe Hercegovinës dhe që nga 2003, është nën mbrojtjen e Komisionit për Ruajtjen e Monumenteve Nacionale të Bosnjes dhe Hercegovinës. Kjo, megjithatë, nuk e ka parandaluar dëmtimin e mëtutjeshëm, tani të drejtuar kah përkujtimi i viktimave serbe: ashtu si shihet në fotografi, fjala 'serbe' është gërvishur dhe fshirë në njërin nga pllakat memoriale. Shpërfillja dhe vandalizimi i monumentit vazhdon të jetë tregues i çështjeve të pazgjidhura historike në të kaluarën e përbashkët antifashiste dhe në të kaluarën pas-Dejtonit në Bosnje dhe Hercegovinë.

The monument is the central part of a memorial park dedicated to the victims of fascism and the fallen soldiers of the National Liberation War (1941-1945) from Sanski Most, in the Northwest of Bosnia and Herzegovina.

At the monument's location, the hill Šušnjar, near Sanski Most, fascists executed twenty-seven Bosnian Serbs in May 1941 as a warning to those who had previously organised a rebellion. The victims were buried at the foot of Šušnjar which would later become a mass grave of several thousand Serbs who were executed in August 1941. Due to the fact that around Sanski Most also numerous Jews were killed and many soldiers from the area died in the war, the park was dedicated to all victims, regardless of their religious or ethnic affiliation. Memorial plaques featuring their names award each victim individual but equal significance.

During the war of the 1990s, the memorial park was subjected to vandalism. When authorities of the Republika Srpska took control over Sanski Most, a cross was erected at the foot of Šušnjar emphasising the Orthodox faith of the victims from 1941. Memorial plaques with the names of fallen Bosniak and Croat soldiers were removed. This new focus exclusively on crimes committed against the Serbian population strengthened the nationalist rhetoric and commemorative practices that occurred with the disintegration of Yugoslavia. The denial of all those victims who were not of Serbian nationality (except for Jews) intended to separate from Croats and Bosniaks as well as from a common past.

Today the memorial park is under the auspices of the Federation of Bosnia and Herzegovina and since 2003 under protection of the Commission to Preserve National Monuments of Bosnia and Herzegovina. This, however, did not prevent further damage, now directed against the commemoration of Serbian victims: as the photograph shows, the word 'Serbs' was scratched out on one of the memorial plaques. Thus the monument's vandalised and neglected state is an indicator of unresolved historical questions of the common antifascist past in post-Dayton Bosnia and Herzegovina.



1973

Monumenti kushtuar 'Heronjëve Minatorë' të Levizjes Nacional Çlirimtare

Vendi: Mitrovicë, Kosovë

Skulptor: Bogdan Bogdanović

Monument to the 'Mining Heroes' of the National Liberation Movement

Location: Mitrovica, Kosovo

Sculptor: Bogdan Bogdanović

Monumenti i dizajnuar nga Bogdan Bogdanović u dedikohet minatorëve shqiptarë e serbë që iu bashkangjitën Levizjes Nacional Çlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe është inauguruar në 1973. I vendosur në kodër mbi qytetin e Zveçanit afër Mitrovicës në Kosovën veriore, monumenti e dominon qytetin i cili konsiderohet të jetë qendra e lëvizjes së klasës punëtore dhe e ideologjisë komuniste në Kosovë.

Monumenti mbahet nga dy shtylla konike dhe simbolizon vagonin i cili tërheq mineralet nga miniera në shkretëtirë. Bazuar në rëndësinë e saj në Jugosllavi, ky ka qenë një nga monumentet më të vlerësuara të regjimit komunist në Kosovë, përcjellur nga monumenti i Landovicës i cili është ndërtuar në kujtim të dy heronjëve, Boro Vukmiroviqit dhe Ramiz Sadikut të cilët ishin vrarë bashkë.

Sot monumenti gjendet në anën veriore të qytetit të ndarë të Mitrovicës, në anën e kontrolluar nga autoritetet serbe. Në këto ditë të ndarjeve etnike dhe konfliktit, monumenti nuk e ka më të njëjtën vlerë, as për shqiptarët e as për serbët.

The monument, designed by Bogdan Bogdanović, is dedicated to local Albanian and Serbian miners who joined the National Liberation Movement during the Second World War and was inaugurated in 1973. Located on a hill overlooking the town Zvečan/Zvečan near Mitrovica in Northern Kosovo, the monument dominates the city that is considered the centre of the working class movement and of communist ideology in Kosovo.

The monument is held by two conic poles symbolising the wagons that haul minerals from the mine to the foundry. Based on its relevance in Yugoslavia, this was the most valuable monument of the communist regime in Kosovo, followed by the monument in Landovica that was built in memory of the two heroes, Boro Vukmirović and Ramiz Sadiku who were shot together.

Today the monument is in the northern part of the divided city of Mitrovica, the part that is controlled by Serb authorities. Nowadays, in times of ethnic division and conflict, the monument does not have any value for either community, neither Serbs nor Albanians.

MONUMENTI



1973

Monumenti kushtuar 'Betejës së Sutjeskës' më 1943

Vendi: Tjentishte, Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Miodrag Živković

Monument to the 'Battle of the Sutjeska' in 1943

Location: Tjentište, Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Miodrag Živković

	Monumenti përkujton ‘Betejën e Sutjeskës’, e cila ishte një nga luftimet më të ashpra të forcave partizane kundër trupave gjermane-italiane. Beteja, e quajtur edhe ‘Ofenziva e pestë e armikut’, ndodhi më 15 maj 1943 në zonën e Malit të Zi, në lindje të Hercegovinës dhe në lindje të Bosnjes. Luftimet e fundit dhe më të përgjakshmet ndodhën buzë lumit Sutjeska dhe në malet në rrethinë.	The monument commemorates the ‘Battle of the Sutjeska’ which was one of the toughest combats of partisan forces against German-Italian troops. The battle, also called the ‘Fifth Enemy Offensive’, took place from May 15th to June 15th 1943 in the area of Montenegro, east Herzegovina, and east Bosnia. The final and bloodiest combats were fought along the Sutjeska River and the surrounding mountains.
	Monumenti, i ngjashëm me të tjerët të ndërtuar pas Luftës së Dytë Botërore, ka për qëllim të përkujtojë sakrificën e bërë në luftën kundër fashizmit me qëllim të krijimit të një rendi të ri social dhe një vetëdijeje të re klasore. Në ‘Betejën e Sutjeskës’ njësitet e rrethuar të Armatës Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë arritën ta thyejnë linjën e armikut numerikisht superior, edhe pse vetë humbën me mijëra të vdekur e të plagosur. Përkujtimi i kësaj ngjarjeje ndikoi në zhvillimin e mitit të fuqisë së popullit jugosllav dhe të gatishmërisë për vetëvendosje politike. Ky ka qenë qëllimi për hapjen e një parku nacional në Sutjeskë, në formën e një kompleksi memorial në qendër të së cilit qëndron monumenti i Miodrag Živkoviçit. Ai përbëhet nga dy forma simetrike e abstrakte që përfaqësojnë brigjet e lumit Sutjeska. Forma e thyer e monumentit sugjeron ‘thyerjen’ e suksesshme nga partizanët dhe fitoren e tyre.	The monument, similar to others built after the Second World War, intended to remind of sacrifices made in the fight against fascism with the aim of creating a new social order and class consciousness. In the ‘Battle of the Sutjeska’, the surrounded units of the National Liberation Army of Yugoslavia succeeded in breaching the lines of a numerically superior enemy, albeit suffering heavy losses of thousands dead or wounded. The commemoration of this event fostered the myth of both the strength of the Yugoslav peoples and their readiness for political self-determination. This was the purpose for opening the national park on the Sutjeska as a memorial complex at the centre of which stands the monument by Miodrag Živković. It is made of two symmetrical and abstract shapes that represent the banks of the Sutjeska River. The broken form of the monument suggests the successful ‘breach’ of the partisans and their victory.
	Gjatë luftës 1992-1995, ky monument dhe park memorial u shkatërruan nga ushtria e Republika Sërpskës. Vetëm monumenti qendror ka mbetur i plotë dhe thuhet se kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së eksplozivit. Sot parku nacional Sutjeska është një nga vendet e pakta ku monumentet që përkujtojnë LNÇ-në po renovohen përmes fondeve zyrtare.	During the war of 1992-1995, many monuments in the memorial park were destroyed by the army of Republika Srpska. Only the central monument remained whole, allegedly because of a shortage of explosives. Today, the Sutjeska national park is one of the few places where monuments commemorating the National Liberation War are actually being renovated through official funding.



1974

'Makedonium'

Vendi: Krushevë, Maqedoni

Skulptorë: Jordan Grabuloski and Iskra Grabuloska (arkitektura), Borko Lazeski (vitrazh) dhe Peter Mazev (plastikë e harkuar)

'Makedonium'

Location: Krushevo, Macedonia

Sculptors: Jordan Grabuloski and Iskra Grabuloska (architecture), Borko Lazeski (stained glass) and Peter Mazev (vaulted plastic)

Monumenti përkujton kryengritjen popullore kundër Perandorisë Osmane, të organizuar nga lëvizja nacionale 'Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedone' (OBRM) në Shën Elia - ose Ilinden - më 2 gusht 1903. Ai është ngritur në qytetin e Maqedonisë jugore, në Krushevë, i cili ka qenë një nga qendrat e revoltës.

Kryengritja 'Ilinden' çoi në shpalljen e 'Republikës së Krushevës' më 3 gusht 1903. Edhe pse të thyer nga osmanët pas 10 ditësh, kjo konsiderohet si një nga pararendësit më të rëndësishëm drejt shtetformimit nacional të Maqedonisë. Në kujtim të këtyre ngjarjeve, 'Dita e Republikës' maqedone festohet çdo vit më 2 gusht.

Ndërtimi i 'Makedonium' rastisi me ratifikimin e kushtetutës së re të Jugosllavisë, më 1974, që i shpërbleu me autonomi më të madhe secilën prej gjashtë republikave të Jugosllavisë. Kushtetuta ishte përgjigje ndaj vetëbesimit në rritje të republikave kundrejt shtetit qendror jugosllav. Në përputhje me klimën e ndryshueshme socio-ekonomike, 'Makedonium' thekson edhe karakterin nacional të Maqedonisë, e edhe pozitën e saj brenda shoqërisë jugosllave. Kjo reflektohet nga referencat artistike e simbolike të ndërtuara në monumentin i cili lidhet me një proces të vazhdueshëm të shtetformimit maqedon: nga 'Kryengritja Ilinden' deri te 'Lufta Nacional Çlirimtare' gjatë Luftës së Dytë Botërore, e drejt formimit të republikës së Maqedonisë brenda Jugosllavisë.

The monument commemorates the popular uprising against the Ottoman Empire staged by the national movement 'Internal Macedonian Revolutionary Organisation' (IMRO) on St. Elias - or Ilinden - Day, August 2, 1903. It was built in the southern Macedonian city Krushevo which was at the centre of the revolt.

The 'Ilinden Uprising' led to the proclamation of the 'Krushevo Republic' on August 3, 1903. Though crushed by the Ottomans after ten days, it is officially considered one of the most significant precursors towards Macedonian national statehood. In remembrance of these events, the Macedonian 'Day of the Republic' is celebrated yearly on August 2.

The construction of the 'Makedonium' coincided with the ratification of a new constitution for Yugoslavia in 1974 which awarded greater autonomy to each of the six Yugoslav republics. The constitution was the response to a growing self-confidence of the republics towards the Yugoslav central state. In line with the changing socio-political climate, the 'Makedonium' accentuates both the national character of Macedonia and its position within a common Yugoslav society. This is reflected by artistic and symbolic references built into the monument which relate to a continuous process of Macedonian nation-building: from the 'Ilinden Uprising' to the 'National Liberation War' during the Second World War towards the formation of a Macedonian republic within Yugoslavia.



1977

Monumenti kushtuar Lirisë

Vendi: Berane, Mali i Zi

Skulptor: Bogdan Bogdanović

Freedom Monument

Location: Berane, Montenegro

Skulptor: Bogdan Bogdanović

‘Monumenti i Lirisë’ në afërsi të Beranes, në verilindje të Malit të Zi, përkujton pjesëmarrjen e popujve nga i gjithë rajoni në luftën çlirimtare gjatë shekujve XIX dhe XX. Historia e këtyre luftërave është shkruar në katërdhjetë blloqe të gurit që gjenden në afërsi të monumentit. Rajoni i Beranes njihet për trazira kundër Perandorisë Osmane gjatë shek. XIX. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913), Berane u çlirua nga osmanët dhe rajoni iu bashkua Mbretërisë së Malit të Zi.

Gjatë viteve në vijim, zhvillimet politike në Evropë patën ndikim edhe në Berane: pas kapitullimit të Malit të Zi nga Austro-Hungaria në Luftën e Parë Botërore, një numër i madh i banorëve u burgosëm; në 1935 u themelua një celulë lokale e partisë komuniste; në prill 1941 zona u okupua nga forcat gjermane dhe italiane; si kundërpërgjigje, brenda një viti u formuan edhe brigadat çetnike e edhe ato partizane. E tërë kjo çoi në luftë midis partizanëve dhe çetnikëve, gjatë së cilës më shumë jetë u humbën se sa gjatë luftërave kundër okupatorëve të huaj. Më 21 korrik 1949, Berane u quajt Ivangrad, sipas Ivan Millutinoviçit, komandantit malazez të Armatës Nacional Çlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore, por në 1992, emri i tij original iu kthye.

Koncepti arkitektural i monumentit është i thjeshtë dhe i integruar në ambientin natyror. Gjuha e tij vizuale shkon përtej kodit estetik socialist të zakonshëm: ai përpqet t’i inkorporojë kulturat e ndryshme etnike dhe religjioze të rajonit, si dhe ideologjitë politike, në një shëmbëlltë të përjetshme arkaike.

The ‘Freedom Monument’ close to Berane, in the Northeast of Montenegro, commemorates the participation of the people from the region in the liberation wars during the 19th and 20th century. The history of these wars is inscribed on forty stone blocks standing in the vicinity of the monument. The region of Berane is known for riots against the Ottomans in the 19th century. During the first Balkan War (1912-1913), Berane was liberated from the Ottoman reign and the region was annexed by the Kingdom of Montenegro.

In the following years, the political developments in Europe also had repercussions for Berane: after Montenegro’s capitulation to Austria-Hungary in the First World War, a large number of inhabitants were taken prisoner; in 1935, a local cell of the communist party was founded; in April 1941 the area was occupied by German and Italian forces; as a response, both Chetnik and Partisan brigades were formed in the same year. All this eventually led to a war between Partisans and Chetniks during which incomparably more lives were lost than in the fight against the foreign occupation. On July 21st 1949, Berane was renamed Ivangrad after Ivan Milutinovic, commander of the Montenegrin arm of the National Liberation Army during the Second World War, but it was given back its original name in 1992.

The monument’s architectural concept is simple and integrated into the natural environment. Its visual language goes beyond the usual socialist aesthetic code: it tries to transcend different ethnic and religious cultures as well as political ideologies of the region and incorporates them into a timeless archaic imagery.



1978

Monumenti Makljen

Vendi: Makljen, Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Boshko Kuqanski

Makljen Monument

Location: Makljen, Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Boško Kućanski

Monumenti Makljen qëndron në një park memorial që përkujton 'Betejën e Neretvës' (të njohur edhe si 'Ofanziva e katërt e armikut' apo 'Beteja e të plagosurve'), që është një nga luftimet më të rëndësishme të LNÇ-së gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjatë aksioneve ushtarake që zgjatën nga janari e deri në prill 1942, partizanët arritën edhe t'i parandalonin Fuqitë e Boshtit nga shkatërrimi i komandës qendrore të LNÇ-së, edhe t'i mbrojnë afro 4.000 të plagosur në spitalin kryesor partizan.

Monumenti Makljen është ndërtuar për t'a përkujtuar fitoren e forcave antifashiste kundrejt një armiku më të fuqishëm, si dhe fitoren e humanizmit. Prandaj skulptori Boshko Kuqanski e konceptualizoi memorialin si 'formë vitale florale' e cila e merr formën nga rrethina shkëmbore. Meqë vendi i këtij monumenti është më i larti në kodrën Makljen, prej aty mund të shikohet një pamje e qartë drejt territoreve ku ndodhi një pjesë e ofanzivës partizane gjatë 'Betejës së Neretvës'.

Monumenti si i tillë, në veçanti pas luftave të viteve të nëntëdhjeta, është interpretuar si simbol i regjimit komunist dhe i së kaluarës socialiste të cilën lëvizjet nacionaliste dëshironin ta theynin. Në 2000, parku memorial Makljen, që ndodhet në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës, u shkatërrua pothuajse tërësisht - bazuar në burime zyrtare - 'nën rrethana të paqarta'. Nga i tërë monumenti, vetëm baza e brendshme e betonit është 'ruajtur'. Që nga 2010, monumenti është nën mbrojtjen zyrtare së bashku me rrethinën natyrore.

The Makljen monument stands in a memorial park which commemorates the 'Battle of the Neretva' (also known as the 'Fourth Enemy Offensive' or the 'Battle of the Wounded'), one of the most significant combats of the National Liberation Army in the Second World War. During the military actions that lasted from January until April 1943, the partisans succeeded both in preventing the Axis forces from destroying the central command of the national liberation movement and in protecting around 4.000 wounded in the main partisan hospital.

The Makljen monument was built to commemorate the triumph of the antifascist forces over a far more powerful enemy as well as the victory of humanitarianism. Therefore sculptor Boško Kućanski conceptualised the memorial in a 'vital floral form' that picks up on the forms of the surrounding rocky hills. As the location for this monument the highest point of the Makljen hill was selected, from where a clear view extends towards the territories where part of the partisan offensives during the 'Battle of the Neretva' took place.

The monument as such, particularly after the wars of the 1990s, was interpreted as a symbol of the communist regime and socialist past which nationalist movements wished to break with. In 2000, the Makljen memorial park, located in the Federation of Bosnia and Herzegovina, was almost entirely destroyed – according to official sources 'under unclear circumstances'. Of the monument, only the inner core of reinforced concrete beams was 'preserved'. Since 2010, it has been under official protection along with its natural setting.



1981

Monumenti në Petrova Gorë

Vendi: Petrovac (Mali Petrova Gorë), Kroaci

Skulptor: Vojin Bakić

Petrova Gora Monument

Location: Petrovac (Petrova Gora Mountain), Croatia

Sculptor: Vojin Bakić

Monumenti në malin Petrova Gora përfaqëson një nga arritjet më të shquara të arkitekturës së monumenteve të Jugosllavisë socialiste. Petrova Gora ka qenë pjesë e rëndësishme e lëvizjes partizane prej kur ka shërbyer si bazë e Partisë Komuniste të Kroacisë, gjatë viteve të para të Luftës së Dytë Botërore. Ai poashtu ka qenë vendi i spitalit qendror fushor partizan. Pos kësaj, ai simbolizon tragjedinë e serbëve të Kroacisë të cilët ishin vrarë në numër të madh nga regjimi i ustashëve në fshatrat në rrethinë.

Autoritetet komuniste e vendosën gurthimin e monumentit të Petrova Gorës në 1946, por për shkak të rajonit të varfëruar, ndërtimi nuk përfundoi deri më 1981. Monumenti u bë famëkeq në mars 1990 për shkak të një përkujtimi të organizuar nga komunistët lokalë të cilët paralajmëruan një ripërtirje të të ashtuquajturve ustashë, në formën e Franjo Tuxhmanit dhe Partisë Demokratike Kroate. Mediat raportuan për prani të çetnikëve dhe nacionalistëve të tjerë serbë, dhe shumë njerëz e interpretuan këtë si një tentim të Beogradit për të manipuluar me frikën e serbëve të Kroacisë në mbrëmjen e zgjedhjeve të para shumëpartiake në Kroaci, që nga Lufta e Dytë Botërore.

Që nga lufta e Atdheut (1991 – 1995), i tërë kompleksi memorial është shkatërruar dhe panelët e çmueshëm metalikë janë vjedhur tërësisht nga lëkura e jashtme e monumentit. Aktualisht, Këshilli Nacional Serb organizon disa aksione punuese çdo vit, për pastrimin e vendit, dhe ekzistojnë disa propozime për renovimin e monumentit dhe shfrytëzimin e tij si muze apo hapësirë artistike. Fatkeqësisht, çmimi i lartë i materialit të përdorur dhe vendi i tij i izoluar e bëjnë të pamundur restaurimin e monumentit në të ardhmen e afërt.

The monument on Petrova Gora Mountain represents one of the most celebrated achievements in socialist Yugoslav monumental architecture. Petrova Gora was an important part of the Partisan movement since it served as the Croatian Communist Party's headquarters during the first years of the Second World War and was the location of the central Partisan field hospital. In addition, it symbolised the tragedy of Croatian Serbs who were killed in large numbers by the Ustaša regime in surrounding villages.

The communist authorities laid the foundation stone of the Petrova Gora monument in 1946, but due to the impoverishment of the region, construction was not completed until 1981. The monument achieved notoriety in March 1990 because of a commemoration organised by local communists who warned of an alleged Ustaša resurgence in the form of Franjo Tudman and his Croatian Democratic Party. The media reported on the presence of Chetnik and other Serbian nationalist imagery, and many perceived it as an attempt by Belgrade to manipulate the fears of Croatian Serbs on the eve of Croatia's first multiparty elections since the Second World War.

Since the Homeland War (1991 – 1995), the entire memorial complex has been devastated and the valuable metal panels that form the monument's outer skin have been systematically stolen. Currently, the Serbian National Council organises several work actions per year to clean up the site, and there are a number of proposals to renovate the monument and use it as a museum or artistic space. Unfortunately, the high cost of the material used in the monument and its isolated location means that it is unlikely for the monument to be restored in the near future.



1982

Monumenti kushtuar luftëtarëve të rënë serbë për lirinë e atdheut 1912-1918 nga shokët e luftës dhe kombi falënderues zahvalnog naroda

Vendi: Kraljevë, Serbi
Skulptor: Živojin Lukić

Monument to Serbian Fighters fallen for the Freedom of the Fatherland 1912-1918 from War Comrades and a Grateful Nation

Location: Kraljevo, Serbia
Sculptor: Živojin Lukić

Idea për ndërtimin e një memoriali për luftëtarët e rënë në lufrat e Ballkanit, së pari lindi në Kraljevë pak pas Luftës së Dytë Ballkanike në 1913. Ndërkaq, realizimi i monumentit përfundoi njëzet vite më vonë, pjesërisht për shkak të Luftës së Parë Botërore. Bazuar në një referendum të qytetarëve, monumenti përfundimisht u vendos në qendrën e qytetit në 1932 (për arsye të panjohura, pllaka memoriale ka të shënuar vitin 1934). Pas dy dekadash, në nëntor 1959, monumenti u largua në bazë të vendimit të komitetit popullor socialist të komunës së Kraljevës, për shkak se sheshi qendror duhej të shndërrohej në varrezë ushtarake. Pas shumë kërkesash nga qytetarët e Kraljevës, monumenti u restaurua zyrtarisht dhe u kthye në vendin e tij original, në tetor 1982.

Monumenti tregon figurën e ushtarit serb të vendosur në një pedestal prej guri. Ana veriore e pedestalit paraqet reliefin e emblemsë nacionale serbe. Të të katër anët e pedestalit përfshijnë qoshe të menduara për pllaka të mermerta me emra të luftëtarëve lokalë që kanë humbur jetën mes viteve 1912 dhe 1918. Për shkak se lista e emrave ishte shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore, në vend të tyre janë instaluar pllaka të bronzit me emra të betejave në të cilat ushtarët serbë u zhdukën gjatë lufrave të Ballkanit si dhe gjatë Luftës së Parë Botërore.

Si tipar qendror i qytetit, monumenti shfrytëzohej si pikë për mbledhime rinore kur shëtitoret e qytetit çonin tek ai. Sot ai është bërë tribunë e popullarizuar për ngjarje politike dhe për vendosje të kurorave në përkujtim të thyerjes së 'Frontit Maqedon (apo të Salonikës)' në 1918, që rezultoi me çlirimin e Serbisë.

The idea of building a memorial to the fighters fallen in the Balkan Wars was first born in Kraljevo shortly after the Second Balkan War in 1913. The realisation of the monument, however, was only finished twenty years later, partly due to the First World War. Based on a referendum among the townspeople, the monument was 1932 finally placed in the city centre (for unknown reasons, the memorial plaque it reads 1934). Another two decades on, in November 1959, the monument was removed by a decision of the socialist people's committee of Kraljevo Municipality because the central square was to be turned into a military cemetery. Following numerous requests by citizens of Kraljevo, the monument was officially restored at its old place in October 1982.

The monument shows the figure of a Serbian soldier set on a stone pedestal. The northern side of the pedestal features a relief of Serbia's national emblem. All four sides of the pedestal include rectangular niches intended for marble plaques with names of local fighters lost their lives between 1912 and 1918. Because the list of names was destroyed during the Second World War, bronze plaques were installed featuring the names of battles in which Serbian soldiers perished in the Balkan Wars as well as the First World War.

As one of the town's central features, the monument used to be a gathering place for youths when the town promenade was leading next to it. Today, it has become a popular tribune for political events and for laying wreaths in commemoration of the breach of the 'Macedonian (also Salonika) Front' in 1918 which resulted in the liberation of Serbia.

MONUMENTI



1990

Monumenti kushtuar Desanka Maksimovićit

Vendi: Valjevë, Serbi

Skulptor: Aleksandar Zarin

Monument to Desanka Maksimović

Location: Valjevo, Serbia

Sculptor: Aleksandar Zarin

Ky monument i kushtohet Desanka Maksimović (1898-1993), njëres nga poetet më të mëdha serbe. Ai është ngritur gjatë kohës sa poetja ka qenë gjallë, në vendlindjen e saj në Valjevë, më 1990. Maksimović protestoi kundër ndërtimit të monumentit, por vendorët e qytetit e bindën atë që ky do të jetë vetëm një monument për poezinë dhe do ta ketë fytyrën e saj. Gdhendja në monument thekson: “Për poezinë nga populli poetik”.

Desanka Maksimović punoi si mësuese e letërsisë serbe dhe ishte anëtarë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë. Ajo është e famshme si poete, tregimtare, novelistë, autore për fëmijë dhe kohë pas kohe edhe si përkthyes. Poezitë e saj janë thirrje që njerëzit të jenë të mirë, fisnikë, krenarë dhe të qëndrueshëm; të respektojnë njerëzit e besimeve, parimeve e mendimeve të ndryshme, si dhe të ngjyryave dhe feve të ndryshme; dhe të jenë striktë ndaj gabimeve të veta si dhe atyre të të tjerëve. Një nga poezitë e saj më të njohura është ‘Përralla e përgjakshme’ (serbisht: Krvava Bajka) të cilën e shkroi pasi që kishte dëgjuar për ekzekutimin e studentëve në Kragujevac, më 21 tetor 1941. Poezia u botua nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, dhe u bë pjesë obligative e çdo planprogrami të shkollave fillore në Jugosllavi. Ajo poashtu inspiroi një film me të njëjtin titull që u realizua në 1969.

Poezia e Desanka Maksimovićit edhe sot është pjesë e planprogramit shkollor fillor në Serbi. Mësimet nga poezia, të kushtuara poezisë së saj, organizohen çdo vit më 16 maj në ‘Sheshin e Poezisë’ në Valjevë. Në atë ditë, poetët më të mirë, fitojnë një shpërblim me emrin e saj, dhe në monumentin në qendrën e qytetit vendosen kurora lulësh.

The monument is dedicated to Desanka Maksimović (1898-1993), one of the greatest Serbian poetesses. It was erected during her lifetime in her hometown of Valjevo in 1990. Maksimović protested against the construction of the monument, but locals from Valjevo persuaded her that it was just a monument for poetry with her face on it. The engraving on the monument reads accordingly: “To poetry from a poetic nation”.

Desanka Maksimović worked as a school teacher of Serbian literature and was member of the Serbian Academy of Sciences and Arts. She is most famous as a poet, storyteller, novelist, children’s writer, and occasional translator. Her poems represent a call for people to be good, noble, proud, and steady; to respect people of different beliefs and principles, opinions, colours and religions; and to be strict towards their own flaws as well as those of others. One of her best-known poems is ‘A Bloody Fairy Tale’ (Serbian: Krvava Bajka) which she wrote after hearing of the execution of students in Kragujevac on October 21st 1941. The poem was published after the end of the Second World War and became an obligatory part of every elementary school curriculum in Yugoslavia. It also inspired a movie with the same title made in 1969.

Still today, Desanka Maksimović’s poetry is included in the curricula of Serbian elementary schools. Poetry lessons, dedicated to her poetry, are organized on the central ‘Poetry Square’ in Valjevo every year on May 16th. That day, the best lyricists are given an award named after her and flowers are laid at her monument in the town centre.



1991

'Kundër të keqes'

Vendi: Kragujevac, Serbi

Skulptor: Romo Miguel

'Against Evil'

Location: Kragujevac, Serbia

Sculptor: Romo Miguel

Monumenti i gjatë 2 metra, 'Kundër të keqes' është gdhendje e një blloku të vetëm të mermerit. Stili i tij të kujton artin majan të Amerikës jugore, por tema e tij është e krishterë. Ai paraqet simbole religjioze të Apokalipsit që flasin për dënim të drejtë për ata që bëjnë keq, apo për shpërblim për ata që bëjnë mirë. Monumenti është punim i skulptorit meksikan Romo Miguel, dhe është dhuruar në 1989 nga Meksika për parkun memorial Shumaricë, afër Kragujevcit, si shenjë miqësie dhe bashkëpunimi. Monumenti u ngrit në vitin 1991.

Parku memorial kujton ekzekutimin e mijëra banorëve të Kragujevcit nga Wehrmacht-i gjerman më 21 tetor 1941. Në kujtim të këtyre viktimave, e tërë zona e Shumaricës është shndërruar në park memorial të quajtur 'Tetori i Kragujevcit' (serbisht: Kragujevački Oktobar) në 1953. Monumete të shumëta janë krijuar në këtë vend midis viteve 1959 dhe 1994, të ndërtuara, me disa përjashtime, kryesisht nga skulptorë dhe arkitektë nga pothuajse të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë.

Gjatë regjimit të Slobodan Millosheviqit dhe rritjes së nacionalizmit në Serbi, një kishë ortodokse serbe u ndërtua afër monumentit 'Kundër të keqes', duke theksur kështu përkatësinë fetare të viktimave dhe konceptin e popullit serb si viktimë.

The 2m-tall monument 'Against Evil' is carved out of a single marble block. Its style is reminiscent of ancient South-American Mayan art, but its theme is Christian. It features religious symbols from the Apocalypse that speak of just punishment for one's misdeeds or of reward for one's good deeds. It is the work of the Mexican sculptor Romo Miguel and was donated by Mexico in 1989 to the memorial park Šumarice, close to Kragujevac, as a token of friendship and cooperation. In 1991 it was finally erected.

The memorial park commemorates the execution of several thousand residents of Kragujevac by the German Wehrmacht on October 21st 1941. In commemoration of the victims, the whole Šumarice area was turned into the memorial park 'October in Kragujevac' (Serbian: Kragujevački Oktobar) in 1953. Numerous monuments were created in the park between 1959 and 1994, made, with few exceptions, mainly by sculptors and architects from almost all republics of former Yugoslavia.

During the rule of Slobodan Milošević and the rise of nationalism in Serbia, a Serbian Orthodox Church was built close to the monument 'Against Evil' emphasising both the religious belonging of the victims to the Serbian Orthodox Church and the concept of the Serbian people as victim.



1994

(ndërtimi i parë më 1984, first construction in 1984)

'Monumenti buzë rruge' kushtuar Ivo Andriqit

Vendi: Vishegrad, Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Ljupko Antunović

'Roadside Monument' to Ivo Andrić

Location: Vishegrad, Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Ljupko Antunović

Monumenti i kushtohet Ivo Andriqit (1892-1975), shkrimtarit të famshëm jugosllav dhe laureatit të çmimit Nobel i cili fitoi famë botërore me romanin “Ura mbi lumin Drina” ku ai përshkruan jetën dhe shoqërinë në qytetin e Bosnjës lindore, Vishegrad, nga shekulli XVI deri në Luftën e Parë Botërore. Ura Mehmed Pasha Sokolloviq, e cila e frymëzoi këtë libër, u ndërtua në vitin 1577 dhe u emërua si Vend i Trashëgimisë Kulturore i UNESCO-s, në vitin 2007.

Monumenti për herë të parë u ndërtua në Vishegrad më 1984 me iniciativën e disa shkrimtarëve të Bosnje dhe Hercegovinës. Ai u përrua gjatë ngjarjes kulturore ‘Shtigjet e Vishegradit’ që grumbullonte shkrimtarë e artistë nga gjithë Jugosllavia. Skulptori Ljupko Antunović, një artist nga Sarajeva, e quajti ‘Monument buzë rruge’ dhe ai u vendos afër urës së famshme.

Edhe pse ndërtimi i tij fillimisht nuk ishte i motivuar politikisht por kulturalisht, ‘Monumenti buzë rruge’ u bë viktimë e eksploatimit politik gjatë luftës së viteve të nëntëdhjeta. I shkatërruar në vitin 1991 nga forcat boshnjake, ai u rindërtua tri vjet më vonë me iniciativën e administratës politike të Republika Srpskës. Skulptori Antunović u pajtua ta rindërtojë monumentin por refuzoi të jetë i pranishëm gjatë ceremonisë së inaugurimit në vitin 1994 ku mori pjesë edhe Radovan Karaxhiqi, presidenti i parë i Republika Srpskës nga viti 1992 deri më 1996, aktualisht i akuzuar për krime luftë në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish Jugosllavi, në Hagë. Duke marrë parasysh këtë dhe faktin se gjatë luftës në vitet 1992-1994 Vishegrad ishte i ekspozuar ndaj kampanjave më gjithëpërfshirëse të spastrimit etnik kundër popullatës muslimane të Bosnjes, rikthimi i monumentit u bë mjet i demarkimit etno-nacional të hapësirës.

Është interesant se prapavija unike e Andriqit e parandalon që t’i atribohet cilësdo ‘anë’: ai u lind afër qytetit Travnik në Bosnje dhe Hercegovinë, nga prindër kroatë dhe e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Beograd. Ashtu sikurse romanet e tij, të cilët çmohen përtej kufijve etnikë e shtetërorë, ai vetë nuk i ‘përket’ vetëm një komuniteti por të gjithëve që e çmojnë veprën e tij. Prandaj, monumenti kushtuar Ivo Andriqit duhet të lirohet nga çfarëdo konotacioni politik që e ka marrë gjatë kohës; qëllimi i tij i vërtetë, sipas skulptorit Antunović, ishte që t’i bëhej homazh imagjinatës dhe veprës letrare të artistit.

The monument is dedicated to Ivo Andrić (1892-1975), famous Yugoslav writer and Nobel laureate who gained world fame with his novel “The Bridge on the Drina” in which he depicts life and society in the Eastern Bosnian city Višegrad from the 16th century until the First World War. The Mehmed Paša Sokolović Bridge, which inspired the book, was built in 1577 and named a UNESCO World Heritage Site in 2007.

The monument was first built in Višegrad in 1984 on the initiative of several Bosnian Herzegovinian writers. It was inaugurated during the cultural event ‘The Paths of Višegrad’ that used to gather writers and artists from all over Yugoslavia. Sculptor Ljupko Antunović, an artist from Sarajevo, named it ‘Roadside Monument’ and it was placed near the famous bridge.

Although its construction was initially not politically but culturally motivated, the ‘Roadside Monument’ became a victim to political exploitation during the war in the 1990s. Destroyed in 1991 by Bošniak forces, it was rebuilt three years later on the initiative of the political administration of Republika Srpska. Sculptor Antunović agreed to rebuild the monument but refused to be present at the inauguration event in 1994 which was attended by Radovan Karadžić, first president of Republika Srpska from 1992 to 1996 and currently tried for war crimes at the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia in The Hague. Taking this into account and the fact that during the war in 1992-1994 Višegrad was subjected to one of the most comprehensive campaigns of ethnic cleansing directed against its Muslim Bošniak population, the reinstatement of the monument became a means of ethno-national demarcation of space.

Interestingly, Andrić’s unique background prevents him from being claimed by either one ‘side’: He was born near Travnik in Bosnia and Herzegovina to Croatian parents and spent much of his life in Belgrade. Like his novels, which are appreciated beyond ethnic and state borders, he himself does not ‘belong’ to one community alone but to everyone who appreciates his work. Therefore, the monument to Andrić should be devoid of any political connotations it gained over time; its real intention, according to sculptor Antunović, was to pay homage to the artist’s imagination and literary work.



1997

Monumenti kushtuar Mbretit Tomisllav

Vendi: Tomislavgrad,
Bosnje dhe Hercegovinë
Skulptor: Vinko Bagariq

Monument to King Tomislav

Location: Tomislavgrad,
Bosnia-Herzegovina
Sculptor: Vinko Bagarić

Monumenti kushtuar Mbretit Tomisllav, sundimtarit të Mbretërisë Kroate në shekullin X, u dedikohet anëtarëve të 'Brigadës së Mbretit Tomisllav' që vdiqën gjatë luftës në vitet 1992-1995. E themeluar në Tomislavgrad, në jugperëndim të Bosnje dhe Hercegovinës, si formacion i Këshillit Kroat të Mbrojtjes, brigada mori pjesë në operacione ushtarake për mbrojtjen e qytetit dhe të rrethinës së luginës Duvno kundër forcave serbe.

Monumenti e përforcon ndjenjën e përkatësisë së katolikëve që jetojnë në luginën Duvno, karshi Kroacisë, 'vendlindjes' së tyre. Figura masive nga bronzi e 'mbretit të parë të Kroacisë', trupi i të cilit formon një kryq, e kujton vështtruesin për rëndësinë historike që ndërmori lugina Duvno në raport me krijimin e identitetit kroat. Besohet se lugina Duvno është vendi ku në vitin 753 u mbajt kuvendi i parë kroat dhe ku në vitin 925 u kurorëzua Mbreti Tomisllav. Edhe pse ende është objekt kundëthëniesh në mesin e studiuesve, këto ngjarje konsiderohen nga shumica të jenë fakte që pa asnjë kundërshtim e lidhin zonën Duvno me Kroacinë, pavarësisht kufijve të rinj politikë (apo ndryshues).

Në fundamentin e monumentit prej graniti, në pllakën memoriale shkruan: "Vendlindja e cila rritet nga dashuria jote jeton në ne, bijtë e Kroacisë. Për bijtë e Duvnos që e dhanë jetën e tyre për Kroacinë, vendlindjen e tyre." I vendosur në zonën e populluar me shumicë kroate dhe duke përmbytur emblema e referenca për Kroacinë, monumenti e përforcon identifikimin me tokën dhe historinë kroate.

The monument of King Tomislav, ruler of the Croatian Kingdom in the 10th century, is dedicated to the members of the 'King Tomislav Brigade' who died during the war in 1992-1995. Founded in Tomislavgrad, in the southwest of Bosnia and Herzegovina, as a formation of the Croatian Council of Defence, the brigade participated in military operations for the defence of the city and the surrounding Duvno valley against Serbian forces.

The monument strengthens a sense of belonging of the Catholics living in the Duvno valley to Croatia, their 'homeland'. The massive bronze figure of the 'first king of Croatia', whose body forms a cross, reminds the observer of the historical importance that the area of Duvno assumed regarding the creation of a Croatian identity. It is believed that the Duvno valley is the place where in 753 the first Croatian assembly took place and where in 925 King Tomislav was crowned. Although still an object of controversy among scholars, these events are by many considered to be historical facts irrefutably connecting the area of Duvno with Croatia, regardless of new (or shifting) political borders.

On the granite fundamen of the monument, a memorial plaque reads: "The Homeland that grows from your love lives in us, the children of Croatia. To the sons of Duvno who gave their lives for Croatia, their homeland." Placed in an area populated by a majority of Bosnian Croats and featuring emblems and references to Croatia, the monument strengthens the identification with Croatian land and history.



1999

Monumenti kushtuar Nënë Terezës

Vendi: Shkup, Maqedoni

Autor: Tome Serafimovski

Monument to Mother Teresa

Location: Skopje, Macedonia

Author: Tome Serafimovski

Monumenti i kushtohet Agnesë Gonxhe Bojaxhiut (1910-1997), të njohur si murgesha katolike Nënë Tereza. Ajo mori çmimin Nobel për Paqe në vitin 1979, për punën e saj humanitare dhe si themeluese e kongregacionit 'Misionarët e Bamirësisë', i cili kujdeset për të sëmurët dhe nevojtarët anembanë botës.

Statuja qëndron aty ku më parë ishte kisha katolike 'Zemra e Shenjte e Jezusit', ku Nënë Tereza u pagëzua menjëherë pas lindjes, në vitin 1910. Në janar të vitit 2009, Shtëpia Memoriale Nënë Tereza (që shihet prapa statujës) i ka hapur dyert e saj. Aty qëndron një ekspozitë e përhershme rreth jetës së saj duke përfshirë edhe një numër të madh të gjërave të saja personale.

Edhe pse respektohet botërisht për përkushtimin e saj ndaj bamirësisë dhe humanitarizmin që ajo e simbolizon, origjina etnike e Nënë Terezës ka qenë subjekt i kundërtënieve të thukta lokale në të kaluarën. Përfaqësuesit e qeverisë maqedone në disa raste iu referuan asaj thjesht si 'Skopjankata' ('shkupjanja'; vendlindja e saj), përfaqësuesit e komunitetit shqiptar e kritikuan këtë si mospërfillje të qëllimshme të origjinës së saj shqiptare. Ata gjithashtu u ankuan për vendin e monumentit, se ishte shumë larg. Propozimet e shoqërisë civile shqiptare për ta vendosur atë afër sheshit qendror të qytetit, ku më parë qëndronte shtëpia e Nënë Terezës, u refuzuan. Njëherë, vetë Nënë Tereza, në lidhje me origjinën e vet, pati thënë: "Sipas gjakut, jam shqiptare, sipas shtetësisë, hinduse, sipas fesë, murgeshë katolike. Sa për thirrjen time, unë i përkas botës. Sa për zemrën time, unë tërësisht i përkas Zemrës së Jezusit."

The monument is dedicated to Agnes Gonxha Bojaxhiu (1910-1997), known as the Roman Catholic nun Mother Teresa. She was awarded the Nobel Peace Prize in 1979 for her humanitarian work and as founder of the congregation 'Missionaries of Charity', which cares for the sick and needy worldwide.

The statue stands on the former site of the Catholic church 'Sacred Heart of Jesus', in which Mother Teresa was baptized shortly after her birth in 1910. In January 2009, the Mother Teresa Memorial House (seen behind the statue) opened its doors. It holds a permanent exhibition about her life that includes numerous of her personal belongings.

Although universally respected for her devotion to charity and the humanitarianism she symbolises, Mother Teresa's ethnic origin has been a matter of subtle local controversies in the past. When representatives of the Macedonian government on several occasions referred to her simply as 'Skopjankata' ('the woman from Skopje'; her birthplace), representatives of the Albanian community criticised this as a deliberate disregard of her Albanian origin. They further complained about the rather remote location of the monument. Proposals from the Albanian civil society to place it near the central city square, where Mother Teresa's original house used to stand, were rejected. Mother Teresa herself once said regarding her origin: "By blood, I am Albanian; by citizenship, an Indian; by faith, I am a Catholic nun. As to my calling, I belong to the world. As to my heart, I belong entirely to the Heart of Jesus."



2000

Monumenti kushtuar Zahir Pajazitit

Vendi: Prishtinë, Kosovë

Skulptor: Muntoz Dhrami

Monument to Zahir Pajaziti

Location: Pristina, Kosovo

Sculptor: Muntoz Dhrami

Statuja përkujton Zahir Pajazitin (1952-1997) i cili ishte njëri nga aktivistët dhe themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai u vra në janar të vitit 1997 nga policia serbe, duke qenë komandanti i parë i UÇK-së që vdiq gjatë konfliktit të armatosur me Serbinë. Në vitin 2008, ai u shpall hero i Luftës së Kosovës nga një dekret i presidentit të atëhershëm, Fatmir Sejdiut. Gjatë luftës, një njësi e UÇK-së u quajt sipas emrit të tij. Autoritetet serbe e akuzuan Pajazitin për kryerjen e sulmeve terroriste ndaj njësive policore serbe. Memoriali i tij u përvurua më 28 nëntor 2000, në Ditën e Flamurit.

Pas luftës së viteve 1998-1999, monumentet dhe vendet memoriale lulëzuan në Kosovë, që kryesisht u ngritën nga familjet që i humbën të afërmit e tyre gjatë luftës. Këto monumente dhe memoriale u ndërtuan për t'i përkujtuar ushtarët dhe komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si dhe viktimat e luftës. Vetëm disa nga këto memoriale u ngritën nën patronazhin e qeverisë së Kosovës apo nën drejtimin e komunave. Pjesa më e madhe e tyre rezultoi nga nismat private. Vendndodhjet e memorialeve janë vetvetiu lokacione historike, meqë ato shpesh i referohen origjinës së heroit të përkujtuar apo vendit të vdekjes së tij. Shumica e monumenteve dhe e memorialeve në Kosovë, sidomos ato të ndërtuara pas luftës së fundit, i ngjajnë artit soc-realist, por të plotësuar me simbole kombëtare.

The statue commemorates Zahir Pajaziti (1952-1997) who was one of the activists and founders of the Kosovo Liberation Army (KLA). He was killed in January 1997 by the Serbian police, being the first KLA commander dying in the armed conflict with Serbia. In 2008, he was declared a hero of the Kosovo War by a decree of then president Fatmir Sejdiu. During the war, a KLA unit was named after him. Serbian authorities accused Pajaziti of conducting terrorist attacks against Serbian police units. His memorial was inaugurated on November 28th 2000 for the Flags Day.

After the war of 1998/9, monuments and memorial sites flourished in Kosovo, mainly erected by families that lost relatives during the war. These monuments and memorials were built to commemorate soldiers and commanders of the Kosovo Liberation Army (KLA) as well as war victims. Only few of these memorials were erected under the patronage of the Kosovo government or under the direction of municipalities. Most of them resulted from private initiatives. The locations of the memorials are historical venues themselves, as they often refer to the origin of the commemorated hero or his place of death. Most of monuments and memorials in Kosovo, especially those built after the last war, resemble socialist-realist art, but complemented with national symbols.



2001

(ndoshta më herët, maybe earlier)

Parku memorial Rorovi

Vendi: Gorazhde, Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Senad Pezo

Memorial Park Rorovi

Location: Goražde, Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Senad Pezo

Ky monument është pjesa qendrore e parkut memorial Rorovi, afër qytetit Gorazhde në lindje të Bosnje dhe Hercegovinës, që i përkujton ushtarët e rënë në rezistencën e Gorazhdes në vitet 1992 - 1995. Gjatë luftës së viteve 1990, Gorazhde ishte disa herë nën rrethim dhe mbrohej nga Ushtria e Bosnje dhe Hercegovinës. Njëra nga linjat mbrojtëse të qytetit shtrihej përgjatë Rorovi, prandaj dhe u zgjodh si vend për parkun memorial.

Memoriali ka formën e shënuesit të varrit të stilizuar me motive të gdhendura të një gjysmëhëne dhe ylli, zambaku të artë, dhe të një shpate. Këto simbole i japin respekt të veçantë ushtarëve të rënë të fesë islame (shehid). Në mesin e shumë përkujtimeve të organizuara në Rorovi, 'Ditët e Rezistencës' veçohet edhe për nga përmbajtja dhe kohëzgjatja: një turne përgjatë linjave të mbrojtjes, një 'mësim historie', dhe kurorat e shtrira; të gjitha këto kanë për qëllim ta ruajnë kujtesën e 'sakrificës për çlirimin nga agresorët'. Meqenëse 'Dita e fitorës kundër fashizmit' kushtuar ushtarëve që kanë rënë në Luftën e Dytë Botërore festohet në kohën e njëjtë, praktikat përkujtuese në Rorovi në njëfarë mënyre i barazojnë të gjitha viktimat, edhe partizanët edhe shehidët, që bashkarisht e kundërshtojnë 'armikun fashist'.

Rorovi ngërthen kode fetare dhe ato laike: duke i dhënë respekt shehidëve të rënë në mbrojtje të qytetit, fokusohet dimension i fetar përderisa shpërfilllet ndëretniciteti i Ushtrisë së Bosnje dhe Hercegovinës. Njëjtë, simbolizmi fetar barazohet me identifikimin kombëtar të boshnjakëve muslimanë. Prandaj ky monument nuk e artikulon unitetin ndëretnik të Bosnje dhe Hercegovinës por ndarjen.

The monument is the central part of the memorial park Rorovi, near Goražde in eastern Bosnia-Herzegovina, which commemorates the soldiers who died in the resistance of Goražde in 1992 - 1995. During the war in the 1990s, Goražde was several times under siege and defended by the Army of Bosnia and Herzegovina. One of the defence lines of the city led across Rorovi, which is why it was chosen as the location for the memorial park.

The monument has the form of a stylised grave marker with engraved motives of a crescent moon and star, a golden lily, and a sword. These symbols give special respect to fallen soldiers of Muslim faith (shaheed). Among the many commemorations organised in Rorovi, the 'Days of Resistance' stand out both in content and duration: a tour along important lines of defence, a 'history lesson', and the laying down wreaths all intend to preserve memories of the 'sacrifice made for the liberation from aggressors'. Since the 'Day of Victory over Fascism' dedicated to soldiers who fell in the Second World War is celebrated at the same time, the commemorative practices in Rorovi in a way equalise all victims, both partisans and shaheed, who jointly oppose the 'fascist enemy'.

Rorovi combines both religious and secular codes: By giving respect to shaheed fallen in defence of the city, the religious dimension is focused while the interethnicity of the Army of Bosnia and Herzegovina is neglected. In the same way, religious symbolism is equated with national identification of Bosnian Muslims (Bošniaks). Thus this monument is not so much an articulation of Bosnian and Herzegovinan interethnic unity, but rather of segregation.



2003

**Qendra Memoriale Srebrenica
– Potočari, për viktimat e
gjenocidit të vitit 1995**

Vendi: Srebrenicë, Bosnje dhe
Hercegovinë

Arkitektët: Ahmed Xhuvicq and
Ahmet Kapixhiq

**Memorial Centre Srebrenica-
Potočari for the
Victims of the 1995 Genocide**

Location: Srebrenica,
Bosnia-Herzegovina
Architects: Ahmed Džuvic
and Ahmet Kapidžic

Qendra memoriale në Potočari, në Bosnjen lindore, u kushtohet viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, të vitit 1995. Ajo përbëhet nga një monument dhe një varrezë, që janë pjesë e komponentës sakrale të qendrës memoriale. Që nga viti 2003, viktimat e identifikuar të gjenocidit varrosen aty.

Qendra memoriale u ndërtua me iniciativën e ish Përfaqësuesit të Lartë për Bosnje dhe Hercegovinë, Wolfgang Petritsch. Në vitin 2001, fondacioni i formuar asokohe 'Srebrenica-Potočari' ndërmori detyrën e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së qendrës memoriale. Qëllimi i saj është të përkujtojë masakrën e mbi 8000 viktimave e cila ndodhi në korrik të vitit 1995 gjatë ofenzivës së zhvilluar nga Ushtria e Republika Sërpskës, të udhëhequr nga Ratko Mladić, në enklavën e Srebrenicës edhe pse zona ishte shpallur 'zonë e lirë' e Kombeve të Bashkuara.

Arkitektët e dizajnuan pjesën e brendshme sakrale në formën e margaritës, që ishte frymëzim për ta për shkak të thjeshtësisë dhe 'pastërtisë' së saj. 8000 shenjat e varrit në varreza (mezarë) janë të grupuara si petale lulesh rreth 'musalës' qendrore, një hapësirë e hapur për lutje dhe e mbuluar nga të katër anët me një kulm që i përngjan arkitekturës tradicionale boshnjake. Në 'Murin e Kujtesës', në një platformë gjysmërrethore prej graniti përreth musalës, janë të shkruar emrat e viktimave.

Pa simbole kombëtare, qendra memoriale fokusohet në kushtimin e respektit për të vdekurit dhe përpiqet t'i shmanget çfarëdo shfrytëzimi politik a ideologjik të kujtesës për viktimat. Forma e lules simbolizon jetën e jo vdekjen, dhe i jep monumentit një ton pajtues dhe madhështor.

The memorial centre in Potočari, in Eastern Bosnia, is dedicated to the victims of the genocide in Srebrenica of 1995. It consists of a monument and a cemetery, both of which are part of the sacral component of the memorial centre. Ever since 2003, the identified victims of the genocide have been buried there.

The memorial centre was built on the initiative of the former High Representative for Bosnia and Herzegovina, Wolfgang Petritsch. In 2001, the newly created foundation 'Srebrenica-Potočari' undertook the task of building and maintaining the memorial centre. Its aim is to commemorate the more than 8000 victims of the massacre which occurred in July 1995 during an offensive carried out by the Army of the Republika Srpska, led by Ratko Mladić, on the enclave Srebrenica even though the area had been declared a UN 'safe zone'.

The architects designed the inner, sacral part of the centre in the form of a daisy which inspired them due to its simplicity and 'purity'. The 8000 grave markers in the cemetery (mezarje) are grouped like flower petals around the central 'musala', an open space for prayer covered by a four-sided roof reminiscent of traditional Bosnian architecture. On the 'Wall of Remembrance', a semicircular granite platform revolving around the musala, the names of the victims are inscribed.

Free from national symbols, the memorial centre focuses on paying respect to the dead and tries to evade any political or ideological exploitation of the remembrance of the victims. Its form of a flower symbolises life rather than death, and gives the monument a conciliatory and dignified tone.



2004

Monumenti kushtuar viktimave shqiptare të Luftës së Dytë Botërore dhe të konfliktit të vitit 2001

Vendi: Bllacë, Maqedoni

Skulptor: Selam Mustafa

Monument to Albanian victims of the Second World War and the 2001 conflict

Location: Blace, Macedonia

Sculptor: Selam Mustafa

Qëllimi i monumentit është i dyfishtë: ai u përrua gjatë përkujtimit të përvjetorit të gjashtëdhjetë të vrasjes së mbi njëqind qytetarëve shqiptarë nga fshati Bllacë i Maqedonisë veriore, nga ana e partizanëve në nëntor të vitit 1944. Njëkohësisht, ai shërben si varrezë për luftëtarët shqiptarë që vdiqën gjatë konfliktit të brendshëm në Maqedoni në vitin 2001.

Në kohën e Jugosllavisë ishte gati e pamundur të ndërtoheshin monumente që i kujtonin ngjarjet me rëndësi kombëtare për njërin nga popujt e saj, sidomos për minoritetet siç ishin shqiptarët në Republikën Socialiste të Maqedonisë. Kjo ndryshoi pasi që Maqedonia fitoi pavarësinë në vitin 1991 dhe pas konfliktit të brendshëm në vitin 2001 që përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, që hapi rrugën për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Për shkak të rregulloreve të liberalizuara, ishte e mundur të ndërtohej monumenti në Bllacë nga ana e komunitetit shqiptar dhe si i tillë ai përfaqëson një lloj të përkujtimit privat veçmas nga kultura zyrtare (maqedonase) e kujtesës. Si i tillë, ai ka më shumë rëndësi për minoritetin shqiptar sesa për të tjerët.

The monument's purpose is twofold: It was inaugurated during the commemoration of the 60th anniversary of the killing of over a hundred Albanian citizens from the village of Blace in Northern Macedonia by Partisans in November 1944. At the same time, it serves as a cemetery for Albanian fighters who died during the internal conflict in Macedonia in 2001.

In the time of Yugoslavia, it was nearly impossible to build monuments remembering events of national relevance for one of its people, especially for minorities such as Albanians in the Socialist Republic of Macedonia. This changed after Macedonia gained its independence in 1991 and following the internal conflict in 2001 which ended with the signing of the Ohrid Framework Agreement that paved the way for improving interethnic relations. Due to liberalised regulations, the monument in Blace could be built by the local Albanian community and as such it represents a type of private commemoration apart from the official (Macedonian) culture of remembrance. As such, it is more significant to the Albanian minority than to others.



2004

Monumenti kushtuar ushtarëve të rënë të luftës për mbrojtjen e vendlindjes
Vendi: Mrkonjić-Grad,
Bosnje dhe Hercegovinë
Skulptor: Miodrag Živković
Monument to the Fallen Soldiers of the Defensive Homeland War

Location: Mrkonjić-Grad,
Bosnia-Herzegovina
Sculptor: Miodrag Živković

Monumenti i kushtohet ushtarëve serbë që vdiqën në 'Luftën për mbrojtjen e vendlindjes' të viteve 1992-1995, sipas mbishkrimit zyrtar mbi pllakën memoriale. Monumenti u përrua më 13 korrik të vitit 2004 së bashku me disa monumente të tjera kushtuar banorëve të zhdukur të zonës që e rrethon qytetin Mrkonjić-Grad në pjesën veriore të Republika Srpskës. Më shumë se treqind njerëz humbën jetën gjatë operacioni të 'Lëvizjes jugore' kur këshilli kroat i mbrojtjes mori qytetin Mrkonjić-Grad në vitin 1995.

Monumenti ndodhet në platonë e nivelizuar përballë Shtëpisë së Kulturës. Ai ka formën e një kryqi ndërsa në kryqëzimin e krahëve të tij qëndron një kryq më i vogël grek me katër shkronja C, derisa fundi i tij është i gdhendur me një figurë të një ushtari që mbështetet në pushkën e tij. Monumenti nuk dallon shumë nga shumica e monumenteve tjera të ndërtuara pas luftës, pikërisht për shkak të qëllimit të tij për të rindërtuar identitetin e një kombi apo të një grupi etnik përmes simboleve kombëtare të njohshme dhe përmes kujtimit të viktimave.

Më gjithatë, ajo që është më e habitshme për këtë monument është fakti se kjo është vepër e Miodrag Živkovićit, skulptorit të njëjtit i cili në vitin 1973 ndërtoi monumentin kushtuar 'Betejës së Sutjeskës'. Duke shikuar transformimin kreativ e politik të po këtij artisti, mund të vërehet masa në të cilën u shfaq hendeku ndërmjet monumenteve që burojnë nga koha e Jugosllavisë dhe të atyre pas shpërbërjes së saj.

The monument is dedicated to Serbian soldiers who died in the 'Defensive Homeland War' of 1992-1995, according to the official inscription of the memorial plaque. It was inaugurated on July 13th 2004 along with several other memorials to the perished inhabitants of the area surrounding Mrkonjić-Grad in the northern part of Republika Srpska. More than three hundred people lost their lives during the 'Southern Move' operation when the Croatian Defense Council took over Mrkonjić-Grad in 1995.

The monument is located on the levelled plateau in front of the House of Culture. It has the form of a cross and in the intersection of its arms sits a smaller Greek cross with four letters C, while in its bottom is engraved the figure of a soldier leaning on his gun. The monument does not differ much from the majority of other memorials built after the war, precisely because of its intention to reconstruct the identity of a nation or ethnic group through recognisable national symbols and remembrance of victims.

However, more striking about this monument is the fact that it is the work of Miodrag Živković, the same sculptor who in 1973 built the monument commemorating the 'Battle on the Sutjeska'. By looking at the creative and political transformation of this one artist, one can see the extent to which a gap appeared between monuments originated in the time of Yugoslavia and the ones after its disintegration.



2004

Memoriali kushtuar Adem Jasharit dhe familjes së tij 'dëshmore'

Vendi: Prekaz, Kosovë

Skulptor: Mumtaz Dhrami

Memorial to Adem Jashari and his 'martyr' family

Location: Prekaz, Kosovo

Sculptor: Mumtaz Dhrami

Memoriali i kushtohet Adem Jasharit (1955-1998), ish kryekomandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai konsiderohet nga shqiptarët e Kosovës si njëri nga heronjtë kryesorë të Luftës së Kosovës ndërmjet viteve 1998 dhe 1999. Monumenti është i ngritur në Prekaz, vendlindjen e familjes Jashari, në Kosovën veriore.

Republika Federative e Jugosllavisë atë e konsideroi terrorist që eventualisht çoi drejt aksionit ushtarak nga ushtria jugosllave. Në korrik të vitit 1997, gjykata jugosllave e dënoi atë, in absentia, për aksione terroristë në një gjykim të dënuar nga grupet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në mars të vitit 1998, shtëpia e Jasharajve u rrethua nga forcat policore serbe që e vranë Adem Jasharin dhe 54 anëtarë tjerë të familjes së tij. Vdekja e Jasharit dhe përplasjet e dhunshme ndërmjet ushtrisë jugosllave dhe luftëtarëve të UÇK-së në fshatrat e Drenicës, Likoshan e Qirez, në të njëjtin muaj shënojnë fillimin e luftës në Kosovë (1998-1999).

Në vitin 2004, shtëpia e familjes së Adem Jasharit në Prekaz u shpall kompleks memorial kombëtar. Pjesa qendrore e kompleksit është shtëpia e djegur. Pas luftës, në kompleks u vendosën varre prej mermeri për të gjithë anëtarët e vrarë të familjes. Varri i Adem Jasharit gjithnjë ruhet nga Forcat e Sigurisë së Kosovës. Memoriali në Prekaz sot është njëri nga vendet më të shenjta për shqiptarët e Kosovës. Ai vizitohet nga qindra mijëra njerëz për çdo vit. Për më tepër, aeroporti kryesor i Prishtinës u emërua sipas Adem Jasharit dhe në vitin 2008 kryeministri i Kosovës i dha titullin pas vdekjes 'Hero i Kosovës'.

The memorial is dedicated to Adem Jashari (1955-1998), former chief commander of the Kosovo Liberation Army. He is perceived by Kosovo-Albanians as one of the main heroes of the Kosovo War between 1998 and 1999. It stands in Prekaz, the hometown of the Jashari family, in Northern Kosovo.

The Federal Republic of Yugoslavia considered him a terrorist which eventually led to military action by the Yugoslav army. In July 1997, a Yugoslav court had convicted him in absentia of terrorist actions in a trial condemned by international human rights groups. In March 1998, the Jashari house was besieged by Serbian police forces that killed Adem Jashari and 54 members of his family. The death of Jashari and violent clashes between the Yugoslav army and KLA fighters in the villages of Drenica, Likoshan and Qirez in the same month mark the beginning of the war in Kosovo (1998-1999).

In 2004, the house of Adem Jashari's family in Prekaz was declared a national memorial complex. The central part of the complex is the burned house. After the war marble tombs were arranged in the complex for all killed family members. Adem Jashari's tomb is constantly guarded by Kosovo Security Forces. The memorial in Prekaz nowadays is one of the most sacred places for Kosovo-Albanians. It is visited by hundreds of thousands of people yearly. Furthermore, the main Pristina airport is named after Adem Jashari and in 2008 the prime minister of Kosovo posthumously awarded him the title 'Hero of Kosovo'.



2005

Monumenti kushtuar ushtarëve kroatë që vdiqën në vitet 1992-1995

Vendi: Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë

Skulptor: Slavomir Drinković

Monument to Croatian Soldiers who died in 1992-1995

Location: Mostar, Bosnia-Herzegovina

Sculptor: Slavomir Drinković

Monumenti u kushtohet ushtarëve kroatë që vdiqën në Mostar gjatë luftës së viteve 1992-1995 dhe është i vendosur në 'Sheshin e të Lavdishmëve' përballë Shtëpisë së Kultures kroate 'Herceg Stjepan Kosača', në pjesën perëndimore – kryesisht kroatë – të qytetit.

Pasi u zbulua, monumenti u bë vend i përkujtimeve të anëtarëve të kështitit kroat të mbrojtjes që vdiqën në mbrojtje të Mostarit gjatë sulmeve të Ushtrisë Popullore Jugosllave (JNA). Ky është poashtu vend i vendosjes së kurorave në përvjetore të themelimit të republikës kroate të Herceg-Bosnjes që ekzistoi ndërmjet viteve 1991 dhe 1994, dhe u anulua nga Marrëveshja e Uashingtonit.

Përveç dërgimit të mesazhit të qartë politik, një nga problemet e monumenit, ashtu siç e shohin qytetarët e Mostarit, qëndron në faktin se me simbolikën e tij fetare dhe kombëtare, ai i përjashton ata mbrojtës që nuk i përkisnin nacionalitetit kroat, por që vdiqën në mënyrë të barabartë në mbrojtje të qytetit. Monumenti përbëhet nga një kub panelesh të zeza boshllëku i të cilave formon një kryq në pjesën e përparme, ndërsa anët janë të dekoruara me skena nga Vajtimi i Krishtit. 'Mohimi' i atyre viktimave që nuk janë të përkatësishë së njëjtë kombëtare dhe fetare me ata që e ngritën monumentin shtrihon një problem edhe më të madh duke marrë parasysh që monumenti u ndërtua nga tatimpaguesit e qytetit dhe të Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës.

Në kontekstin e konfliktit që shpërtheu ndërmjet anës boshnjake dhe kroate në Mostar gjatë viteve 1992-1995, monumenti qëndron si vazhdimësi e mospajtimeve dhe ndarjes së tyre të mëtejme. Qëllimi i tij nuk është katarza dhe çlirimi nga vuajtjet, por ndërtimi i një identiteti politik të bazuar në kultin e 'viktimës sonë'. Mostari ishte njëri nga qytetet më të prekura nga lufta dhe qytetarët sot ende bartin ndarjen si fat të përbashkët. Kufijtë, edhe pse të padukshëm, janë të gjithëpranishme; secili i ndan ato sepse ekzistojnë në entitete etno-nacionale të të dyja palëve.

The monument is dedicated to Croatian soldiers who died in Mostar during the war in 1992-1995 and is placed on the 'Square of the Greats' in front of the Croatian House of Culture 'Herceg Stjepan Kosača', in the western – mostly Croatian – part of the city.

After it was uncovered, the monument became the place for commemorations of members of the Croatian Defense Council who died in the defence of Mostar during the attacks of Yugoslav People's Army (JNA). It is also the place of laying wreaths on the anniversaries of establishing the Croatian Republic of Herzeg-Bosnia that existed between 1991 and 1994, and was abolished by the Washington Agreement.

Other than sending a clear political message, one of the monument's problems, as Mostar's citizens see it, lies in the fact that with its religious and national symbolism, it excludes those defenders who were not of Croatian nationality, but who died equally in the defence of the town. The monument consists of a cube of black panels whose gaps form a cross on the front, while the sides are decorated with scenes of the Lamentation of Christ. The 'denial' of those victims who are not of the same national and religious affiliation as the ones who erected the monument raises an even greater problem considering that the monument was funded by the city's taxpayers and the Federation of Bosnia and Herzegovina.

In the context of the conflicts that broke out between the Bosniak and Croatian sides in Mostar between 1992 and 1995, the monument stands as the continuation of their further disagreements and separation. Its intention is not catharsis and release from pain and war suffering, but the establishment of a political identity based on the cult of 'our victim'. Mostar was one of the cities most affected by the war and its citizens today still bear division as a common fate. The boundaries, though invisible, are omnipresent; everyone shares them and they exist in both ethno-national entities.



2006

**Monumenti kushtuar
Skenderbeut**

Vendi: Shkup, Maqedoni

Skulptor: Thoma Thomai

Monument to Skanderbeg

Location: Skopje, Macedonia

Sculptor: Thoma Thomai



	Monumenti i kushtohet Gjergj Kastrioti Skenderbeut (1405-1468), të njohur si 'Sken-derbeu', udhëheqësit të rezistencës kundër pushtimit osman të Shqipërisë së ditëve tona dhe të Ballkanit të shekullit XV.	The monument is dedicated to Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468), commonly known as 'Skanderbeg', leader of the resistance against the Ottoman conquest of present-day Albania and the Balkans in the 15th century.
	Monumenti simbolizon aspirata çlirimtare të Ballkanit në një kohë të superioritetit të madh të Perandorisë Osmane në pushtimin e saj të rajonit. Duke i kushtuar dy dekadat e fundit të jetës së tij kundër pushtuesve të huaj, rëndësia e Skenderbeut dhe përpjekjet e tij respektohen anëmbanë Ballkanit.	The monument symbolises libertarian aspirations of the Balkans at a time of great superiority of the Ottoman Empire in its conquest of the region. Having dedicated the last two decades of his life to the fight against foreign occupation, Skanderbeg's importance and efforts are widely respected throughout the Balkans.
	Pasi Maqedonia e deklaroi pavarësinë e saj më 1991, komunitetit i shqiptarëve etnikë në vend e ndjeu dëshirën për të krijuar vende të publike të kujtesës së tyre kombëtare. Por vetëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, që në vitin 2001 i dha fund shpërthimit të shkurtër por intenziv të dhunës ndërmjet shtetit maqedonas dhe kryengritësve shqiptarë, u ndërtua një bazë për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve dhe të minoriteteve tjera në Maqedoni, dhe kështu mundësoi realizimin e monumenteve të inicuar nga minoritetet.	After Macedonia declared its independence in 1991, the ethnic Albanian community in the country felt the desire to create its own public places of national remembrance. But only after the signing of the Ohrid Framework Agreement, which in 2001 ended a short but intense outbreak of violence between the Macedonian state and Albanian insurgents, a basis had been established for improving the rights of Albanians and other minorities in Macedonia, and thus enabled the realisation of monuments initiated by minorities.
	Në vitin 2006, komuna e Çairit e Shkupit inicoi dhe financoi ndërtimin e monumentit të Skenderbeut. Edhe pse monumenti është veçanarisht relevant për identitetin shqiptar në Maqedoni, përrurimi i tij nuk u çmua vetëm nga shqiptarët etnikë, të cilët janë krenarë për ta parë heroin 'e tyre' kombëtar në pazarin e vjetër, por edhe nga elita politike dhe intelektuale maqedonase e cila reagoi pozitivisht dhe e konsideroi monumentin si një kontribut për imazhin e Shkupit si një metropol evropian.	In 2006, the Skopje municipality of Cair initiated and financed the construction of the Skanderbeg monument. Although, the monument is especially relevant for the Albanian identity in Macedonia, its inauguration was not only appreciated by ethnic Albanians, who feel a certain pride to see 'their' national hero at the Old Bazar in central Skopje, but also the Macedonian political and intellectual elite reacted positively and consider the monument a contribution to Skopje's image as a European metropolis.



2006

'Krahët e Thyer'

Vendi: Shkup, Maqedoni

Skulptor: Zharko Basheski

'Broken Wing'

Location: Skopje, Macedonia

Sculptor: Žarko Bašeski

Monumenti 'Krahët e Thyer' u kushtohet 54 ushtarëve maqedonas që u vranë duke luftuar përkrah Ushtrisë Jugosllave gjatë luftave 1991/92 në Slloveni e Kroaci. Monumenti u inicua nga Shoqata Maqedonase e Prindërve të Ushtarëve të Rënë dhe të Plagosur të Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë. Ky monument përfaqëson të vetmin vend të kujtimit në Maqedoni për këtë kapitull të historisë së Ballkanit perëndimor.

Monumenti u ndërtua me iniciativë private të prindërve të ushtarëve, dhe financimi gjithashtu u bazua në donacione private. Ndërtimi relativisht i ri i monumentit ndodhi si rezultat i kohës së nevojshme për të mbledhur donacione të nevojshme dhe për të mobilizuar përkrahës të mjaftueshëm.

Fakti që ky monument është iniciativë private dëshmon që në Maqedoni, një diskurs politik mbi luftrat në territorin e ish Jugosllavisë vështirë se zhvillohet. Kjo është rezultat i pjesërishëm i përfshirjes së rrallë të Maqedonisë në ndonjërin nga konfliktet e mëdha gjatë viteve të nëntëdhjeta.

The monument 'Broken Wings' is dedicated to 54 Macedonian soldiers who were killed fighting for the Yugoslav Army during the 1991/92 wars in Slovenia and Croatia. The monument was initiated by the Macedonian Association of the Parents of Fallen and Wounded Soldiers of the Yugoslavian National Army. It represents the only place of remembrance in Macedonia for this chapter of Western Balkan history.

The monument was built on a private initiative by the soldiers' parents, and also the funding was based on private donations. The relatively late construction of the monument occurred due to the time needed to collect necessary donations and to mobilise sufficient supporters.

The fact that this monument is a private initiative indicates that in Macedonia a political discourse on the wars in the territory of Ex-Yugoslavia is hardly taking place. This is partly due to the fact that Macedonia was rarely involved in any of the major conflicts during the 1990s.



2007

**Monumenti kushtuar
konsullit rus Grigorije
Stepanović Šćerbina**

Vendi: Mitrovicë, Kosovë

Skulptor: I panjohur

**Monument to Russian
Consul Grigorije
Stepanović Šćerbina**

Location: Mitrovica,
Kosovo


Sculptor: Unknown

Statuja memoriale në Mitrovicë, në veri të Kosovës, përkujton konsullin e parë rus të qytetit, Grigorije Stepanović Šćerbina (1868-1903). Rusia cariste e dërgoi Shćerbina në Mitrovicë në fillim të marsit të vitit 1903 për të monitoruar kushtet e popullatës lokale serbe. Shqiptarët e refuzuan praninë e konsullit në Mitrovicë meqë ata e perceptonin si kërcënim ndaj aspiratave të tyre për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar. Një muaj më pas, Shćerbina u vra nga një shqiptar në kohën kur Kosova ende ishte pjesë e Perandorisë Osmane por vazhdimisht dridhej nga kryengritjet.

Vrasja e konsullit e bëri atë dëshmor për shume serbë. Ata thonin se Shćerbina “vdiq për ortodoksinë e shenjtë dhe për lirinë e popullatës serbe”. Në vitin 1928, për Shćerbina u ndërtua një statujë në stacionin e trenit në Mitrovicën jugore, në vendin ku ai u vra. Pas vitit 1999, statuja mbeti në pjesën shqiptare të Mitrovicës por u largua në vitin 2001. Në vitin 2007 statuja e Shćerbina u rindërtua në pjesën veriore të Mitrovicës ku jeton shumica serbe. Prandaj, monumenti gjithashtu shërben si simbol i dallimeve të thella etnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve.

The memorial statue in Mitrovica, in northern Kosovo, commemorates the first Russian consul of the city, Grigorije Stepanović Šćerbina (1868-1903). Tsarist Russia sent Šćerbina to Mitrovica in early March 1903 in order to monitor the conditions of the local Serbian population. Albanians rejected the presence of the consul in Mitrovica because they perceived it as a threat to their aspirations of creating an Albanian national state. One month later, Šćerbina was killed by an Albanian at a time when Kosovo was still part of the Ottoman Empire but constantly shaken by riots.

The murder of the consul made him a martyr for many Serbs. They said that Šćerbina “has died for the sacred orthodoxy and liberty of the Serbian population”. In 1928, a statue was built for Šćerbina at the train station in southern Mitrovica where he was killed. After 1999, the statue remained in the Albanian southern part of Mitrovica, but in 2001 it was removed. In 2007, Šćerbina’s statue was rebuilt in the northern part of Mitrovica where a majority of Serbs live. Thus, the monument serves also as a symbol of the deep ethnic differences between Albanians and Serbs.



2007

Monumenti kushtuar Roki Balboas

Vendi: Zhitishte, Serbi

Skulptor: Boris Staparac

Monument to Rocky Balboa

Location: Žitište, Serbia

Sculptor: Boris Staparac

Monumenti kushtuar karakterit të filmave, boksierit Roki Balboa (të luajtur nga Sylvester Stallone) u zbulua më 18 gusht të viti 2007 në 'Parkun e artit të ndaluar' në Zhitishte, qytet i vogël në veri të Serbisë.

Për banorët e qytetit Zhitishte, monumenti përfaqëson një përpjekje për ta ndryshuar imazhin e qytetit dhe për të tërhequr turistë. "Qëllimi ynë është të krijojmë një brend nga ky qytet. Deri më tani Zhitishte ka qenë i njohur vetëm për gjëra të këqija – vërshime, gripi i derrave. Këtu ka shumë tifozë të futbollit italian dhe (aktori amerikan-Italian) Stallone dhe Roki thjeshtë përshtaten këtu," tha kryetari i komunës, Zoran Babić.

Monumenti u ndërtua me iniciativën e shoqatës së qytetarëve lokalë "Roki Balboa" që kryesisht përbëhet nga të rinj lokalë të frymëzuar nga ndërtimi i monumentit për nder të legjendës së kung-fusë, Brus Li, në Mostar. Skulptori kroat, Boris Staparac, dëgjoi për planet dhe u ofrua të ndërtonte monumentin pa asnjë kompensim: "Ideja për të ndërtuar dhe për t'i kushtuar një monument një heroi të filmit është mjaft e çuditshme, dhe mua jashtë-zakonisht më interesojnë e më tërheqin çuditrat dhe gjërat e pazakonshme."

Shoqata shpjegoi zgjedhjen e Rokit për faktin se heroi i filmit filloi si një boksier i pasuksesshëm dhe në fund u bë kampion bote, duke i mundur të gjithë kundërshtarët dhe njëkohësisht duke i mposhtur fantazmat e tij të brendshme. Kjo është ajo që banorët e qytetit synonin të arrinin në mënyrë që ta promovojnë përparimin e qytetit të tyre. Sipas mendimit të tyre, ky qëllim u arrit: zbulimi i monumentit u përcoll nga media ndërkombëtare dhe një ekip kanadez madje e xhiroi. Megjithatë, investimet aq të dëshiruara që do të tërhiqeshin nga ky reklamim nuk i plotësuan pritjet.

The monument to the movie character boxer Rocky Balboa (played by Sylvester Stallone) was uncovered on August 18th 2007 in the 'Park of Forbidden Art' in Žitište, a small town in northern Serbia.

For the residents of Žitište, the monument represents an attempt to change the town image and attract tourists. "Our goal is to make a brand out of this town. So far Žitište has only been known for bad things - floods, swine fever. There are a lot of fans of Italian football here and (US-Italian actor) Stallone and Rocky simply fit in," said the city's mayor, Zoran Babić.

The monument was built on initiative of the local citizen's association "Rocky Balboa" that mainly consists of local youths who were inspired by the construction of a monument in honour of kung fu legend Bruce Lee in Mostar. Croatian sculptor Boris Staparac heard of the plans and offered to make the monument without any compensation: "The idea to build and dedicate a monument to a movie hero is quite odd, and I am incredibly interested and attracted by all wonders and strange things."

The association explained the choice of Rocky by the fact that the movie hero started off as an unsuccessful boxer and by the end became a world champion, defeating all his opponents as well as overcoming his inner demons. This is what the town residents wanted to achieve in order to promote the progress of their town. In their opinion, this aim was reached: The unveiling of the monument was covered by international media and a Canadian crew even filmed it. However, much desired investments attracted by this advertisement fell short of expectations.



2008

Monumenti kushtuar Bob Marlit

Vendi: Banatski Sokolac, Serbi

Skulptor: Davor Dukić

Monument to Bob Marley

Location: Banatski Sokolac, Serbia

Sculptor: Davor Dukić

Monumenti kushtuar Bob Marlit (1945-1981), muzikantit legjendar të muzikës reggae nga Xhamajka, u zbulua në vitin 2008 në oborrin e shkollës fillore në Banatski Sokolac, në Serbinë verilindore. Si pjesë e festivalit të katërt të muzikës “Rok Fshati”, monumeti u përvurua nga disa prej muzikantëve më të njohur të muzikës rok nga territori i ish Jugosllavisë.

Ideja për monumentin u zhvillua nga organizatorët e festivalit, që vendasit gjithashtu e quajnë “Udstoku i Banatit”. Që nga fillimi i tij në 2005, festivali ka grumbulluar me mijëra adhurues të muzikës çdo vit. Organizatorët theksuan se Bob Marli e përdorte muzikën si medium për të përhapur dashuri, paqe e tolerancë ndërmjet njerëzve anembanë botës. Meqë festivali ka filozofi të ngjashme, organizatorët vendosën t’i kushtojnë respekt muzikantit të famshëm.

